

# **E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR DHE MBROJTJA E SAJ NË BE DHE NË SHQIPËRI**

Greta Bardeli

Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Shkencat Juridike, me profil E Drejtë civile, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ilir Mustafaj

Numri i fjalëve: 51.883

Tiranë, Mars 2017

## **DEKLARATË AUTORËSISE**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Emri, Mbiemri

Greta BARDELI

## DEDIKIM

Familjes sime,

*pa mbështetjen e të cilëve do kishte qenë e pamundur përfundimi i kësaj teme;*

Prindërve,

*që më mësuam vlerat, rëndësinë e edukimit dhe më nxitën të hy në labirinthe të dijes;*

Mentorit tim,

*pa përkushtimin dhe inspirimin e të cilit suksesi do kishte qenë i vështirë.*

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

|                              |     |
|------------------------------|-----|
| Deklarata e Autorësisë ..... | I   |
| Dedikimi .....               | II  |
| Tabela e Përmbajtjes.....    | III |

## **KAPITULLI I: HYRJA DHE BAZIMI TEORIK**

|                                                       |    |
|-------------------------------------------------------|----|
| 1.1.Hyrje.....                                        | 1  |
| 1.2.Qëllimi i studimit dhe rëndësia e tij.....        | 5  |
| 1.3.Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit.....   | 7  |
| 1.3.1.Pyetjet kërkimore të studimit.....              | 7  |
| 1.4.Hipotezat e studimit.....                         | 8  |
| 1.5.Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor..... | 9  |
| 1.6.Përmbledhja dhe strukturimi i kapitujve .....     | 10 |

## **KAPITULLI II: E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR NË KUADRIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE TË BASHKIMIT EVROPIAN**

|                                                                                                                                              |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 2.1. Hyrje. Natyra e të drejtës së bashkimit familjar .....                                                                                  | 14 |
| 2.2. E drejta e bashkimit familjar në aktet juridike ndërkombëtare.....                                                                      | 22 |
| 2.2.1. Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).....                                                                             | 25 |
| 2.2.2. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre e vitit 1990..... | 29 |
| 2.2.3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e New York-ut.....                                                                                  | 32 |
| 2.2.4. Konventa e Gjenevës mbi të Drejtat e Refugjatëve.....                                                                                 | 36 |
| 2.3. E drejta e bashkimit familjar në aktet juridike rajonale.....                                                                           | 38 |
| 2.3.1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).....                                                                              | 42 |

|                                                                                                                                      |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 2.3.2. Roli dhe vendimet e Gjykatës Europian të të Drejtave të Njeriut për<br>implementimin e të drejtës së bashkimit familjar ..... | 45 |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|

### **KAPITULLI III: E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR PËR QYTETARËT KOMUNITAR**

|                                                                                                                                |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 3.1. E drejta e bashkimit familjar e qytetarëve komunitar në kuadër të lëvizjes së lirë.....                                   | 48 |
| 3.2. Subjektet aktive të të drejtës së bashkimit familjar .....                                                                | 51 |
| 3.3. Subjektet pasive të të drejtës së bashkimit familjar .....                                                                | 56 |
| 3.3.1. Bashkëshorti/ja.....                                                                                                    | 58 |
| 3.3.2. Bashkëjetuesi/ja.....                                                                                                   | 60 |
| 3.3.3. Pasardhësit.....                                                                                                        | 62 |
| 3.3.4. Paraardhësit.....                                                                                                       | 64 |
| 3.3.5. Përfituesit e të drejtave.....                                                                                          | 65 |
| 3.4. Te drejtat që përfitojnë familjaret përfitues pas bashkimit familjar. E drejta e lëvizjes së<br>lire dhe e qëndrimit..... | 67 |
| 3.5. E drejta për të ushtruar një aktivitet ekonomik.....                                                                      | 69 |
| 3.6. Kufizimet për hyrjen dhe qëndrimin për arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe<br>shëndetit publik.....              | 70 |
| 3.7. Mënyrat e ushtrimit të të drejtës së bashkimit familjar .....                                                             | 76 |

### **KAPITULLI IV: E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR PËR QYTETARËT JO- KOMUNITAR NË BASHKIMIN EUROPIAN**

|                                                                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 4.1. Evoluimi i politikave komunitare mbi emigracionin e qytetarëve të vendeve jo anëtare të<br>BE-së.....     | 80 |
| 4.2. Direktiva 2003/86/EC në lidhje me bashkimin familjar të qytetarëve të vendeve<br>jo anëtare të BE-së..... | 84 |

|                                                                                                     |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 4.2.1. Përfituesit e të drejtës për bashkim familjar.....                                           | 87  |
| 4.2.2. Subjektet përfituese të të drejtës së bashkimit familjar të vendeve jo anëtare të BE-së..... | 90  |
| 4.2.2.1. Bashkëshorti.....                                                                          | 91  |
| 4.2.2.2. Fëmijët.....                                                                               | 93  |
| 4.2.2.3. Anëtarë të tjerë të familjes.....                                                          | 99  |
| 4.3. Kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar.....           | 101 |

## **KAPITULLI V: MBROJTJA E TË DREJTËS SË BASHKIMIT FAMILJAR NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR**

|                                                                                   |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 5.1. E drejta e bashkimit familjar në Shqipëri .....                              | 106 |
| 5.2. Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të drejtës së bashkimit familjar..... | 108 |
| 5.2.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.....                                 | 110 |
| 5.2.2. Ligji Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” .....                        | 111 |
| 5.2.3. Ligji Nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” .....           | 113 |
| 5.3. Subjektet e të drejtës së bashkimit familjar.....                            | 115 |
| 5.3.1. Bashkëshorti/ja, bashkëjetuesit/si.....                                    | 117 |
| 5.3.2. Fëmijët.....                                                               | 121 |
| 5.3.3. Paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë.....                    | 123 |

## **KAPITULLI VI: PROCEDURAT E BASHKIMIT FAMILJAR NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR DHE PROBLEMATIKAT QE HASEN NE PRAKTIKE**

|                                                                                                                        |     |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 6.1. Procedura e aplikimit për bashkim familjar në legjislacionin shqiptar.....                                        | 124 |
| 6.2. Procedura e aplikimit për bashkim familjar në legjislacionin shqiptar për refugjatet. Arritjet dhe mangesite..... | 128 |

|                                                                          |     |
|--------------------------------------------------------------------------|-----|
| 6.3. Leja e qëndrimit në kuadër të të drejtës së bashkimit familjar..... | 131 |
| 6.4. Rastet e refuzimit të bashkimit familjar.....                       | 136 |

## **KAPITULLI VII KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME**

|                        |     |
|------------------------|-----|
| 7.1. Konkluzione ..... | 140 |
| 7.2. Rekomandime.....  | 146 |

|                          |            |
|--------------------------|------------|
| <b>BIBLIOGRAFIA.....</b> | <b>149</b> |
|--------------------------|------------|

## KAPITULLI I: HYRJA DHE BAZIMI TEORIK

### 1.1.Hyrje

Familja është njësia bazë e shoqërisë dhe e drejta e bashkimit familjar është një nga të drejtat më të rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë. Në fakt, kjo e drejtë merr një rëndësi të vecantë në kauder të emigracionit, sidomos për shoqëri shqiptare në këto dy dekadat e fundit. Mbrojtja e kësaj të drejte është domosdoshmëri për ruajtjen e unitetit familjar. E drejta e bashkimit familjar aktualisht gëzon mbrojtje ligjore jo vetëm në nivel kombëtar dhe rajonal, evropian, por edhe ndërkombëtar. Garantimi i kësaj të drejte krijon mundësinë e bashkimit të personave me anëtarët e familjeve të tyre të cilët ndodhen në një shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes.

E drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore e sanksionuar në shumë akte ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe europiane<sup>1</sup>. Kjo është një e drejtë shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi. Nëpërmjet institutit të bashkimit familjar një personi (titullari aktiv) i njihet e drejta për t'u bashkuar me anëtarët e familjes së tij (titullarë pasiv) në një Shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. Në kuadër të bashkimit familjar, familjarët e një personi kanë të drejtë të shoqërojnë ose t'i bashkohen më vonë këtij të fundit nëse transferohet në një Shtet tjetër Anëtar, i ndryshëm nga ai i vendlindjes (Canaj, 2014; 59). Në përgjithësi, bashkimi familjar, nëse nuk ka

---

<sup>1</sup> Deklarata universale e të drejtave të njeriut (neni 12 dhe 16), Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (17 dhe 23) dhe Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 2) Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës (nenet 9 dhe 10), Konventa europiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 8) Karta sociale europiane (nenet 16 dhe 19) Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre (neni 44), Konventa europiane për statusin ligjor të punëtorëve migrantë (neni 12), Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Europian (neni 7) etj.



ndonjë regjim tjetër specifik i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare: d.m.th. rregullave specifike kur ka marrëveshje të veçanta ndërmjet shteteve ose rregullave të përgjithshme të legjislacionit të brendshëm të emigracionit të shtetit pritës kur nuk ka marrëveshje të veçanta, apo kur shteti në fjalë nuk bën pjesë në rende të veçanta juridike. Shembull i rastit të parë janë, ndër të tjera, marrëveshjet e nënshkruara nga Italia me disa shtete si Belgjika në vitin 1946, Gjermania në vitin 1965, Zvicra në vitin 1964, dhe Australia në vitin 1970<sup>2</sup>. Shprehje e rastit të dytë është legjislacioni ynë i emigracionit dhe azilit për shtetasit e huaj që kërkojnë bashkim familjar me familjarët e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me natyrë të veçantë prezantohet rendi juridik i Bashkimit Europian, ku bashkimi familjar merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkim familjar. Bashkimi familjar në BE njihet si titullar aktiv (personin që transferohet në një shtet tjetër anëtar -shteti pritës- dhe që kërkon bashkimin me familjen e tij që ndodhen në shtetin prej të cilit vjen – shteti i vendlindjes) si shtetasin komunitar ashtu edhe atë jo komunitar. Në këtë studim do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën juridike të Shteteve Anëtare të BE-së për rregullimin ligjor të bashkimit familjar si për shtetasit komunitar ashtu edhe ata jo komunitar dhe në përcaktimin e kategorive të familjarëve që e përfitojnë këtë të drejtë. Sistemi ligjor i Bashkimit Evropian përbën aktualisht një nga eksperiencat me përvojën

---

<sup>2</sup> Në lidhje me këto marrëveshje të shumta janë studjuesit që e kanë trajtuar por vecojme këtu BEYERS L., *"Italians" in Belgium: a unique process of changing positions and identities*, në *Studi Emigrazione*, 2005, fq. 762; RUBINACCI L., *La circolazione dei lavoratori nella Comunità economica europea*, në *La libera circolazione dei lavoratori*, *Rassegna del lavoro*, a cura del Ministero del lavoro e della previdenza sociale, Romë, 1962, fq. 11-13; BISCARO A., *Italia: ancora Paese d'emigrazione*, në *Undicesimo Rapporto sulle migrazioni 2005*, Milano, 2006; COMPASSO A., *Extracomunitari in Europa. Immigrazione, razzismo xenofobia*, Roma, 1995, fq. 16-17. FIBBI R., *Italiani in Svizzera: da Tschingg a persone frequentabili*, në *Studi emigrazione*, 2005, fq. 733; SPIRANI G., *Il diritto degli stranieri all'unità familiare*, Perugia, 2004, fq. 8-10.

më komplekse, i cili në kontekst merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkim familjar (Sirianni 2004, fq. 8).

Të drejtën e bashkimit familjar e gjejmë të trajtuar fillimisht në dispozitat e Traktatit Themelues të Komunitetit European dhe në legjislacionin sekondar të institucioneve komunitare. Në Europë, bashkimi familjar merr rëndësi si pasojë e krijimit të hapësirës së përbashkët, që përcakton jo vetëm flukset e punonjësve emigrantë, por përcakton në mënyrë shumë rigoroze dhe selektive mundësinë e hyrjes dhe qëndrimit, me preferencë për qëndrimet e përkohshme. Karakteristikat e flukseve migratore kanë qenë gjithmonë të ndryshme në kohë dhe për rrjedhojë kanë marrë rëndësi të ndryshme në varësi të kontekstit historik. Lëvizja e personave para viteve '90 ishte kryesisht brenda vendit dhe pas këtyre viteve filluan të shfaqeshin format e para të emigracioni ekonomik drejt vendeve të tjera. Fluksi më i madh i emigracionit ekonomik ishte pas Luftës së Dytë Botërore dhe kishte si qëllim rindërtimin ekonomik të shkatërruar nga Lufta. Pikërisht ishte kjo lëvizje migratore e cila krijoi konceptin e *guest worker*.

Një pjesë e konsiderueshme e personave emigronin vetëm dhe bashkimi i familjes, me familjarin e mbetur në vendin e origjinës, realizohej nëpërmjet nismave spontane të disa qytetarëve që i përkushtoheshin bashkimit të familjeve të ndara, edhe pse në mungesë të normativave në këtë fushë. Me evoluimin e ekonomisë dhe të shoqërisë civile evoluoi mbrojtja dhe rregullimi ligjor i të drejtës së bashkimit familjar, duke arritur një standardizim më të lartë (Canaj, Bana, 2014).

Fillesat e trajtimit të kësaj të drejte evidentohen në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, si akti më i rëndësishëm juridik ku janë mbështetur shumë traktate ndërkombëtare dhe komunitare. Bashkimi familjar në Deklaratën Universale të të Drejtave

të Njeriut është konsideruar si një nga të drejtat themelore të njeriut dhe si pasojë e këtij trajtimi institucioni i bashkimit familjar është njohur si instrument i nevojshëm për të ruajtur unitetin dhe jetën familjare. Bashkimi familjar ka qenë dhe do të mbetet një nga faktorët kryesorë të migrimit dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në integrimin e shtetasve të vendeve të treta. Bashkimi familjar përbën një nga arsyet kryesore të kërkesave për leje qëndrimi në hapësirën komunitare, duke u shndërruar në arsyen kryesore të hyrjes në hapësirën komunitare. E drejta e bashkimit familjar përveç impaktit social dhe politik ka edhe një impakt ekonomik shumë të rëndësishëm, sepse përfshin edhe të drejtave sociale të tjera si arsimi, shëndeti, rezidence etj., në kushtet e barazisë pak a shumë me qytetarin, shtetas të atij vendi.

E drejta e bashkimit familjar është zgjeruar gradualisht me Direktivën Nr. 2004/38 të BE-së e cila garanton lëvizje e lirë të shtetasve komunitarë dhe Direktivën Nr. 2003/86 të BE-së që saknsionon të drejtën e bashkimit familjar për shtetasit *extra* komunitarë. Pra, në të drejtën komunitare e drejta e bashkimit familjar është modeluar në varësi të faktit nëse subjektet që e kërkojnë atë janë shtetas komunitar apo qytetar të vendeve të tjera.

Qytetarët komunitar e ushtronin të drejtën e bashkimit familjar me familjarët e tyre vetëm nëse kishin përfituar një nga liritë themelore të parashikuara nga Traktati i BE. Direktiva Nr. 2004/38 e BE-së i akordon të drejtën e lëvizjes dhe të qëndrimit të gjithë shtetasve të Bashkimit European, me qëllim ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar të shtetasve komunitar, me familjarët e tij, përtej legjislacionit sektorial. Direktiva konfirmon kuadrin rregullues ekzistues, duke vendosur si kusht të pashmangshëm për ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar, zhvendosjen e qytetarit komunitar nga një Shtet në tjetrin. Gjykata e Drejtësisë në interpretimin e akteve ligjore në lidhje me të drejtën e bashkimit

familjar, ka evidentuar një tendencë për të forcuar sa më shumë jetën familjare, si të qytetarëve komunitar po ashtu edhe të atyre nga vende të treta.

Bashkimi familjar është një e drejtë që garantohet edhe në legjislacionin e vendit tonë. Burimet kryesore të së drejtës për bashkim familjar dhe unitetit familjar të të huajve të vendit tonë janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9959 datë 18.7.2008 “*Për të huajt*”, Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “*Për azilin në Republikën e Shqipërisë*” dhe Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “*Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë*” i amendaur. Legjislacioni ynë prezantohet i plotë, i besueshëm, i qartë dhe në përputhje me standartet europiane. Në bazë të legjislacionit të brendshëm e drejta e bashkimit familjar i njihet çdo të huaji që ka hyrë dhe qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe është i pajisur me leje qëndrimi me kohëzgjatje jo më të vogël se një vit në përputhje me kuadrin ligjor. Në legjislacionin kombëtar ligji në fjalë e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejtë themelore. Megjithatë, sic do të shihet edhe në këtë studim ka disa problematika që e karakterizojnë ushtrimin e kësaj të drejte nga shtetasit e huajt që jetojnë në vendin tonë.

## **1.2.Qëllimi i studimit dhe rëndësia e tij**

Qëllimi i këtij studimi është pikerisht analizimi i mbrojtjes së të drejtës së bashkimit familjar në nivel ndërkombëtar, komunitar dhe sidomos kombëtar. Kjo e drejtë përmban në vetvete nevojën për garanci dhe mbrojtje ligjore sepse mbron atë që konsiderohet esenca e

shoqërisë, pra, familja. Gjatë analizës së punimit do të evidentojmë që regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitar dhe jo komunitar në fakt, ndryshon.

Në këtë punim nuk kemi si qëllim në vetvete vetëm trajtimin e konceptit të të drejtës së bashkimit familjar por edhe analizimin e faktorëve që ndikojnë negativisht në garantimin e saj. Në kuadër të mbrojtjes së bashkimit familjar, familja komunitare është më e plotë dhe më e mbrojtur dhe përfshin jo vetëm bashkëshortin por edhe partnerin (bashkejetuesin) e regjistruar në gjendjen civile sipas rregullave të seciti shtet. Rregullimi ligjor i lejimit të hyrjes dhe qëndrimit të partnerëve *de facto* i lihet në dorë Shteteve Anëtare. Ky është një diskrecion i shtetit pritës dhe jo atij dërgues. Që këtu lindin problemet e unifikimit të legjislacioneve, edhe pse në realitet unifikim nuk ka.

Pasi u njohëm me problematikën e këtij punimi do të trajtojmë studimin në përputhje me fushën studimore përkatëse duke trajtuar rëndësinë e studimit.

Studimi i të drejtës së bashkimit familjar përbënë një rëndësi të veçantë pasi është një nga të drejtat më të rëndësishme në kuadër të ruajtjes së unitetit familjar. Kjo e drejtë është e sanksionuar në shumë akte ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe europiane, dhe është një nga të drejtat më të rëndësishme në lidhje me emigracionin dhe lëvizjen e lirë në përgjithësi. E drejta e bashkimit familjar i njihet një personi nëpërmjet institutit të bashkimit familjar. Është me rëndësi të theksohet se bashkimi familjar nëse nuk ka ndonjë regjim tjetër specifik, i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Rëndësia e studimit paraqitet në trajtimin e rendit juridik të Bashkimit European, ku bashkimi familjar merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkimin familjar. Bashkimi familjar në Bashkimin European njihet si titullar aktiv shtetasit komunitar edhe ata jo komunitar. Në Bashkimin European e drejta e bashkimit

familjar, si e drejtë themelore, parashikohet në Direktivën Nr. 2003/86/KE, “*Mbi bashkimin familjar për shtetasit jo komunitarë*” që gjenden në territorin e BE-së për arsye punësimi dhe në direktivën 2004/38/KE mbi lëvizjen e lirë për shtetasit komunitar.

Në këtë studim do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën juridike të bashkimit familjar të shtetasve të huaj që kërkojnë bashkim familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë siç janë refugjatët, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. E drejta e bashkimit familjar garantohej edhe në vendin tonë. Kjo e drejtë është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **1.3.Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit**

Per te realizuar kete studim kam ngritur disa pyetje kerkimore dhe disa hipoteza te cilat kerkoj ti vertetoj me argumenta te mirefillte shkencore juridike. Ato kane rendesi te vecante ne nje punim doktoral. Elementët kryesore pa të cilët një studim shkencor nuk do të konsiderohej kurrësi i plotë janë pyetjet kërkimore dhe hipoteza e ngritur. Me anë të pyetjeve kërkimore i jepet, projektit kërkimor, rëndësia e duhur duke evidentuar në këtë mënyrë dhe drejtimin e studimit dhe qëllimin e tij.

#### **1.3.1. Pyetjet kërkimore të studimit**

Në këtë studim kemi ngritur disa pyetje kërkimore. Për të analizuar këtë tematikë kemi ngritur fillimisht disa pyetje kërkimore, të cilat janë:

1. Cili është kuptimi i të drejtës për bashkim familjar?
2. Si realizohet e drejta e bashkimit familjar?
3. Cilët janë aktet juridike me anë të të cilëve garantohet e drejta e bashkimit familjar?
4. Cilët janë subjektet përfituese që ligji u mundëson të drejtën për të aplikuar për bashkim familjar?
5. Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjar?
6. Cilat janë mënyrat e ushtrimit të të drejtës të bashkimit familjar?
7. A garantohet e drejta e bashkimit familjarë nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë?

#### **1.4. Hipotezat e studimit**

Hipoteza e studimit paraqitet në funksion dhe mbështetje të pyetjeve kërkimore.

##### *Hipoteza 1*

Nuk kemi ende një kompromis ndërkombëtar për përkufizimin dhe nocionin e familjes, kjo sepse kushtëzohet nga legjislacioni i brendshëm dhe jurisprudenca komunitare, duke bërë që të jetë i ndryshëm, në varësi të legjislacioneve, apo statusit të personave që përcaktojnë përbërjen e familjes.

##### *Hipoteza 2*

Mbrojtja e të drejtës së bashkimit familjar garantohet edhe nga legjislacioni shqiptar duke respektuar ndalimet përkatëse të vendosura nga ligjet në fuqi. Kjo mbrojtje behet sipas standarteve dhe rregullave të Bashkimit Europian.

### *Hipoteza 3*

Në këtë kontekst kuadri ligjor i mbrojtjes së të drejtës së bashkimit familjar duhet të jetë subjekt i përmirësimeve me qëllim përparimin dhe harmonizimin e politikës së bashkimit familjar pasi në Shqipëri ka shumë problematika lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzohet të huajt me qëllim përfitimin e bashkimit familjar.

### **1.5. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor**

Metodologjia në këtë studim përfaqëson analizën logjike, juridike dhe institucionale të mbrojtjes së drejtës për bashkim familjar. Analiza e dispozitave të legjislacionit të të drejtës së bashkimit familjar, studimi i legjislacionit në nivel ndërkombëtar, evropian dhe kombëtarë do të jenë pjesë e punës kërkimore. Studimi ka në fokus trajtimin e mbrojtjes së të drejtës së bashkimit familjar në disa nivele për të evidentuar dhe ndihmuar në përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar në trajtimin e kësaj të drejte. Për të arritur këtë qëllim mbledhja e të dhënave të këtij studimi mbështetet në një kombinim të disa metodave shkencore të përdorura, të cilat do të e vërtetojnë në vijim.

*Metoda Historike:* Përdorimi i metodës historike synon të paraqesë një panoramë të shkurtër të evoluimit që ka pasur mbrojtja e të drejtës së bashkimit familjar deri në ditët e sotme. Përdorimi i kësaj metode na ndihmon të kuptojmë rëndësinë e kësaj të drejte dhe mbi të gjitha si ka evoluar ajo në kohë.

*Metoda e analizës së legjislacionit* konsiston në analizimin në mënyrë të detajuar të legjislacionit në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, të jurisprudencës perkatese, doktrinës



dhe dokumentet të tjera ligjore të zbatueshme. Kjo metodë e përdorur në këtë studim bazohet kryesisht në analizën e dispozitave ligjore e kushtetuese, instrumenteve apo akteve ndërkombëtare që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtës së bashkimit familjar dhe familjen në përgjithësi. Nëpërmjet kësaj metode jemi përpjekur të analizojmë jurisprudencën komunitare mbi të drejtën e bashkimit familjar të qytetareve komunitare dhe *extra* komunitarë në Bashkimin Europian dhe mbi të gjitha jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

*Metoda Cilësore:* me anë të kësaj metode kemi përdorur mbledhjen e të dhënave me qëllim përfshirjen më shumë në kontekstin aktual të respektimit të të drejtës së bashkimit familjar, duke marrë në studim përjasjen që ka ligjvënësi shqiptar për të garantuar këtë të drejtë si dhe duke studiuar gjithashtu qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë në rastet e cenimit të kësaj të drejte.

Gjatë gjithë studimit vërehet përdorimi gjerësisht i metodës hulumtuese, e cila është përdorur më qëllim mbledhjen dhe shfrytëzimin e materialeve të shkruara dhe elektronike si jurisprudencën e gjykatës të drejtësisë për të drejtën e bashkimit familjarë. Kjo metodë ka shoqëruar fazën e sistemimit të zërave bibliografik në funksion të finalizimit të këtij punimi.

## **1.6.Përmbledhja e kapitujve**

Ky punim doktoral do të sintetizojë kombinimin e njohurive teorike gjithëpërfshirëse dhe jurisprudenciale të ndarë në pesë kapituj dhe secili prej tyre trajton çështje të veçanta sipas ndërtimit të strukturës së tij.

Në *kapitullin e parë* do të trajtojmë aspektin teorik të punimit, duke dhënë një përshkrim të shkurtër të punimit i cili do të shërbejë si një pasqyrë për të rritur interesin në lidhje me përmbajtjen në brendësinë e tij. Në këtë kapitull do të trajtojmë shkurtimisht metodologjinë e studimit me anë të të cilës është bërë e mundur mbledhja, përpunimi, analizimi i materialeve përbërëse të tij. Këtu është trajtuar rëndësia e studimit, qëllimi bashkë me elementët thelbësorë të të drejtës së bashkimit familjar duke u fokusuar kryesisht te mbrojtja që i ofrohet kësaj të drejte. Janë trajtuar shkurtimisht problematikat e studimit dhe nevoja për studime të thelluara, nisur nga fakti që në mjedisin shqiptar ka një vakum shkencor në lidhje me trajtimin e kësaj të drejte.

Në *kapitullin e dytë*, trajtojmë gjenezën e të drejtës së bashkimit familjar. Trajtohet shkurtimisht historiku i të drejtës së bashkimit familjar dhe natyra e kësaj të drejte. Në vazhdimësi të tij trajtohen fillesat e mbrojtjes së kësaj të drejte të para në këndvështrimin e evoluimit si dhe të arritjeve në këtë fushë. Kështu, trajtohet e drejta e bashkimit familjar në të drejtën ndërkombëtare dhe komunitare, Ndër aktet universale mbi të drejtat e njeriut që ofrojnë mbrojtje për të drejtën e bashkimit familjar të trajtuara në këtë studim janë Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre e vitit 1990., Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e New York-ut dhe Konventa e Gjenevës mbi të Drejtat e Refugjatëve. Pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli është dhe trajtimi i mbrojtjes së të drejtës së bashkimit familjar në aktet rajonal mbi të drejtat e njeriut, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në *kapitullin e tretë* do të trajtojmë të drejtën e bashkimit familjar në kuadër të lëvizjes së lirë të qytetarëve komunitar. Një punim shkencor, nëpërmjet të cilit kërkohet të

analizohet mbrojtja e të drejtës së bashkimit familjar, nuk do të konsiderohej i tillë nëse në analizën e tij do të mungonte trajtimi i jurisprudencës së Gjykatës të Drejtësisë në lidhje me respektimin në kësaj të drejte. Do të trajtohen gjerësisht subjektet që konsiderohen nga ligjet komunitare mbajtes të të drejtës së lëvizjes së lirë sepse qytetaret komunitare gëzojnë të drejtën e bashkimit me familjaret e tyre edhe nëse janë qytetare komunitare apo të ardhur nga vende të treta. Do të trajtohen kategoritë e qytetareve të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e bashkimit familjare në Bashkimin European, dhe kategorinë e subjekteve përfituese nga e drejta e bashkimit familjar. Pjesë e këtij kapitulli është dhe trajtimi i të drejtave që gëzojnë personat që përfitojnë nga e drejta e bashkimit familjarë, siç janë e drejta e për të ushtruar një aktivitet ekonomike, e drejta e rezidencës, etj. Çdo kuadër ligjor ndërkombëtar apo komunitar përcakton të drejtat e subjekteve të kësaj të drejte dhe kufizimet në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin e rregullt në vendin pritës. Në përfundim të këtij kapitulli trajtojmë edhe mënyrat e ushtrimit të të drejtës së bashkimit familjar.

Në kapitullin e katërt trajtohet e drejta e bashkimit familjar për qytetarët *extra* komunitar në Bashkimin European. Pjesë e këtij kapitulli janë evoluimi i politikave komunitare mbi emigracionin e qytetarëve të vendeve të tjera dhe bashkimi familjar i qytetarëve *extra* komunitar në Bashkimin European. Në kornizën ligjore të akteve komunitar të cilët garantojnë mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtës së bashkimit familjar do të trajtojmë edhe Direktivën Nr. 2003/86 e cila i referohet të drejtës së bashkimit familjar të qytetarëve të vendeve të treta. Kjo Direktivë fokusohet kryesisht në trajtimin e mbartësve dhe subjekteve përfituese të të drejtës së bashkimit familjar siç janë bashkëshort, fëmijët dhe anëtarë të tjerë të familjes. Ushtrimi i të drejtës së bashkimit familjar nga ana e

subjekteve përfitues shoqërohet domosdoshmërisht me plotësimin e kushteve të kërkuara për ushtrimin e kësaj të drejte nga ana e legjislacionit komunitar.

Në kapitullin e pestë do të trajtohet mbrojtja e të drejtës së bashkimit familjar në legjislacionin tonë të brendshëm. Fillimisht do të paraqesim një vështrim të shkurtër historik në lidhje me këtë të drejtë dhe më pas do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën juridike të bashkimit familjar të shtetasve të huaj që kërkojnë bashkim familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë siç janë refugjatët, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. Trajtimin e kuadrit ligjorë dhe të subjekteve përfitues nga kjo e drejtë si dhe boshllëqet ligjore që mund të ketë legjislacioni i brendshëm.

Në përfundim të studimit do të paraqesim konkluzionet e punimit dhe rekomandimet përkatëse si një vlerë e shtuar dhe e domosdoshme për të evidentuar arritjet por edhe nevojën për përmirësim të kuadrit ligjorë përkatës.

Pjese e këtij punimi në fund do të jete edhe bibliografia e përdorur sipas ndarjes në burime përsore, dytesore dhe tretesore (interneti).

## **KAPITULLI II: E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR NË KUADRIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE TË BASHKIMIT EVROPIAN**

### **2.1. Hyrje. Natyra e të drejtës së bashkimit familjar**

Bashkimi familjar është institucioni përmes të cilit një personi i lejohej që të bashkohej me pjesëtarët e familjes së tij në territorin e një shteti të ndryshëm nga ai i origjines ose vendlindjes. E drejta e bashkimit familjar paraqet interes të veçantë jo vetëm sepse trajton atë që konsiderohet si bërthama themelore e shoqërisë – familja, por edhe sepse kjo e drejtë lidhet ngushtë me të drejta të tjera të rëndësishme, si e drejta e rifitimit të bashkimit të familjes, e drejta e të miturve për t'u rritur dhe zhvilluar në një ambient të sigurt, e drejta për jetë private dhe familjare, si dhe e drejta për ruajtjen e kulturës dhe traditave të tyre. (Strozzi.G,2000:133) E drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të njeriut në përgjithësi, sepse nëpërmjet saj krijohet fenomeni i lëvizjes së personave nga një shtet në tjetrin, mekanizëm i cili kërkon një rregullore specifike dhe të detajuar.

E drejta e bashkimit familjar gëzon një rregullim ligjor dhe mbrojtje në nivel ndërkombëtar, komunitar dhe shtetëror. (Cellamare.G.2000:152) Ky rregullim ligjor realizohet mbi një strukturë të “prerë” e cila bazohet në kategoritë e ndryshme të subjekteve. Në raste të ndryshme bazohet edhe mbi dinamikën e bashkimit familjar si për shembull, në kuadër të BE-së, rregullorja është e ndryshme në sajë të faktit që përfituesi i të drejtës është qytetar i një shteti anëtar të BE-së apo qytetar me prejardhje nga vende të treta. Nisur nga fakti që pranimi i bashkimit familjar është një e drejtë sovrane e shtetit, i cili gëzon autonomi të plotë në rregullimin e hyrjes dhe të qëndrimit të të huajve në

territorin e tij, bashkimi i një familjeje të përbërë vetëm nga shtetas komunitare konsiderohet tashmë si një e drejtë plotësisht e garantuar, falë evolucionit dhe konsolidimit të parimit të lëvizjes së lirë brenda BE-së. (Martiniello.M, 2004:256) Pikërisht për këtë arsye kjo temë nuk shkakton më polemika në rendin ligjor komunitar. Ndryshimet që ajo pëson janë risi të cilat konsistojnë në përmirësimin e kushteve dhe thjeshtimin e procedurave të bashkimit të qytetarëve të Bashkimit European.

E drejta e bashkimit familjar në rastin e qytetarë të vendeve të treta trajtohet në mënyrë të ndryshme se në rastin e qytetarëve të vendeve komunitare, kjo për faktin se është një e drejtë që përshin çështje delikate sa i përket aspektit politik të saj mbi cilet anetare do të perfitojnë bashkimin familjar. Kështu bashkimi familjar, nëse nga njëra anë kërkon të konsolidohet, të paktën në thelb, nga ana tjetër është i ekspozuar ndaj politikave të pritjes të secilit shtet në kuader të emigracionit. (Hailbronner.K,2000:16) Disiplinat europiane ofrojnë në kompleks një mbrojtje të artikuluar të kërkesave në lidhje me njësinë familjare të emigrantëve. (Cholewinsky.R, 2004:115) Këto disiplina veprojnë negativisht si kufizime ndaj dëbimeve të të huajve, dhe pozitivisht, si e drejtë e bashkimit të familjarëve. (Bascherini.G, 2007:311)

Kjo e drejtë edhe pse shkon paralelisht me flukset migratore ekstra-komunitare, nuk mund të programohet. (Nascimbene.B, 2004:71) Në fakt, i takon vetë familjeve, që në momentin e plotësimit të kushteve të nevojshme, të vendosin nëse duan dhe kur duan të bashkohen me pjesën tjetër të familjes. Pra, njohja e të drejtës së bashkimit familjar do të thotë pranimi që emigracioni nuk përbën aspak një ngjarje të përkohshme, e lidhur me nevojat e natyrës ekonomike, por ai është një realitet i përhershëm i cili mund të shkaktojë transformime në jetën sociale dhe kulturore të shtetit pritës. Megjithatë, është një fenomen i

pashmangshëm dhe si i tillë duhet të përballohet.

Lëvizja e lirë e punonjësve emigrantë, në kontekstin më të gjerë të lëvizjes së lirë të personave në përgjithësi, kërkon ekzistencën e tre elementeve thelbësore: të drejtën për të lënë vendin e tyre, të drejtën për të hyrë në një vend tjetër dhe të drejtën për të qëndruar në vendin e zgjedhur. (Bhabha.J, 2003:203). Interesat thelbësore të emigrantëve, kur spostohen nga një vend në tjetrin, janë në parim tre: kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit në Shtetin pritës, apo nevoja dhe siguria për të mos u dëbuar nga vendi i zgjedhur; mundësia për të punuar dhe kushtet e punës në përgjithësi; i treti ka të bëjë pikërisht me bashkimin familjar. (Giuld.E ,2000:16).

Instituti i bashkimit familjar, në kontekstin më të gjerë të fenomenit migrator, që nga fillimi ka prekur me shumë profilin sociologjik, sesa profilin juridik. (Mottura G,1992:49). Në kuadrin e politikave migratore në Europë, bashkimi familjar merr rëndësi si pasojë e krijimit të hapësirës së përbashkët, që përcakton jo vetëm flukset e punonjësve emigrantë, por përcakton në mënyrë më rigoroze dhe selektive mundësinë e hyrjes dhe qëndrimit, me preferencë për qëndrimet e përkohshme. (Zanfrini.I,2007:27) Studimet sociologjike janë përqendruar më shumë në konceptin e “*family migration*” në perspektivën e integritetit dhe mbështetjes së individit dhe vetë familjarëve, sesa si bashkim familjar në termat juridikë. (Drobhlav D, 2003)

Burimet e të drejtës ndërkombëtare e projektojnë të drejtën e bashkimit familjar si përfituese të mbrojtjes absolute në fushën e të drejtave themelore të njeriut, por aktualisht ende nuk është e mundur një njohje e plotë dhe e pakushtëzuar e së drejtës së bashkimit familjar, duke marrë parasysh dhe interesin korrespondues të shtetit pritës për të kontrolluar

flukset migratore<sup>3</sup>.

Karakteristikat e flukseve migratore ndryshojnë në kohë dhe marrin rendësi të ndryshme në varësi të kontekstit historik. Kështu, para viteve nëntëqind personat spostoheshin nga njëri vend në tjetrin në shumicën e rasteve me të gjithë familjen, në përgjithësi e përbërë nga bashkëshorti/ja, fëmijët, vëllezërit, motrat dhe prindërit) dhe në këto kushte flitet për emigracion familjar. (Melotti.U,2000:115)

Migrimi individual ndodhte më rrallë dhe në këto raste. Me se shumti emigronte e gjithë familja. Kur verifikoheshin raste të kësaj natyre dhe familja kishte mbetur në vendin e origjinës, bashkimi i familjes realizohej në forma tradicionale shoqërore, nëpërmjet qytetarëve që merreshin me bashkimin e familjeve të ndara, edhe pse në mungesë të një normative specifike. (Johnson.V,1996:170) Kështu, nga viti 1763 deri në vitin 1912, prindërit e punonjësve që kishin emigruar nga Mbretëria e Bashkuar drejt Amerikës, të mbetur në vendin e origjinës, bashkoheshin falë ndërmjetësimit të një shoqërie të quajtur “*Imperial Home Reunion Association of Winnipeg*”. (Canaj Bana 2014) Kjo shoqëri për shembull gjatë kësaj periudhe ka qenë pika e vetme e referimit dhe shpresa e vetme për bashkimin e shumë familje të ndara. Procedura e bashkimit ishte e thjeshtë dhe ngjason me procedurën aktuale të bashkimit familjar. Kriteret kryesore që duhet të plotësonte personi që të gëzonte të drejtën e bashkimit familjar ishin të ardhurat ekonomike (*rrogë javore*) të mjaftueshme për mbajtjen e familjes, të përfituara nga një burim i ligjshëm (*punë*), dhe një

---

<sup>3</sup> Ky interpretim është mbështetur shprehimisht nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimin e saj të 19 shkurtit 1996 *Gül v. Zira*, aplikimi nr. 23218/94; gjykimi i 21 qershorit 1988 *Berrehab c. Olanda*, aplikimi nr. 10730/84; Vendimi i 28 majit 1985 *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali c. Mbretëria e Bashkuar*, kërkesa. 9214/80, 9473/81, 9474/81 të mundshme në [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int). Shih gjithashtu në doktrine L.Pascucci, Qiftet e pamartuara. Një kufi për bashkim familjar? cit., f. 1042 ss; F.Angelini, E drejta për bashkim familjar, në F.Angelini, M.Benvenuti, A.Schillaci (eds) kufijtë e rinj të ligjit të emigracionit: Integrimi, të drejtave, sigurisë, Jovene, 2011, f. 166.



banesë e përshtatshme (një shtëpi e madhe mjaftueshëm për të gjithë familjen). (Blangiardo.G & P.Farina,2006:97) (Canaj Bana 2014)

Akti i parë juridik që trajton bashkimin familjar është “*Immigration Act*”. Akti i emigracionit u krijua në Shteteve të Bashkuara në vitin 1907 dhe përcakton kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të të huajve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (Canaj Bana 2014) Në bazë të tij, procedura që ndiqej në veri të Amerikës dhe në Kanada, ishte mjaft e lehtë. Kërkuesi plotësonte një formular me të dhënat e tij si emri, adresa, emri i punëdhënësit, natyrën e punës, të ardhurat javore, emrin e plotë të gruas apo të fëmijëve, vërtetim mjekësor ku vërtetohet që personat që do ishin pjesë e bashkimit familjarë nuk ishin të sëmurë me sëmundje të rënda si epilepsia, verbëria etj.

Në formularë përcaktohej edhe shuma e të ardhurave që do të paguhej në favor të shoqërisë ndërmjetësuese dhe të ardhurat mujore. Në rastet kur familja përbëhej nga nëntë apo dhjetë pjesëtarë dhe kërkuesi nuk ishte në gjendje të siguronte transportin dhe qëndrimin e të gjithë familjarëve atëherë procedura zhvillohej në dy (ose më shumë) faza. Kështu, fillimisht procedohej me lejimin e hyrjes së fëmijëve në moshë madhore, të cilët mund të punonin dhe të ndihmonin ekonomikisht kërkuesin për të siguruar të ardhurat minimale, si një shtëpi e madhe dhe të ardhura ekonomike të mjaftueshme, për të vazhduar më tej me bashkimin e pjesëtarëve të tjerë, nëna dhe fëmijët e tjerë. (Canaj Bana 2014)

Shoqëritë që merreshin me bashkimet ishin konform me përshtatjet e Sekretarit të Përgjithshëm të Tregtisë dhe të Punës, me vëmendje në shqetësimin kryesor “që personi që do të vijë të mos jetë i sëmurë nga epilepsia, të mos jetë shtruar në çmendinë pesë vitet e fundit, të mos jenë të shurdhër, memecë, apo të verbër dhe të mos kenë sëmundje ngjitëse të syve apo të lëkurës dhe të mos jenë të deformuar dhe të jenë në shëndet të mirë”. Në

thelb, bashkimi familjar merr forma të veçanta duke i dhënë gjithnjë e më shumë rëndësi jo vetëm bashkimit në vetvete, por edhe kushteve fizike, ekonomike dhe estetike të plotësuara nga kërkuesi dhe nga përfituesi. (Bhabha J,2006:203).

Kërkuesi, që në shumicën e rasteve ishte babai i familjes, duhej të kishte marrë rezidencën e përhershme dhe duhej të kishte deklaruar qëllimin e tij për t'u bërë qytetar (amerikan), ndërsa gruaja dhe fëmijët e kërkuesit nuk duhej të vuanin nga sëmundje të pashërueshme, ngjitëse apo të rrezikshme për të tjerët; për të mos u bërë një rëndesë për shtetin dhe një rrezik për komunitetin që i mirëpret. (Lonato.B,2007:17)

E parë në këtë kontekst, bashkimi familjar nuk duket si një e drejtë e lidhur me mbrojtjen e njësisë familjare. Ajo që merr prioritet në këtë akt në konceptin e bashkimit familjar, nuk janë kushtet ekonomike dhe banimi, por gjendja shëndetësore e pjesëtarëve të familjes dhe kushtet e tyre fizike të shëndetshme d.m.th. që nuk rrezikohen nga sëmundje të pashërueshme dhe ngjitëse që mund të transformoheshin në një rrezik për higjienën publike dhe rendin publik të qytetarëve. (Canaj Bana, 2014).

Për pasur një kuadër më të plotë të zhvillimit të bashkimit familjar duhet trajtuar dhe konteksti historik në të cilin ky fenomen ka lindur dhe ka marrë formë edhe në Evropë. Në fillim të shekullit të XIX kemi krijimin e emigracionit ekonomik në shkallë të gjerë. Kjo formë migrimi konsistonte fillimisht në spostime nga zonat rurale në ato urbane brenda vendit dhe më tej në migrimin nga shteti në shtet. Fillimi i shekullit të njëzetë shënon një kufizim në lëvizje, sidomos për punonjësit migrues. (Cholewinski.R,1997:200)

Në periudhën midis Luftës së parë dhe Luftës së dytë botërore, punonjësit migrues punonin kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe atë të minierave. Dhe, konkretisht, gjatë Luftës së dytë botërore, kemi migracionin masiv, i cili ishte i nevojshëm për të rindërtuar

ekonominë e shkatërruar nga lufta. Në këtë periudhë lindi edhe figura e *guest worker* (punonjës–mik), apo *Gastarbeiter* në Gjermani, e cila është e karakterizuar nga një sërë akordesh bilaterale rekrutimi forcash pune, të nënshkruara midis shteteve. Këto marrëveshje janë konsideruar, kryesisht marrëveshje me natyrë ekonomike dhe nuk e trajtojnë bashkimin familjar në një profil ngushtësisht juridik<sup>4</sup>. Këto marrëveshje përmbanin dispozita specifike të orientuara nga bashkimi familjar, sepse forca punëtore emigrante konsiderohej si një fenomen i përkohshëm. (Beyers.B,2005:762). Punonjësit emigrues janë konsideruar *guest workers*, kryefamiljarë pa familje ose të rinj të pavarur; arsyeja kryesore e pranisë së tyre në territorin e shtetit pritës ishte ajo e motivit ekonomik. (Canaj Bana, 2014).

Në përfundim të punës, në përgjithësi, ata duhet të ktheheshin në vendin e tyre të origjinës. Në thelb, pra, integrimi i tyre social dhe kulturor në komunitetet pritëse dukej i panevojshëm pasi merrej në konsideratë që këto punonjës emigrues nuk kishin si synim të qëndronin për një kohë të gjatë ose përfundimisht. (Cholewinski.R, 2004: 257) Sistemi *guest – worker* pushoi së funksionuari në fillimin e viteve 70, ku në këtë periudhë, shumë punonjës emigrues u kthyen në vendet e tyre të origjinës, por gjithashtu shumë të tjerë u stabilizuan përfundimisht në vendin pritës. (Apap.J,2004:257) Në këtë situatë filloi të shfaqet nevoja për t’u siguruar këtyre punonjësve emigrantë mundësinë për t’u ribashkuar me familjarët e tyre të mbetur në vendet e origjinës, kjo e diktuar nga konsiderata njerëzore, sociale dhe politike. (Cholewinski.R, 2004: 257) Në vendet Europiane, vetëm në vitet ‘80 fillon të ndihet frika nga një fluks i madh emigrantësh, të ardhur nga jashtë, dhe në këtë

---

<sup>4</sup> Shih marrëveshjen Italo-belge e vitit 1946 franko-italiane shkurt dhe nëntor të vitit 1946 dhe i treti në vitin 1951, lidhur midis Zyrës Kombëtare të Emigracionit me qeverinë italiane.

kontekst fillojnë të forcohen kontrollet mbi emigracionin. (Furlanos.G,1986:34)

Në analizimin e zanafilles të së drejtës së ribashkimit familjar duhet evidentuar, ndër të tjera, që ribashkimi është i rëndësishëm edhe nën profilin e dëbimeve dhe të largimeve të të huajve. Dëbimi në përgjithësi ka për qëllim mbrojtjen e rendit publik të një shteti dhe nuk është i rregulluar nga një disiplinë ndërkombëtare, përveç se në raste të veçanta.

Nga analiza e burimeve kombëtare që kanë si objekt rregullimin e dëbimeve të të huajve, vërejmë se, nën profilin që na intereson, në veçanti ligji Belg i 17 Prillit, 1871 dhe ligji Holandez i 13 Gushtit, 1847, përmbajnë rregulla për dëbimin dhe largimin e të huajve, të cilat edhe pse nuk i referohen njësisë së familjes, për herë të parë e mbrojnë edhe pse në mënyrë të nënkuptuar, pasi ndalojnë urdhrin e dëbimit ndaj personave që janë martuar me një grua belge apo holandeze, në rastin kur kanë lindur fëmijë në shtetin pritës, me synimin specifik të mbrojtjes së familjes, pjesëtarët e së cilës janë qytetarë të shtetit pritës. Bashkimi familjar është konfiguruar në termat e “ligjit” vetëm pas Luftës së dytë botërore, pasi afirmohet në terma universalë rëndësia e familjes, së cilës i duhet njohur mbrojtja dhe i duhet atribuuar mbështetja më e madhe. (Canaj Bana, 2014).

Shprehje e mbrojtjes është pikërisht mbrojtja e njësisë familjare. Institucioni ka evoluar me kalimin e viteve, por jo në mënyrë uniforme, pasi përmbajtja e këtij instituti vazhdon të jetë e ekspozuar nga rregullimi i kësaj të drejte nga legjislacioni kombëtar i secilit shtet, siç është rasti i përgjithshëm i hyrjeve dhe qëndrimeve të emigrantëve. Në këtë kontekst, mund të themi që bashkimi familjar korrespondon me një tendencë të përhapur, e cila haset në shumë prej shteteve, në veçanti në vendet Europiane, të cilët janë frymëzuar nga nevoja për t'i njohur disa të drejta themelore të huajve dhe t'i lejojë atyre të

ribashkohen me familjarët e tyre në mënyrë që të kenë një jetë emocionale, familjare për një integrim efektiv. (Nascimbene.B,2006:861) Por shtetet kanë mbajtur një qëndrim të tërhequr dhe kujdes në hapjen e kufijve nga frika e flukseve të pakontrolluara të emigrantëve dhe nga frika që nuk do të mund t'u siguronin atyre një integrim socio-ekonomik efektiv në shtetin pritës. (Franco.P,2007:522)

## **2.2. E drejta e bashkimit familjar në aktet juridike ndërkombëtare**

E drejta e bashkimit familjar është e sanksionuar në aktet e ndryshme në nivel ndërkombëtare dhe rajonal. Akti i parë me influencë ndërkombëtare që ka sanksionuar për herë të parë të drejtën e bashkimit familjar është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e miratuar në vitin 10.12.1948<sup>5</sup>, akt mbi të cilin janë mbështetur shumë dokumente dhe traktate ndërkombëtare dhe komunitare. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut nuk ka natyrën e traktateve ndërkombëtare dhe nuk ka fuqi kushtetuese, por konsolidimi në shkallë botërore të garancive të themeluara në këtë akt, përgjegjshmëria në fushën e të ashtuquajturës *international soft law* (ligji i butë ndërkombëtar) është vënë në dyshim nga shumë palë. (Martenson.J,14) Një karakteristikë tjetër origjinale e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut është se zbatimi universal; një karakter të përgjithshëm, veçanërisht të përkushtuar ndaj miratimit të të drejtave themelore të personit. (Pocar.F,31) Të drejtat e parashikuara në Deklaratë kanë zbatueshmëri për të gjithë njerëzit në nivel ndërkombëtar. (Eide-C.A & Rosas.K:16-17) Deklarata ofron mbrojtje për individin si qenie njerezore dhe i

---

<sup>5</sup> Shih Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut kundër. [www.un.org](http://www.un.org) site. Shih. Në mësimin e të drejtave të njeriut në 40 vjet pas Deklaratës Universale. Studime dhe hulumtime të drejtat e njeriut, organizuar nga Studime dhe Qendrën për trajnim të Njeriut dhe të Drejtat e Popujve ", Padovës, 1989; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, organizuar nga Qendra e Informimit të Kombeve të Bashkuara, 1973.

vetmi formim social që ajo garanton është *familja* si bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë. (Eide-C.A & Rosas.K:99)

Rëndësia e kësaj njohjeje çon rrjedhimisht në njohjen e të drejtës së familjes për të marrë mbrojtjen e duhur dhe konsideratat e përshtatshme nga shoqëria dhe nga shteti. Jeta private dhe familjare trajtohet në nenin 12 të Deklaratës ku përcaktohet që *“asnjë individ mos t’i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare në jetën e tij private dhe familjare. Çdo individ ka të drejtën të jetë i mbrojtur me ligj nga ndërhyrje apo dëmtime të saj”*. Po kështu, në nenin 16, mbrohet e drejta familjare dhe e drejta e çdo individi që kur emigron të krijojë dhe të ketë të drejtë të bashkohet me familjen. Deklarata nuk jep një përkufizim të sakte të nocionit të familjes dhe të modelit të saj, ndaj trajtimi i kësaj të drejte i referohet pikës së tretë të këtij neni që përkon me bërthamën natyrore dhe themelore të shoqërisë dhe ka të drejtë të jetë e mbrojtur nga shoqëria dhe nga shteti<sup>6</sup>. Deklarata ofron një mbulim të gjerë njësisë familjare, (Aveta.R,2007:21) duke e konsideruar si një nga të drejtat parësore dhe themelore që i përkasin personit. Si konkluzion natyror i kësaj pikëpamjeje është njohur institucioni i bashkimit familjar, si instrument i nevojshëm për të ruajtur unitetin dhe për të lejuar jetën familjare.

Parimet e vendosura në dispozitat në shqyrtim janë marrë në konsideratë nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, miratuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut; në mënyrë të veçantë, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike<sup>7</sup>. Ky i fundit, së bashku me Paktin e të Drejtave

---

<sup>6</sup>Neni 16 thotë shprehimisht: “.. (3) Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.” Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, botuar nga botimet e shoqërisë italiane për cit ndërkombëtare organizatës.

<sup>7</sup> Shih nenin. 23 paragrafi 1 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Ekonomike, Sociale dhe Kulturore janë traktate ndërkombëtare që vendosin rregulla juridike kufizuese për shtetet<sup>8</sup>. Si neni 16 i Deklaratës Universale ashtu edhe neni 10 i Paktit mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i njeh familjes një rëndësi themelore, duke e konsideruar edhe një herë si bërthama themelore e shoqërisë.

Në nenin 10, paragrafi 1 të Paktit Ndërkombëtar, përcaktohet: *“mbrojtje dhe mbështetje sa më e madhe duhet t’i jepet familjes, duke qenë se është bërthamë themelore e shoqërisë, përderisa ajo ka përgjegjësinë e mbajtjes dhe edukimit të fëmijëve në ngarkim”*. E drejta e respektimit të jetës familjare garantohet edhe nga neni 17 dhe neni 23 i Paktit, ndërsa neni 17 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike mbron individin nga ndërhyrjet arbitrare apo të paligjshme në jetë e tij private, në familjen e tij, në shtëpinë e tij apo në marrëdhëniet e tij dhe parashikon mbrojtje të individit nga të tilla ndërhyrje. (Hailbronner.K:278) Në paragrafin 2 të nenit 23 sanksionohet e drejta për t’u martuar dhe për të krijuar familje.

Parimi i mosdiskriminimit gëzon një rëndësi të veçantë dhe është një nga parimet në bazë të të drejtës ndërkombëtare, i përcaktuar edhe në nenin 2 të Paktit mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe në nenin 26 të Paktit mbi të drejtat civile dhe politike. Sipas parimit në fjalë, dispozitat e përmbajtura specifikisht në Paktet ndërkombëtare, mbrojnë të gjithë individët, jo vetëm qytetarët, por edhe të huajt, duke përfshirë kështu edhe emigrantët që ndodhen në territorin e shtetit apo që i janë nënshtruar juridiksionit të tij. (Sepúlveda.M,2003:379) Sipas këtij parimi, gjithsecili shtet detyrohet të respektojë dhe të

---

<sup>8</sup> Italia ka nënshkruar Konventat Ndërkombëtare në 18 janar 1967 dhe ratifikuar 15 shtator 1978 pas miratimit të përgatitur nga ligji 25 tetor 1977 n. 881, botuar në Fletoren Zyrtare e 7 dhjetorit 1977, n. 333, hyri në fuqi për Itali dhjetor 15, 1978, në pajtim me nenin. 49 § 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni. 27 § 2 të Konventës mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Shih [www.un.org](http://www.un.org).

garantojë të gjithë individët që ndodhen në territorin e tij të drejtat e njohura në Paktet Ndekombetare, pa asnjë lloj dallimi, mbi racën, gjuhën, origjinën kombëtare apo shoqërore, kushtet ekonomike, lindjen apo çdo kusht tjetër. (Canaj Bana, 2014).

### **2.2.1. Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP)**

Vështirësitë ekonomike janë arsyeja kryesore për të cilën individit vendose që të qëndroje në mënyrë të përhershme në një shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes/origjinës. Në këtë kontekst, tema e të drejtës së bashkimit familjar ka qenë objekt i vëmendjes edhe në kontekstin e politikës së mbrojtjes së punëtorëve emigrantë. Vëmendja i drejtohet në radhë të parë, krijimit të një sistemi rregullash ndërkombëtare për punësimin, dhe në radhë të dytë përkufizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe të kushteve të punës. Punëtorët emigrantë, për arsye të qarta, përfaqësojnë një kategori të ndjeshme, shpesh të pambrojtur dhe në nevojë të mbrojtjes së duhur. Konventat e para në këtë temë janë Konventat Ndërkombëtare të Punës, (O'Leary.A,2005:227) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, si agjencia e Kombeve të Bashkuara që merret me promovimin e punësimit dinjitoz dhe produktiv në kushte lirie dhe barazie, sigurie dhe dinjiteti njerëzor midis burrave dhe grave, përmirësim të mbrojtjes sociale dhe përforcim të dialogut mbi problematikat e punësimit. (Cabrini.A,1923:7)

Konventat Organizatës Ndërkombëtare të Punës përgjithësisht aplikohen ndaj të gjithë punonjësve, përfshirë edhe punonjësit emigrantë duke treguar kështu që Organizata ka treguar një interes të veçantë për këtë kategori punëtorësh. Konventat me të rëndësishme që trajtojnë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve emigrantë dhe familjeve të tyre janë:



Konventa Nr. 97 e vitit 1949<sup>9</sup> dhe Konventa për Punëtorët Emigrantë Nr. 143 e vitit 1975<sup>10</sup>. Konventat janë shoqëruar dhe me Rekomandimet përkatëse: respektivisht Rekomandimi Nr. 86 dhe Rekomandimi Nr. 151. Në të dyja Konventat përfshihet përcaktimi i termit “punëtor emigrant” (“*migrant worker*” ose “emigrant për punësim”) dhe sipas tyre do të konsiderohen punonjës emigrantë personat që emigrojnë (ose kanë emigruar tashmë) nga një vend në tjetrin me qëllimin që të jenë të punësuar, si dhe personat e hyrë rregullisht në territor si punonjës emigrantë. (Canaj Bana: 2014)

Konventa nr. 97 mund të konsiderohet dhe si konventa e parë e cila trajton institucionin e bashkimit familjar për punëtorët emigrantë dhe familjet e tyre. (Brinkmann.G, 2002:246) Konventa, pavarësisht se nuk vendos asnjë kufizim për shtetet që e firmosin për të autorizuar shoqërimin apo ribashkimin, shpreh pa dyshim një favorizim ndaj bashkimit familjar të familjeve që shoqërojnë punonjësit emigrantë, duke përdorur shprehje si “emigrantë, dhe për pjesëtarë të familjeve të tyre të autorizuar për t’i shoqëruar apo arritur”<sup>11</sup>.

Konventa Nr. 143 vendos norma kundër emigracionit abuziv, duke promovuar barazine në trajtimin e punëtorëve emigrantë. Në këtë kontekst kjo Konventë vendos një

---

<sup>9</sup>Konventa u miratua më 01.07.1949 nga Konferenca ndërkombëtare e Përgjithshme të Punës, të mbledhur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Punës Ndërkombëtar dhe hyrë në fuqi më 22.01.1952. Konventa është ratifikuar nga Italia dhe zbatuar me. August 12, 1952 n. 1304. Konventa është ratifikuar nga Belgjika (1953), Francë (1954) Germany (1959) Itali (1952) Holanda (1952) Portugal (1978) Spain (1967) dhe Britania e Madhe (1951). Mbi problemet e emigracionit të punëtorëve, Konferenca e Romës Ndërkombëtare mbi propozimet e tezës italiane të shihni detaje Italy Organizata Ndërkombëtare e punës të Lidhjes së Kombeve, (1919-1929). Shih ne lidhje me kete argument Canaj Bana, *Il diritto al ricongiungimento famigliare e la sua tutela multilivello*, Edizioni Nuova cultura, Rome, 2014.

<sup>10</sup>Konventa është miratuar në Gjenevë më 24/06/1976 dhe hyrë në fuqi më Konventës 09.12.1978.La është ratifikuar nga Italia dhe zbatuar me. April 10, 1981 n. 158. Shtetet anëtare të BE-së të cilat e kanë ratifikuar Konventën, përveç Italisë, janë Portugalinë (1978) dhe Suedia (1982).

<sup>11</sup> Shih nenet 5, 8 dhe 17 të Konventës, nenet. 06:07, Shtojca I, Neni. 07:09 Aneksi II dhe, në fund, nenet. 1 dhe 2, Shtojca III. Shih. Në këtë temë G. Srianni, e drejta e të huajve unitetit të familjes,

hap përpara. Në nenin 13 të saj kjo del qartësisht në pah. Konventa nr. 143, përcakton rregullat kundër emigracionit në kushtet abuzive, duke promovuar barazinë e oportuniteteve dhe trajtimit të punonjësve emigrantë dhe përcakton shprehimisht që shtetet duhet të thjeshtësojnë ribashkimin familjar të të gjithë punonjësve emigrantë:

*“1. Çdo shtet anëtar mund të miratojë të gjitha dispozitat e favorshme në kompetencë të tij dhe të bashkëpunojë me shtetet e tjera anëtare, për të favorizuar bashkimin familjar të të gjithë punonjësve emigrantë që banojnë ligjërisht në territorin e tij.*

*2. Ky nen ka të bëjë me bashkëshortin/en e punonjësit emigrant, dhe kur janë në ngarkim të tij, edhe fëmijët, edhe prindërit”*. (Colacino,2004:133)

Në këtë kontekst, rekomandimet drejtuar shteteve anëtare për të favorizuar bashkimin familjar janë pasojë direkte e dobësisë së të drejtës ndërkombëtare për të konfiguruar bashkimin familjar si një nevojë e të gjithë punonjësve emigrantë. Në këtë kuptim, i kërkohet shteteve favorizimi i bashkimit familjar, duke përfshirë jo vetëm bërthamën e familjes, por edhe prindërit. Rekomandimi nr. 86 që shoqëron Konventën ILO nr. 97, në nenin 15 përcakton se anëtarë të familjes të një punëtori emigrant, që janë grua dhe fëmijët e mitur. Megjithatë, sipas këtij neni, duhet të merret në konsideratë edhe kërkesa për përfshirje të anëtarëve të tjerë të familjes që varen nga punonjësi emigrant. Specifikohet në këtë mënyrë se cilët janë familjarët e pranueshëm në ribashkim. (Brinkmann.G,2002:246)

Në rekomandimin Nr. 143 që shoqëron Konventën ONP, që trajton të drejtat e punonjësve emigrantë, i kërkohet shteteve anëtare thjeshtësimi i bashkimit familjar “sa më shpejt të jetë e mundur” dhe gjithashtu synohet të thjeshtëzohen me instrumente mbështetëse të përshtatshme nevojat e familjeve të ribashkuara. Në lidhje me pjesëtarët e

familjes të cilët kanë të drejtën e bashkimit me punonjësit emigrues, art. 13 i rekomandimit nr. 151 ripërcakton që familja e punëtorit emigrant përfshin bashkëshortin/en, fëmijët në ngarkim, babain dhe nënën.

Duket i arsyeshëm nënvizimi i faktit që Konventa ONP e 1975 e shtrin të drejtën e ribashkimit familjar edhe te babai dhe nëna e punonjësit emigrant, (Galoppini.A,2000:740) në ndryshim me instrumentet e tjerë ndërkombëtare në të cilat kjo e drejtë nuk i njihet pjesëtarëve të tjerë të familjes. Konventat ONP mbrojnë personin si punonjës emigrant me tendencën e njohjes së bashkimit familjar vetëm në funksion të statusit të punëtorit<sup>12</sup>. Në këtë kuptim, Konventa ILO e vitit 1949 e drejton vëmendjen në mënyrë të veçantë tek punësimi dhe kushtet e punës të punonjësve emigrantë, ndërsa Konventa ONP e vitit 1975 përqendrohet shumë më tepër mbi integrimin apo në mundësinë që shtetet mund t'u ofrojnë edhe anëtarëve të familjes së punonjësit. (Canaj Bana, 2014).

Ndër të tjera, përdorimi i fjalës “*may*” (A *Member may take all necessary measures*) në vend të “*shall*” përkthehet në një rekomandim më shumë sesa në një detyrim për secilin shtet që ka ratifikuar Konventën. (Cholewinski.R, 2004: 71) Justifikimi i kësaj zgjedhjeje “të butë” duhet lidhur me pajtueshmërinë ekonomike shkaktuar nga kriza e naftës (1973-1974) që shtetet e përfshira po kalonin pikërisht në periudhën e redaktimit të saj. Megjithatë Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës kanë qenë të parat që kanë njohur ribashkimin familjar si një e drejtë e cila u rezervohet punëtorëve. Sidoqoftë kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të të huajve ka qenë dhe mbetet, siç është nënvizuar edhe më parë, e drejtë e shtetit sovran. (Canaj Bana, 2014).

---

<sup>12</sup>Spas statistikave të Organizatës ndërkombëtare të migracionit, aktualisht, 175 milion njerëz banojnë në një vend të ndryshëm nga ai i lindjes apo kombësia.

## **2.2.2. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve**

### **Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre e vitit 1990**

Implementimi i normave të promovuara nga Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës Nr. 97 e vitit 1949 dhe nr. 143 e vitit 1975, ka qenë arsyeje që Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 18 dhjetor 1990 miratoi Konventën për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve emigrantë dhe të pjesëtarëve të familjeve të tyre<sup>13</sup> e cila hyri në fuqi në 10 korrik 2003. (Nascimbene.B,2006:3) Qëllimi i Konventës është mbrojtja në nivel ndërkombëtar i të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të punonjësve që emigrojnë për arsye ekonomike apo punësimi, përmes miratimit të ligjeve të përshtatshme dhe praktikave të mira në nivel kombëtar, pra garantim i trajtimit të barabartë mes emigrantëve dhe qytetarëve. (Franco.P,2007:525)

Për herë të parë kjo Konventë e OKB-së jep një përcaktim ndërkombëtar për “punëtorët emigrantë”, dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre, duke vendosur disa standarte ndërkombëtare për trajtimin e tyre. Konventa nuk i trajton punonjësit emigrantë vetëm si forcë pune, por edhe si subjekte shoqërore dhe pjesëtarë të një bërthame familjare. Për rrjedhojë, ata janë titullarë të të drejtave themelore dhe të pakapërcyeshme, siç vendoset më para edhe nga Konventa të tjera ndërkombëtare. Konventa është e zbatueshme për të gjithë punonjësit emigrantë që qendrojnë në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, dhe familjeve të tyre, pa asnjë lloj dallimi<sup>14</sup>.

Kjo Konventë është i vetmi instrument ndërkombëtar që përmban një përkufizim, edhe pse

---

<sup>13</sup> Konventa që është në fuqi që nga korriku i vitit 2003, nuk është ratifikuar as nga Italia, as nga shumë vende të tjera evropiane. Për të lexuar tekstin e Konventës dhe statusin e ratifikimeve të shihni faqen e internetit <http://untreaty.un.org>.

<sup>14</sup> Shiko nenin 2 ku përcaktohet termin "punëtorë emigrantë", "punëtorë kufitare", "punëtorë sezonale", "detarin", "punëtorë në një instalim në det të hapur", "punëtorë shëtitës", "projekt-lidhur punëtorë 'etj

të pjesshëm, të “familjes”. (Manca.L,2005:22) Sipas nenit 4 të kësaj Konvente me termin “*members of family*”, anëtarë të familjes, përfshihen,

1. bashkëshorti/ja e punonjësit apo ato që kanë me këtë të fundit një marrëdhënie që prodhon *efektet e martesës*;
2. fëmijët në ngarkim;
3. personat e tjerë të familjes që konsiderohen në ngarkim të punonjësit emigrant.(Colacino,2004:133)

Është me rëndësi të theksohet që familja referohet pra një koncepti më të gjerë të bërthamës familjare duke përfshirë edhe prestatet që janë jashtë kufizimeve formale martesore.

E drejta e bashkimit familjar është e sanksionuar në neni 44 të Konventës ku përcaktohet se shtetet anëtare të Konventës, nisur nga fakti që familja është njësia themelore e shoqërisë duhet të marrin masat e nevojshme për të garantuar ruajtjen e të drejtës familjare të punëtorëve emigrantë<sup>15</sup>. Sipas kësaj dispozite: “1. Shtetet palë, duke pranuar që familja është elementi natyror dhe themelor i shoqërisë dhe i shtetit, marrin masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e njësisë familjare të punonjësit emigrant. 2. Shtetet palë marrin masat e përshtatshme dhe që janë në kompetencën e tyre për të thjeshtësuar bashkimin e punonjësit emigrant me bashkëshortin/en e tyre apo me personat që kanë me to marrëdhënie të tilla që, në zbatim të ligjit të aplikuar, prodhojnë efekte të barazvlefshme me martesën, si dhe me fëmijët në ngarkim, të mitur dhe të pamartuar. 3. Për arsye humanitare, shtetet marrin parasysh t’i japin barazi në trajtim, kushteve të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, pjesëtarëve të tjerë të familjes së punëtorit emigrant”.

---

<sup>15</sup> Shih nenin 44 paragrafi 1 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve emigrantë dhe të pjesëtarëve të familjeve të tyre e vitit 1990

Formulimi i kësaj dispozite në krahasim me normat e analizuara duket më imponues në përdorimin e shprehjes: shtetet *duhet të marrin masat e duhura* për të thjeshtësuar bashkimin familjar. Në dispozitën në fjalë përdoret në fakt shprehja duhet që tregon një detyrim dhe jo mundesi si në aktet e tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, është marrë në konsideratë edhe zgjerimi i kategorive përfituese, kështu përveç bashkëshortit/es, dispozita i referohet specifikisht edhe bashkimeve të tjera që prodhojnë, sipas legjislacionit në fuqi, të njëjtat efekte si të martesës, përmendim ketu bashkejtesën dhe çiftet *de iure* dhe *de facto*; si dhe kategoria e fëmijëve nuk përfshin vetëm fëmijët e mitur që janë në ngarkim, por edhe fëmijët në moshë madhore në ngarkim ose që nuk mundën të sigurojnë vetë jetesën e tyre ; kategoria e fundit e familjarëve (paragrafi 3) përmban pjesëtarët e tjerë të familjes në linjë direkte (paraardhës dhe pasardhës), si prindërit, gjyshërit, ashtu si dhe linjën tjetër, siç janë vëllezërit ose motrat, xhaxhallarët apo nipërit: pranimi në territorin e shtetit me qëllimin e ribashkimit të kësaj kategorie duhet bërë për arsye humanitare dhe i duhet lënë në zgjedhje shteteve nënshkruese. (Canaj Bana, 2014).

Numri i aderimit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian në Konventë, pavarësisht trajtimit dhe mbrojtjes që i bën kësaj të drejte si dhe kërkesës së shpeshtë nga Parlamenti dhe nga Komisioni për ta ratifikuar, ka qenë i ulët. Sjellja e shteteve anëtare të BE-së është e përmbajtur si pasojë e frikës së marrjes së angazhimeve të shumta në këtë fushë, por përpos këtij fakti, ratifikimi i Konventës nuk i kufizon shtetet palë me parime të ndryshme apo shtesa nga ato të shprehura më parë në instrumente juridike ndërkombëtare, është e qartë që ajo do të nxiste te shtetet europiane lënien e politikës së mos-njohjes së të drejtave të njeriut të emigrantëve dhe dhënien e rëndësisë në drejtim të tyre si subjekte të cilëve u takon mbrojtja dhe garancia në vend që të jenë thjesht forcë pune dhe ingranazh i

sistemit prodhues. Këtij elementi i shtohet edhe frika që hyrja në fuqi e saj mund të shkaktojë dyndje të punonjësve emigrantë, sidomos në vendet e me nivel të lartë jetese, dhe mund të inkurajojë gjithmonë e më shumë njerëz nga vendet në zhvillim të emigrojnë drejt vendeve të zhvilluara.

### **2.2.3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e New York-ut**

Mbrojtja ndërkombëtare që i atribuohet të miturve, si subjekte kryesore të përfitimeve të të drejtës së njësisë familjare ka një trajtim të ndryshëm nga ajo e personave në moshë madhore. Për të siguruar të drejtat e të miturve Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi me anë të Rezolutës Nr .44/25 të 20 nëntorit 1989<sup>16</sup> Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve të New York–ut. Kjo Konventë është një akt me përmasa historike, jo vetëm për numrin e lartë të shteteve që kanë aderuar në të (192 shtete kane ratifikuar Konventën), por edhe sepse ajo karakterizohet nga risi inovative në lidhje me mbrojtjen juridike të fëmijëve. Kështu, përcaktimi që Konventa jep për të miturit jepet në nenin 1 të saj. Të mitur quhen ata individë që nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përveç atyre që e kanë arritur moshën e pjekurisë sipas legjislacionit në fuqi.

Në bazë të kësaj Konvente fëmijët nuk konsiderohen më si subjekte të thjeshta mbrojtjeje juridike, por konsiderohen si subjekte të së drejtës, titullarë të pozicioneve juridike të pavarura përkundër shoqërisë, shtetit dhe vetë prindërve. Të drejtat e shpallura në Konventë përsërisin në një pjesë të mirë të tyre të drejtave që janë prezentë edhe në instrumentet e tjera ndërkombëtare me karakter të përgjithshëm (si Paktet Ndërkombëtare

---

<sup>16</sup>Konventa është në fuqi nga data 2 shtator 1990. Italia e ka nënshkruar Konventën më 26 janar 1990 dhe ratifikuar atë 5 shtator 1991.

të 1966)<sup>17</sup>. Në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve të New York–ut është parashikuar e drejta e ribashkimit familjar të të miturve me prindërit e tyre.

Konventa jo vetëm që njeh ekzistenca e së drejtës së bashkimit familjarë por dhe formulon një sërë direktivash që detyrojnë shtetet të garantojnë maksimalisht interesin e të miturit në çdo kompetence të institucioneve publike, të autoriteteve administrative dhe të organeve legjislativë (neni 3), duke i detyruar të respektojnë të drejtat e fëmijës në ruajtjen e identitetit të tij dhe marrëdhënieve familjare si dhe të mos jetë i ndarë nga prindërit (neni 8 dhe neni 9). Normat e Konventës zbatohen për të gjithë fëmijët pa asnjë dallim. Parimi i mosdiskriminimit është sanksionuar në nenin 2 të kësaj Konvente, sipas të cilit shtetet duhet t'u sigurojnë dhe garantojnë të drejtat, pa asnjë dallim, të gjithë të miturve, nën juridiksionin e të gjithë shteteve nënshkruese.

Në nenin 9 të Konventës trajtohet njësia familjare, ku përcaktohet se shtetet duhet të përpiqen që fëmija të mos jetë i ndarë nga prindërit e tij kundër dëshirës, vetëm në rastin kur autoritetet kompetente kanë vendosur që kjo ndarje është në interesin madhor të fëmijës. Domethënë, shtetet duhet t'i japin gjithmonë përparësi interesit madhor të fëmijës. (Mondino.S,2007:442) Bazuar në nenin 9 e drejta për të mos u ndarë nga familja konsiston në dy detyrime të përgjithshme të shteteve:

1. detyrimi negativ për të mos ndërhyrë në jetën familjare dhe

---

<sup>17</sup> Në disa raste mbrojtja e ofruar nga Konventa është më i kufizuar se sa ajo që ishte planifikuar në instrumente të tjera ndërkombëtare siç është neni 32, paragrafi 2, Në lidhje me fëmijët, ajo nuk përcakton një moshë minimale për punësimin e tyre, kjo e fundit përcaktohet në nenin 2 paragrafi 3 i Konventës së ILO-s moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Në nenin 14 sigurohet liria e fesë së fëmijëve, por kjo nuk e njeh të drejtën e zgjedhjes së lirë të besimit,



2. detyrimi i dytë pozitiv, për të cilin duhen marrë të gjitha masat për të siguruar dhe garantuar të drejtën e njësisë familjare të fëmijës (bashkimit të familjes)<sup>18</sup>

Shtetet duhet të sigurojnë që fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit e tij kundër vullnetit të tyre, me përjashtimin e vetëm kur ndarja konsiderohet si e nevojshme në interesin maksimal të fëmijës<sup>19</sup>. Në këtë këndvështrim, në kuadër të zbatimit të parimeve të vendosura nga Konventa, merr rëndësi hipoteza e ribashkimit familjar “përmbys”. Ky formë e bashkimit familjar ndodh në rastet kur subjekti aktiv (prindi) ndodhet në vendin e tij, ndërsa i mituri në një vend pritës. (Nascimbene.B,2006:878) Ligjvënësi kombëtar lejon hyrjen për ribashkim familjar më fëmijën e mitur që ndodhet në vendin pritës, të prindit që tregon brenda një kohe të caktuar nga data e hyrjes, posedimin e kërkesave të banesës dhe të të ardhurave. Kjo lloj mbrojtjeje i rezervohet të miturit që ka nevojë për të pasur sidoqoftë pranë vetes prindin, pasi gjendet në vendin pritës në kushte psiko-fizike të caktuara. (Canaj Bana, 2014). Në këto raste, shtetet janë të detyruar t’i garantojnë ribashkimin familjar të miturit që ndodhet në territorin e tij, detyrim i cili mbizotëron mbi kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe qëndrimit për të huajt.

Falë këtij neni verifikohet edhe një tjetër rast në të cilën interesi i të miturit është cenuar pasi jemi përballë pranimi të situatave poligame: për të miturin, interesi madhor përkon me prezencën e nënës, e cila është bashkuar me babain në një martesë poligamie.

---

<sup>18</sup> Në nenin. 9, paragrafi 2 detyrohen Shtetet Anëtare të marrin të gjitha masat për të siguruar bashkimin familjar të familjeve të ndara.

<sup>19</sup> Shih nenin 3 të Konventës ku trajtohet epërsia e interesit më të lartë të fëmijës.

Kjo e fundit është e ndaluar, pasi martesë poligame është në kundërshtim me normat e detyrueshme të rendit publik në vendet e Europës Perendimore<sup>20</sup>.

Në nenin 10 paragrafi 2 të Konventës së New York-ut përcaktohet se shtetet kanë detyrimin të respektojnë këto të drejta në drejtim të çdo fëmije, në rastin kur kjo e drejtë ushtrohet (në mënyrë të veçantë) me qëllimin për të ruajtur lidhjet familjare me prindërit që banojnë në vende të ndryshme nga ai i të miturit. Pra, neni 9 dhe neni 10 përfshijnë të drejtën e bashkimit familjar, pas mbrojtjes dhe garantimit të fëmijës nga ndarja me prindërit e tij. I mituri ka të drejtë të jetojë me prindërit e tij, ashtu siç të dy prindërit kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për të rritur fëmijën. (Jastram.K,185) Kjo do të thotë që kufizimet duhet t'i përkasin vetëm rasteve që përfshihen në nenin 9, pika e parë, sipas së cilit bashkimi familjar duhet të ndodhë vetëm në rastin kur është në interesin maksimal të të miturit.(Mondino.S, 2007:442) Nenet në fjalë zbatohen edhe për fëmijët e refugjatëve banues në një shtet të caktuar, të ndryshëm nga ai i origjinës<sup>21</sup>. (Canaj Bana, 2014).

---

<sup>20</sup>Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit e Torinos, e cila vendosi në favor të qëndrimit të qëndruar ndaj gruas së dytë, për qëllim jo mbrojtjen dhe bashkimin jo-martesor por mbrojtjen e interesave të fëmijës, duke u bazuar në Konventë për të drejtat e fëmijës. Rasti kishte të bënte me banim i një marokeni në Itali me dy gratë dhe dy fëmijët e tyre. Kërkesa e bërë nga subjekti për të autorizuar grua të dytë për të qëndruar në Itali ishte refuzuar nga Gjykata e të Miturve të Torinos sepse ishte në kundërshtim me parimet e ligjit italian. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë shtetasi maroken ,apeloj vendimin në Gjykatën e Apelit të Torinos në bazë të dispozitave të nenit. 31 paragrafi 3 ku përcaktohet se "për arsye të rënda që lidhen me zhvillimin fizik dhe psikologjik, dhe duke marrë parasysh moshën dhe gjendjen e shëndetit të fëmijës që është në territorin italian (ju) mund të autorizojë ...vendbanimin e familjes për një periudhë kohë të caktuar, pavarësisht nga dispozitat e tjera të ... tekst të vetëm. " Një autorizim i tillë do të sjellë një situatë poligame, nëse lejohet në bazë të nenit 29 "për të lejuar një bashkëshort për t'u ribashkuar bashkëshortin tjetër në një situatë poligame familjare; por në këtë rast autorizimi është dhënë në interes të fëmijës së mitur, për të siguruar afërsinë e prindit, pavarësisht nëse kjo është apo nuk është i martuar me prindin tjetër të fëmijës, dhe është martuar në regjimin monogame ose poligame. Autorizimi ka për qëllim jo për të mbrojtur një marrëdhënie martesore, në teori, në kundërshtim me parimet e sistemit tonë ligjor, por për të realizuar të drejtën e fëmijës për të mos u ndarë nga prindi".

<sup>21</sup> Shih nenin 2 të Konventës. e Gjenevës mbi të drejtat e refugjatëve.

#### **2.2.4. Konventa e Gjenevës mbi të Drejtat e Refugjatëve**

E drejta e bashkimit familjar për refugjatet trajtohet në kuadrin e përgjithshëm të mbrojtjes së familjes dhe të mbrojtjes së bashkimit familjar të personave, që për arsye të ndryshme transferohen nga një vend në tjetrin.<sup>22</sup> Uniteti i familjes është kryesor për refugjatët dhe bashkimi familjar duhet konsideruar si një fakt stabiliteti i madh dhe pozitiv për integrimin e tyre. Respekti i parimit të bashkimit familjar lind si një instrument parësor për mbrojtjen e refugjatëve. (Goodwin-Gill.G.S2005:141) Asambleja e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të garantuar të drejtat e refugjatëve hartoi Konventën e Gjenevës në lidhje me statusin e refugjatëve e miratuar më 25 qershor 1951. Konferenca e cila u mbledh nga 2 deri 25 korrik 1951 formuloi pesë rekomandime, të cilat përkatësisht i referohen dokumenteve të udhëtimit, unitetit të familjes, organizatave joqeveritare, azilit dhe kuadrit të aplikimit të dispozitave konvencionale.

Sipas nenit 1 A(2) të Konventës së 1951, termi "refugjat" do të zbatohet "si rrjedhojë e ngjarjeve të ndodhura para 1 janarit 1951 dhe për çdo person i cili për shkak të frikës së bazuar të të qenit i persekutuar për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose të bindjes politike, ai ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij, dhe nuk ka mundësi apo për shkak të një frike të tillë, nuk dëshiron të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose kur ai duke mos patur shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij si pasojë e këtyre ngjarjeve nuk ka mundësi, ose nuk ka dëshirë të kthehet atje për arsye të kësaj frike"<sup>23</sup>. Kjo Konventë detyron shtetin pritës të marrë të gjitha masat për të siguruar bashkimin e familjes së refugjatit, edhe pse e kufizuar në

---

<sup>22</sup>Shih [www.un.org](http://www.un.org).

<sup>23</sup>Shih nenin 1 Konventës së Gjenevës lidhur me Statusin e Refugjatëve të vitit 1951.

bërthamën e familjes, duke konsideruar që refugjati nuk mund të kthehet më në vendin e prejardhjes dhe të gëzojë aty jetën familjare së bashku me familjarët e tij. (Hathaway.C,2005:553)

Mungesa e rregullave specifike në Konventë, në lidhje me mbrojtjen e bashkimit familjare nuk do të thotë, që mbrojtja e familjes së refugjatit nuk përbën një detyrim. E drejta themelore e njësisë së familjes, ashtu si parimi i bashkimit familjar janë të njohura në këtë Akt Final të Konferencës që miratoi Konventën ku u rekomandohej shteteve të miratonin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e familjes së refugjatit, me qëllimin e ruajtjes së njësisë familjare.

Edhe pse kemi të bëjmë me një sqarim shtesë për mbrojtjen e garantuar ndaj refugjatëve dhe familjeve të tyre, do të kishte qenë shumë më e dobishme përfshirja e një dispozite të veçantë në tekstin e Konventës. (Jastram.K &Newland.K, 565) Duke mbajtur parasysh rekomandimet dhe tendencën për ta konsideruar njësinë familjare të refugjatit si një e drejtë themelore në formulimin e dispozitave të Konventës së 1951, Konventa duhet të lexohet së bashku me hyrjen e saj, në mënyrë që refugjatëve t'u garantohet ushtrimi i të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në kuptimin sa më të gjerë të mundshëm. (Jastram.K &Newland.K, 566)

Në literaturën juridike mbrojtja maksimale i rezervohet bërthamës familjare, bashkëshortit/es dhe fëmijëve të mitur në ngarkim, duke i lënë shteteve fuqinë për të zgjeruar këtë mbrojtje edhe për personat e tjerë pjesëtarë të familjes, si fëmijët në moshë madhore, prindërit etj.. Disa shtete i kanë zgjeruar të drejtat e njohura ndaj refugjatëve (të quajtur “kryefamiljar”) ndaj familjes së tij “*the immediate families of refugees*”, e përbërë jo vetëm nga gruaja dhe fëmijët natyrorë, por edhe nga fëmijët e biresuar dhe fëmijët e

njërit nga bashkëshortëve të lindur nga një martesë e mëparshme. (Nascimbene.B,2004:861) Deri më sot, kjo e drejtë e të qenit të mbrojtur nga ndërhyrjet e paligjshme në jetën familjare është e kufizuar për bashkëshortët heteroseksualë dhe fëmijët e mitur në ngarkim. (Hathaway.C,2005:546)

Komuniteti ndërkombëtar i ka kushtuar vëmendje të veçantë bashkimit familjar të refugjatëve dhe nevoja për të mbrojtur parimin e bashkimit të familjes së refugjatëve është rikonfirmuar nga Komiteti Ekzekutiv i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR). Komiteti ka vendosur në mënyrë specifike që respekti për bashkimin familjar është një “*minimum basic human standart*” në disa situata dhe ka inkurajuar bashkimin familjar jo vetëm të refugjatëve, por edhe të personave që qëndrojnë në një shtet nën mbrojtje të përkohshme.

### **2.3. E drejta e bashkimit familjar në aktet juridike rajonale**

Në trajtimin e të drejtës së bashkimit familjar janë shumë të rëndësishme dhe aktet e mbrojtjes rajonale, si Akti Final i Helsink-it, Karta Sociale Europiane, apo Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Nisur nga fakti që Akti Final i Helsinkit-it nuk është një marrëveshje ndërkombëtare ashtu si dokumentet finale të akteve të mëtejshme të Parisit 1990 dhe të Helsinkit 1992, ai nuk është shtruar për ratifikim nga ana e Parlamenteve kombëtare. (Canaj Bana; 2014)

Akti konsiderohet si një “*gentlement’s agreement*” dhe si i tillë, angazhimet dhe dispozitat e përmbajtura në të nuk janë të detyrueshme<sup>24</sup>. Akti është i ndarë në tre pjesë, të

---

<sup>24</sup> Dispozitat e Aktit Final të Helsinkit konsiderohen vetëm "politikisht" të detyrueshme.

cilat trajtojnë çështjet kryesore si siguria, bashkëpunimi ekonomik, shkencor, teknik dhe mjedisor dhe të drejtat e njeriut. Pjesa e tretë i dedikohet kryesisht bashkëpunimit në të drejtat e njeriut dhe fusha të tjera si lëvizja e lirë e njerëzve, duke përfshirë këtu edhe bashkimin familjar si dhe vizitat mbi bazë të lidhjeve familjare. Akti final, në paragrafin 6 të kapitullit mbi Bashkëpunimin Ekonomik të quajtur “Bashkëpunim në sektorin humanitar dhe në sektorë të tjerë”, i dedikon një pjesë të tërë bashkimit familjar. Në fakt, në pjesën “Kontakte mes njerëzve”, trajtohen ndër të tjera :

1. Kontaktet dhe takimet e rregullta mbi bazat e lidhjeve familjare,
2. Ribashkim i familjeve dhe
3. Martesa midis qytetarëve të shteteve të ndryshme. Pozita e mësipërme tregon qartësisht rëndësinë që shtetet pjesëmarrës i kanë rezervuar çështjeve që kanë lidhje me familjen<sup>25</sup>.

Vendoset që shtetet pjesëmarrëse të impenjohen “të thjeshtësojnë, sa më shumë që është e mundur, bashkimin e punëtorëve emigrantë me familjet e tyre”. Parimi udhëheqës në lidhje me bashkimin e familjeve është i drejtpërdrejtë: shtetet do të shqyrtojnë më një frymë pozitive dhe humane kërkesat e paraqitura nga persona që dëshirojnë të bashkohen me pjesëtarët e familjes së tyre, duke i dhënë rëndësi të veçantë kërkesave me karakter urgjent (si të ardhurat nga persona të sëmurë apo të moshuar). Në këtë kuptim, shtetet duhet të thjeshtojnë sa është e mundur procedurën administrative për ato persona që vuajnë nga sëmundje apo për të moshuarit dhe duhet të specifikojnë se kush mund të konsiderohet, për

---

<sup>25</sup> Shih Aktin Final të Helsinkit të datës 1 gusht 1975, pjesën në lidhje me bashkëpunimin në fushën e ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë dhe mjedisit, seksioni 6 "bashkëpunimit në fusha të tjera" - aspektet ekonomike dhe sociale të punëtorit migrant.

qëllimet e bashkimit familjar, pjesëtar i familjes.

Në Kreun “*Martestat midis qytetarëve të shteteve të ndryshme*”, trajtohet në mënyrë indirekte fusha e veprimit të dispozitave që i përkasin bashkimit familjar ku përcaktohet që shtetet anëtare duhet të zbatojnë në mënyrë të barabartë dispozitat e miratuara për bashkimin e familjeve pasi të kenë analizuar kërkesat e paraqitura nga persona të ardhur nga vendet anëtare të ndryshme me qëllimin e transferimit, pas martesës, të rezidencës së përhershme të tyre dhe të fëmijëve të mitur në shtetin e rezidencës normale. Kjo dispozitë përcakton se shtetet duhet t’u sigurojnë këtyre familjeve dhe fëmijëve të tyre të mitur, lindur nga këto bashkime, mundësinë që të transferojnë rezidencën e tyre në shtetin ku njëri nga to është rezident. Ky parim, megjithëse i kufizuar në qëllimin e tij, pasi aplikohet vetëm për personat që synojnë të martohen dhe që vijnë nga vende anëtare, është i një rëndësie të veçantë. Pra Akti Final i Helsinkit formulon një detyrim të përgjithshëm për shtetet nënshkruese që të lejojnë me të gjitha mundësitë njësine familjare përmes institutit të ribashkimit familjar.

Karta Sociale Europiane, e miratuar nga Këshilli i Europës në vitin 1986 mbron të drejtat e njeriut në kontekstin social dhe ekonomik dhe gëzon një influencë të madhe në politikat sociale në Europë<sup>26</sup>. Karta është zëvendësuar pjesërisht nga Karta Sociale Europiane, e rishikuar për Shtetet që e kanë nënshkruar në maj të vitit 1996 dhe ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 1999. (Saccucci.A,2002:151) Karta mbron një sërë të drejtash sociale dhe ekonomike, duke përfshirë kushtet e punës, kushtet e shpërblimeve, mbrojtjen e

---

<sup>26</sup> Karta u miratua në versionin final në datë 3 prill 1996, duke e vendosur hapjen për nënshkrim në 3 Maj 1996. Karta ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1999. Karta u hartua si një Konventë autonome qëllim pjesërisht të zëvendësuar Kartën 1961 dhe protokollin, dhe pjesërisht për të bashkë-ekzistojnë me ta. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë ratifikuar Kartën e rishikuar sociale. Ratifikime shihni faqen e internetit të Këshillit të Evropës.

të miturve, të të rinjve dhe grave, të sigurisë sociale, shërbimeve shtetërore sociale dhe të drejtat e punonjësve emigrantë dhe të familjes së tyre për mbrojtje dhe mbështetje sociale (neni 19), duke përfshirë kështu edhe bashkimin familjar. Për sa i përket fushës së zbatimit të Kartës, duhet thënë që dispozitat e përmbajtura në të zbatohen për të gjithë punonjësit.

Në nenin 16 të Kartës Sociale përcaktohet se familja, si bërthama themelore e shoqërisë, ka të drejtën e mbrojtjes së duhur sociale, juridike dhe ekonomike për të garantuar zhvillimin e saj të plotë. Në mbështetje të nenit 16, Karta në nenin 19 përcakton që punëtorët emigrantë, qytetarë të një prej Palëve Nënshkruese të saj dhe familjet e tyre, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe mbështetjes në territorin e çdo Pale Nënshkruese. Shtojca e Kartës. në lidhje me këtë artikulli, nënvizon që koncepti i “familjes së një punonjësi emigrant” përfshin të paktën bashkëshortin/en e punëtorit emigrant dhe fëmijët e pamartuar, përderisa konsiderohen të mitur në shtetin pritës dhe janë në ngarkim të punëtorit. Karta edhe pse njeh të drejtën e familjes për të pasur mbrojtje sociale, ekonomike dhe juridike, të plotë, (neni 16), ajo nuk i detyron shtetet që të lejojnë bashkimin familjar. Karta kërkon që “për sa të jetë e mundur”, të thjeshtojnë procesin e bashkimit familjar (neni 19)<sup>27</sup>. Në thelb, Karta Sociale Europiane përbën një perspektivë më të detajuar se aktet e tjera ndërkombetare dhe ato rajonale, dhe mundësia e bashkimit familjar përmes institutit të bashkimit familjar të punonjësve emigrantë përbëjnë parakushtet kryesore për të lejuar ruajtjen efektive të bërthamës familjare. (Colacino,2004:7) Por pavarësisht kësaj,ky formulim “për të thjeshtësuar sa më shumë” nuk është detyrues.

---

<sup>27</sup> Shih nenin 16 të Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961 me titull "E drejta e familjes për mbrojtje sociale, ligjore dhe ekonomike", ajo është ndryshuar pjesërisht nga Karta e ndryshuar, por përmbajtja e dispozitës ka mbetur i njëjtë.



### **2.3.1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)**

Një nga aktet më të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila ka vendosur në fokusin e vëmendjes së saj familjen dhe të drejtat e saj. Respektimi i jetës familjare garantohet nga neni 8, i cili konsiderohet dhe si neni kryesor dhe më i rëndësishmi në trajtimin e rasteve të emigracionit. Neni 8 i Konventës është i lidhur ngushtësisht jo vetëm me të drejtën për të lëvizur dhe për të krijuar familje, por edhe me nenin 3 të saj (Konventës Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut) ku përcaktohet se refuzimi i pranimi dhe dëbimi i të huajit ligjërisht rezident është i papranueshëm dhe në mbështetje të nenit 1 përcaktohet se dispozita specifike të Konventës mund të aplikohen edhe të huajve. Të drejtat dhe liritë e parashikuara nga pjesën e partë të Konventës duhet të njihen për të gjithë individët që ndodhen nën juridiksionin e secilit nga shtetet që e kanë nënshkruar këtë Konventë dhe duhet të zbatohen edhe për të huajt sipas së njëjtës jurisprudencë të gjykatës. Fusha e zbatimit zgjerohet jo vetëm tek personat pjesëtarë të familjes ligjore, por edhe ato pjesëtarë të familjes natyrore.

Konventa mbron individin nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve publike dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton mbrojtje për personat e prekur nga ndërhyrjet e autoriteteve publike në jetën e tyre familjare. Një ndërhyrje nga ana e autoriteteve mund të konsiderohet e ligjshme vetëm në raste të veçanta të parashikuara nga neni 8 paragrafi 2 i KEDNJ-së, ku përcaktohet se “Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

Dispozita në fjalë, sipas praktikës së Gjykatës imponon detyrimin pozitiv për të mbrojtur jetën familjare dhe për të ndërmarrë masa pozitive në këtë drejtim. Kjo dispozitë imponon detyrimin negativ të shtetit për të mos ndërhyrë në jetën familjare të individit<sup>28</sup>. (Gomien, D. 2006) Pra, dispozita legjitimon ndërhyrjet e bëra nga autoritetet shtetërore, veçanërisht në kuadrin e ushtrimit të fuqisë së kontrollit të hyrjes dhe qëndrimit të të huajve vetëm në kuadër të mbrojtjes së interesave individuale dhe kolektive. (De Salvia M.1994:171)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka ndërhyrë në disa raste për të verifikuar nëse vendimi i dhënë nga një shtet ishte në kundërshtim me të drejtën e bashkimit familjar dhe në të gjitha rastet kriteri juridik i ndjekur nga GJEDNJ-ja bazohet në nenin 8 të të KEDNJ-së dhe mund të përmblihet në pesë pyetjet e mëposhtme

1. ka një jetë të vërtetë familjare?
2. ka ndërhyrje në jetën familjare?
3. është e parashikuar nga ligji kjo ndërhyrje?
4. ndjek një qëllim ligjor n kjo ndërhyrje?
5. nëse kjo ndërhyrje është e «nevojshme në një shoqëri demokratike»? që do të thotë e justifikuar nga një nevojë sociale e ngutshme dhe në proporcion me qëllimin e legjitimitetit të ndjekur. (Zanobetti Pagnetti.A,2004:552)

Sipas Gjykatës, e drejta e bashkimit familjar nuk duhet të konsiderohet si një e drejtë e pakushtëzuar, por duhet vlerësuar rast pas rasti për të parë balancimin e interesave të shtetit për kontrollin e flukseve migratore. (Angelini.F,2011:167) Pavarësisht nëse ka të bëjë me pranimin apo dëbimin e të huajve, sipas Gjykatës, është detyrë e shtetit të sigurojë

---

<sup>28</sup> Shih vendimet e Gjykatës të 28 Maj 1985 Abdulaziz, Cabales dhe Baljandalic. Mbretëria e Bashkuar, vendim i datës 9 shkurt 1996 Gul c. Zvicra dhe gjykimi i 28 nëntor 1996 Ahmut c. Netherlands. Vendimet janë në dispozicion në faqen e internetit: <http://www.echr.coe.int>.

respektimin e rendit publik, në veçanti të kontrollojë hyrjen, qëndrimin dhe largimin e të huajve. Në një shoqëri të konsideruar demokratike, vendimet në lidhje me të drejtën e bashkimit familjar të mbrojtur nga neni 8 duhet të jenë të nevojshme, të justifikuara nga një nevojë sociale dhe mbi të gjitha, proporcionale me qëllimin ligjor të ndjekur.<sup>29</sup> Por çfarë nocioni të familjes pranon Konventa dhe në çfarë kushtesh kjo ndërhyrje është e justifikuar?

Në kuadër të përgjigjes së kësaj pyetje nga vjen në ndihmë dhe praktika e Komisionit Europian për të drejtat e njeriut (tashme nuk ekziston me si institucion), dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburg-ut, sipas së cilës “*elementi themelor i jetës familjare është i përbërë nga përfitimi i përbashkët i prindit dhe i fëmijës në shoqërim reciprok*”. Pra, edhe në rastet kur kemi të bëjmë me fëmijë jashtë martese, ato janë gjithsesi pjesë e njësisë së familjes nga momenti i lindjes<sup>30</sup>.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në vlerësimet e saj rast pas rasti, perqafon një koncept evolutiv dhe të ndryshuar të familjes sipas kushteve të ndryshme sociale, ekonomike dhe fetare. (Angelini.F,2011:167) Nocioni i familjes përfshin në radhë të parë bashkëshortin. Vendimet e Gjykatës përfshijnë në nocionin e familjes edhe disa marrëdhënie personale të zgjeruara: për shembull, në lidhje me familjet *more uxorio* trajton jo vetëm bashkëjetesën reale, por edhe faktorë të tjerë si qëndrueshmëria e marrëdhënieve, ekzistenca e fëmijëve dhe pavarësia ekonomike<sup>31</sup>. Megjithatë Gjykata, edhe duke vlerësuar efektivitetin e raporteve nuk duket se e ka shtrirë këtë zgjerim edhe për çiftet *more uxorio*

<sup>29</sup> Shih çështjen *Beldjoudi kundër Frances*, nr. 234-A p.27.V. dhe çështjet e *Abdullazis, Cabales dhe Balkandalic kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 94; qershor 21, 1988 *Berrehab kundër Holandës*, nr. 138; shkurt 18, 1991 *Moustaquim kundër Belgium*, n. 1993.

<sup>30</sup> Shih çështjen *Berrehab kundër Holandës* e datës 21 qershor 1988, A 138.

<sup>31</sup> Shih çështjen *Marckx kundër Belgjikës* e datës 16/03/1975 A.6833/74 dhe çështjen *Emonet e të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* e datës 16/12/2007, A. 39051/03.

homoseksuale, të cilat vazhdojnë të jenë të diferencuara nga çiftet heteroseksuale<sup>32</sup>. Pavaresisht kesaj në vendimin *Karner kundër Austrisë* e vitit 2010 Gjykata ka vendosur që nevoja për të ruajtur nocionin e familjes tradicionale mund të justifikojë një trajtim të ndryshëm atëherë kur është një kusht i nevojshëm për arritjen e objektivit që duhet garantuar (Lamce: 2011, 102-103)., ndërsa në vendimin *Kopf kundër Austrisë* Gjykata ka vendosur që edhe një marrëdhënie sentimentale mes dy personave të të njëjtit seks futet në konceptin e jetës familjare<sup>33</sup>.

### **2.3.2. Roli dhe vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për implementimin e të drejtës së bashkimit familjar**

Gjatë analizimit të vendimeve të GJEDNJ-së, vërehen dallime themelore ndërmjet rasteve të dëbimit të të huajve që ndikojnë në situatat familjare të konsoliduara dhe rasteve të refuzimit të lejes së qëndrimit që kërkohet me anë të bashkimit familjar. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka gjykuar disa raste që trajtojnë shkeljen e nenit 8 të KEDNJ-së dhe ka dhënë vendime të ndryshme. Kështu në çështjen *Gul kundër Zvicrës*<sup>34</sup>, ku trajtohet rasti i dy prindërve turq të cilët kishin kërkuar bashkimin me djalin e tyre gjashtë-vjeçar të mbetur në Turqi, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës nga ana e Zvicrës, e cila kishte mohuar të drejtën e bashkimit familjar të kësaj familjeje. Arsyetimi i Gjykatës ishte i bazuar në vullnetin e prindërve për ta lënë të rritet atje dhe periudha e gjatë e kaluar nga fëmija në Turqi. Pra, nuk ka patur shkelje të nenit 8 KEDNJ.

---

<sup>32</sup>Shih çështjen *D.P. kundër Mbretërisë së Bashkuar* e datës 11/09/1986, A.12513/86, dhe çështjen del 22/04/1997 *X e Y kundër Mbretërisë së Bashkuar* A.21830/83.

<sup>33</sup>Shih çështjen A.40016 / 98 e datës 24/07/2003, dhe gjykimi A. 30141/04. i datës 24/06/2010,

<sup>34</sup>Shih çështjen *Gul kundër Zvicrës* e datës 19 shkurt 1996, p. 1573 par. 38.

As në çështjen *Omojudi kundër Mbretërisë së Bashkuar* e datës 20.02.2010, ku konstatohen te njejtat rrethana, Gjykata nuk konstaton shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së. Në çështjen *Berrehab kundër Holandes* trajtohet rasti i një vajze të një qytetari maroken e cila kishte lindur dhe kishte jetuar gjithmonë në Holandë<sup>35</sup>. Në këtë çështje Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut u shpreh që megjithëse dëbimi mund të jetë i justifikuar nga të gjitha pikëpamjet, edhe nga mirëqenia ekonomike e vendit, ky vendim *nuk ishte proporcional*, sepse do të ndikonte patjetër në raportet familjare. (Nascimbene.B,2002:861)

Gjykata ishte e vetëdijshme për nevojën e një ekuilibri mes të drejtës së jetës familjare dhe sovranitetit ekskluziv të Shtetit për të rregulluar hyrjet, qëndrimet dhe dëbimet e të huajve. Prandaj, jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut karakterizohet nga shqetësimi konstant për të mbajtur një ekuilibër mes dy interesave: nga njëra anë interesi i personit të dëbuar për të mos u ndarë nga familja dhe nga ana tjetër interesi i shteti për të larguar një person që vendos në rrezik rendin publik. Në fakt, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ripohon të drejtën e shtetit për të vlerësuar në mënyrë të pavarur të drejtën e bashkimit familjar, por trajton në mënyrë të veçante çështjen e dëbimeve, duke u shprehur se dëbimi duhet bërë duke iu përgjigjur kritereve të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, sidomos kur interesat në lojë janë të larta, si e drejta e bashkimit familjar.

Pra, është detyrë e shtetit ose e gjykatës, sipas rasteve, të bëjnë një vlerësim të interesave të subjekteve në gjykim për të jetuar me familjarët e tyre, duke konsideruar “situatën e të interesuarit” një nga elementet themelore që duhet marrë parasysh. Epërsia e lidhjeve

---

<sup>35</sup> Për të parë vendimet e Gjykatës në rastet e pranimit, hyrjes dhe bashkimit ose dëbimit të shih çështjet Nr. 54273/00 *Boultif kundër Zvicrës* 3 gusht 2001 Çështja nr. 31465 / 99 *Sen kundër Holandës* e datës 21 dhjetor 2001.

familjare është konsideruar e rëndësishme në rastet e qëndrimit për një periudhë të gjatë kohore bashkë me familjarët e tij, në Shtetin ku i huaji ishte transferuar, për arsye shkollimi dhe punësimi. Në raste se i huaji ishte dënuar gjatë qëndrimit të tij në Shtetin pritës, për krime të ndryshme, atëherë Gjykata merr në konsideratë në dhënien e vendimit të saj, llojin e veprës penale të kryer, ashpërsinë dhe numrin e dënimeve, moshën në të cilën janë kryer dhe moshën ku i huaji ka hyrë në shtet, lindja apo jo në këtë shtet, natyra e lidhjeve familjare të krijuara, nga periudha e rezidencës, nga ndjekja e shkollës etj. Gjykata në çështjen *Moustaquim*, ku trajtohet rasti i një qytetari algjerian i cili ka mbërritur në Belgjikë në moshën dy vjeçare, ka konsideruar të nevojshëm dëbimin, pasi kishte kryer krime të shumtë kur ishte i mitur<sup>36</sup>. Në çështjen *Beldjoudi* trajtohet rasti i një qytetari algjerian i lindur në Francë dhe i martuar me një qytetare franceze, Gjykata ka vendosur që dëbimi nuk është proporcional me qëllimin, por konsiderohet i ligjshëm, duke marrë në konsideratë krimet e kryera<sup>37</sup>. Gjykata në çështjen *Nasri*, një qytetar i mbërritur në Francë në moshën dy vjeçare e ka konsideruar dëbimin jo proporcional, duke marrë parasysh kushtet subjektive të të huajt<sup>38</sup>. Këto vendime evidentojnë nevojën, për gjykatësin europian, përpara se të japë dëbimin, të vlerësojë konkretisht, rrezikshmërinë e individit dhe nën optikën e qëllimeve, të vendosura nga neni 8, të mbajë parasysh gjithmonë kushtet e jetës familjare të tij. (Angelini.F,2011:168)

---

<sup>36</sup> Shih çështjen nr. 1993 të *Moustaquim kundër Belgjikës* datë 18 shkurtit 1991

<sup>37</sup> Shih çështjen *Beldjoudi kundër Francës* i datës 26 mars 1992, nr. 234-A p.27.

<sup>38</sup> Shih çështjen *Nasri kundër Francës* date 13 korrik 1995, Nr, A.320 –B, p. 31

## **KAPITULLI III: E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR PËR QYTETARËT KOMUNITAR**

### **3.1. E drejta e bashkimit familjar në kuadër të lëvizjes së lirë të qytetarëve komunitar**

Mbrojtja e të drejtës së bashkimit familjar, ka marrë rëndësi në të drejtën komunitare nën aspektin e lëvizjes së lirë të personave, përmes shtrirjes së kësaj lirie te familjarët e qytetarëve komunitarë, që e ushtrojnë këtë të drejtë në bazë të dispozitave të Traktatit. (Bergamini.E,2006:356)

Në Traktat termi person identifikon të gjithë subjektet ekonomikisht aktivë që lëvizin për të kryer aktivitete ekonomik si të punësuar, të vetëpunësuar apo profesionistë të lirë. (Giubboni.S &Orlandini.G,2007:98) E drejta komunitare e ka zgjeruar gradualisht konceptin e lëvizjes së lirë, duke e shtrirë atë edhe te personat “ekonomikisht jo aktivë”, dhe tek të gjithë personat që kanë shtetësinë e një shteti anëtar (Canaj Bana, 2014). Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e konceptit të lëvizjes së lirë, në dy aspekte:

- a) duke shtrirë nocionin e përfituesve të lëvizjes së lirë dhe
- b) duke interpretuar në mënyrë të ngushtë kufizimet që Traktati i lejonte shteteve të vendosin si kufizime për këtë liri. (Rossi.L.S, 2005:304)

Aktiviteti interpretues i Gjykatës së Drejtësisë ka zgjeruar sigurisht numrin e subjekteve për të cilët zbatohet normativa komunitare në temën e lirisë së lëvizjes, dhe rrjedhimisht, numri i përfituesve të së drejtës së bashkimit familjar, ashtu siç është sanksionuar nga burimet e të drejtës komunitare.

Dispozitat e Traktatit që trajtojnë të drejtën e bashkimit familjar janë të ndara në tre grupe:

1. dispozitat që trajtojnë lëvizjen e të punësuarve (nenet 45 TFBE dhe në vijim)
2. dispozitat që trajtojnë punonjësit e pavarur dhe çdo qytetar që dëshiron të vendoset me të gjitha efektet në territorin e një shteti anëtar të ndryshëm nga shteti i tij, (nenet 49 TFBE dhe në vijim);
3. dispozitat që trajtojnë punonjësit e pavarur të cilët, pa u vendosur me të gjitha efektet në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës, ushtrojnë një aktivitet të ushtrimit të shërbimeve (Perazzo.G, 99) (nenet 56 TFBE dhe në vijim)

Tre disiplinat në fjale duhet të trajtohen në lidhje me nenin 21 (TFBE), që ka të bëjë me nënshtetësinë e shteteve të Bashkimit Europian.

Lëvizja e lirë e personave gëzon një rregullim ligjor jo vetëm nga dispozitat e Traktatit por dhe nga aktet nënligjore. Rregullorja Nr. 1612/68 “*Për lëvizjen e lirë të punonjësve brenda Bashkimit Europian*”, i akordon punonjësve që zhvendoset në një vend tjetër, të drejtën e bashkimit familjar, e drejtë kjo e cila përcaktohet në nenet 10-12 të Rregullores. (Foglia.R,2000:487) Kjo rregullore mund të konsiderohet si burimi i parë ligjor që duhet të merret në konsideratë në lidhje me të drejtën e bashkimit familjar. Sipas Rregullores Nr. 1612/68 e drejta e bashkimit familjare i rezervohet qytetarëve komunitar, banues në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës, duke e kufizuar këtë vetëm për një kategori punëtorësh.

Në baze të nenit 1 të rregullores e drejta e bashkimit familjar i njihet shprehimisht individëve që hyjnë në territorin e një vendi tjetër anëtar, për arsye punësimi, pra i njihet



vetëm të punësuarve. Kategoritë e subjekteve përfitues të të drejtës së bashkimit familjar zgjerohen në vitet në vijim nga Direktiva Nr. 73/148 BEE<sup>39</sup>, “*Për heqjen e kufizimeve të kalimit dhe të qëndrimit të qytetarëve të një shteti anëtar*” dhe nga tre Direktivat e vitit 1990, që i kanë njohur pothuajse të gjithë qytetarëve të shteteve anëtare të drejtën e lëvizjes dhe qëndrimit në territorin e përbashkët komunitar. (Mattera.A,1990 :448)

Rregullorja ka vendosur detyrimin për të qenë ekonomikisht të pavarur, pra për të pasur për vete dhe për familjarët të ardhura në nivelin minimal të mjaftueshëm për të mos pasur nevojë për ndihmë sociale nga shteti pritës ose, në mungesë, nivelin e pensionit minimal të ndihmës sociale, në mënyrë që të mos bëhet një barrë për asistencën sociale të shtetit pritës.

Të njëjtat kushte janë të sanksionuara edhe në Direktivën Nr. 2004/38 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të 29 prill 2004, (Iglesias Sánchez.S,2007:913) që kishte qëllim të diktonte një disiplinë uniforme të hyrjes, të qëndrimit dhe të masave të dëbimit dhe të largimit. Direktiva disiplinon hyrjen dhe qëndrimin e qytetarëve komunitar në shtetet anëtare dhe përcakton kriteret e ushtrimit të të drejtës së lëvizjes së lirë. Baza juridike e krijimit të kësaj directive është neni 45 dhe neni 21 i TFBE-së.

Qëllimi i direktivës është që të disiplinojë të drejtën e bashkimit familjar dhe përcaktimin e qartë të natyrës së formaliteteve që lidhen me lëvizjen e lirë, duke thjeshtëzuar ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar, duke ngushtuar shtrirjen e përjashtimeve dhe duke eliminuar diferencimin e mëparshëm mes të punësuarve, të vetëpunësuarve, studentëve dhe personave të tjerë në mënyrë që të thjeshtëzohet kuadri

---

<sup>39</sup> Shih Direktiven Nr. 73/148 të BE-së.

komunitar normativ ligjor. (Pascucci.L,2007:1044) Kjo ndërhyrje ka pasur si qëllim final barazimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve komunitarë brenda Bashkimit European me lëvizjen e lirë të qytetarëve të një shteti brenda territorit të tij.(Liakopoulus.D,2007:107) Direktiva nuk është kufizuar në “kodifikimin” e të drejtës në fjale dhe në jurisprudencën e Gjykatës, por ka futur edhe disa risi të rëndësishme, të cilat do t’i evidentojmë në vazhdim. Tema që po trajtojmë karakterizohet nga një proces i vazhdueshëm evolues dhe është ende e ndjeshme ndaj interpretimeve të zgjeruara rast pas rasti nga ana e Gjykatës së Drejtësisë. (Giubboni.S &Orlandini.G,2007:64)

### **3.2. Subjektet aktive të të drejtës së bashkimit familjar**

Të drejtën e bashkimit familjar mund ta ushtrojnë qytetarët komunitar vetëm në rastin kur ato kanë ushtruar një prej lirive themelore të parashikuara në Traktatin e BE-së. Direktiva Nr. 2004/38/BE ka përgjithësuar të drejtën e lëvizjes dhe qëndrimit për të gjithë qytetarët e Bashkimit European, duke i njohur të gjithë këtyre individëve të drejtën e bashkimit familjar me familjarët e tyre, duke tejkaluar në këtë mënyrë legjislacionin sektorial në fuqi. (Bergamini.E,2006:307) Gjykata ka deklaruar që në qoftë se e drejta e bashkimit familjar, në kontekstin e të drejtës së lëvizjes së lirë, është ushtruar nga një qytetar komunitar në një vend anëtar duke iu referuar të drejtës komunitare atëherë e njëjta e drejtë mund të ushtrohet edhe në momentin e rikthimit në shtetin e qytetarit, sepse edhe rikthimi konsiston në ushtrimin e të drejtës së lëvizjes së lirë. Kjo liri zbatohet vetëm për qytetarët komunitarë.

Bazuar në aktet ligjore në fuqi, kategoritë e qytetarëve të Bashkimit European, të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e Bashkimit Familjar janë konkretisht:

1. të punësuarit
2. të vetëpunësuarit dhe ato që ushtrojnë një aktivitet të dhënies së shërbimeve
3. Studentëve
4. personat e quajtur ekonomikisht jo aktivë, përfshirë këtu punonjësit me pagesë dhe pa pagesë që kanë pushuar aktivitetin e tyre profesional, apo personat që kanë të ardhura ekonomike të mjaftueshme.

Në lidhje me kategorinë e të punësuarve Gjykata e Drejtësisë, bazuar në një jurisprudencë të konsoliduar, ka vendosur që nocioni “punëtor” të mos i lihet interpretimit të normave të shteteve anëtare, por t’i lihet një interpretim në nivel komunitar, të përcaktuar në bazë të kriterëve të të drejtës komunitare. Krijimi i një nocioni në nivel komunitar shmang rrezikun që normat kombëtare të përjashtojnë njëanshmërisht kategori të caktuara personash nga fusha e zbatueshmërisë së Traktatit. Për këtë arsye, është cilësuar “punëtor” brenda kuptimit të Traktatit një person që *“kryen, gjatë një kohe të caktuar, në favor të një tjetri apo në drejtim të një tjetri, punë dhe shërbime”*<sup>40</sup>. (Daniele.L,2000:146)

Parimi i lëvizjes së lirë të punëtorëve përfshin, gjithashtu, të drejtën e qytetarëve të shteteve anëtare të lëvizin lirisht në territorin e një shteti tjetër anëtar, të drejtën për të pasur një banesë me qëllim punësimi, ose të drejtën e lëvizjes së lirë të punëtorëve me qëllimin “për t’ju përgjigjur ofertave të punës efektive” (neni 45). Duke mbajtur në konsideratë faktin që një person mund të hyjë në territorin e një shteti tjetër anëtar vetëm për të kërkuar punë, mund të lindin pikëpyetje interpretuese për sa i përket kohëzgjatjes në të cilën ky qytetar mund të kërkojë punë, me problematikat që rrjedhin për mbajtjen apo heqjen e të

<sup>40</sup> Shih çështjen *Bettray* cituar. Gjykimi cit *Lawrie-Blum*, paragrafët 16 dhe 17, çështjen Unger, cituar. pika 1. çështjen *Levin*, cit, paragrafët 15, 16 dhe 17 n; çështjen *Antonissen*, cit, paragrafi 22. çështjen *Martinez Sala*, cit., paragrafi 32 .

drejtës së qëndrimit. Gjykata ka mbajtur një interpretim më liberal të kësaj normativës në rastin kur ka kaluar afati por i interesuari jep prova se vazhdon kërkimin e punës dhe ekzistojnë mundësi efektive për t'u punësuar, kështu që nuk mund të detyrohet të largohet nga territori i shtetit pritës<sup>41</sup>.

Jurisprudenca përcakton një afat kufizimi *gjashtë muaj* për qëndrimin e një individi për të kërkuar punësim, por normativa kombëtare përcakton se ky afat është “në parim i pamjaftueshëm” dhe në qoftë se qytetari “paraqet prova se vazhdon kërkimin e punës” dhe ka “mundësi efektive për t'u punësuar, nuk mund të detyrohet që të largohet nga territori i shtetit anëtar në të cilin ndodhet”<sup>42</sup>. Gjykata në interpretimin e saj ka saktësuar që afati është i mjaftueshëm kur merret parasysh nevoja, për të interesuarit, për të pasur një kohëzgjatje për kalimin nga kufiri në vendin e tyre të destinacionit, si dhe të informohet për formalitetet administrative që duhet të përmbushë<sup>43</sup>. Megjithatë, Gjykata ka sqaruar, gjithashtu, që e drejta e qëndrimit dobësohet në rastet kur qytetari ka pamundësi objektive për të gjetur punë, ose kur është quajtur i paaftë për punë për shkak të sëmundjes<sup>44</sup>.

Ky arsyetim që ka dhënë Gjykata vlen edhe për lirinë e vendosjes në një shtet dhe lirinë e dhënies së shërbimeve. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë ka shtrirë mënyrat e zbatimit edhe të vendosjes në një Shtet, si dhe të lirisë së ofrimit të shërbimeve.(Daniele.L,2000:115).

---

<sup>41</sup> Gjykata në datë 20 shkurt 1997 në çështjen e *Komisionit kundër Belgjikës* ka deklaruar shkeljen e nenit. 39 nga Belgjika për mbajtjen në fuqi të legjislacionit e cila ka dhënë një detyrim të shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare kërkojnë punë në Belgjikë për të lënë automatikisht nga vendi pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh.

<sup>42</sup> Shih vendimin e 26 shkurtit 1991, *Antonissen*, cituar çështjen vendimin e 7 korrik 1976 *Watson dhe Bellmann*, 118/75 shkakt Nr. 1976, f. 1185 ..

<sup>43</sup> Shih çështjen e 12 dhjetorit 1989, *Messner*, 265/88, 1990 p. 4209.

<sup>44</sup> Shih çështjen e 26 maj 1993 *Tsiotras*, rasti C-171/91, f. I-2925.

Studentët janë kategoria tjetër e subjekteve që përfitojnë nga e drejta e lëvizjes së lirë. Në çështjen *Gravier*,<sup>45</sup> Gjykata ka vendosur që “në veçanti, hyrja në formimin profesional mund të favorizojë lëvizjen e lirë të personave brenda Bashkimit Evropian”<sup>46</sup>. Traktati nuk i atribuon studentëve të drejtën e lëvizjes së lirë dhe të qëndrimit dhe kjo e drejtë i'u është njohur nga aktet normative, në fillim nga direktiva Nr. 93/96, më tej nga neni 7 paragrafi 1, shkronja c) e direktivës 2004/38<sup>47</sup>, me kushtin e të qenit të regjistruar në një institut publik ose privat, të njohur ose të financuar nga shteti anëtar pritës, për të ndjekur një kurs studimesh, përfshirë edhe formimin profesional që ai dhe familja e tij të kenë një siguracion për sëmundjet, siguracion i cili mbulon të gjitha rreziqet në shtetin pritës. (Groussot.X,315) Gjykata në jurisprudencën e saj për një kohë të gjatë ka shmangur marrjen parasysh të studentëve si përfitues të shërbimeve. Ajo ka deklaruar se e drejta e lëvizjes së lirë i takon vetëm atyre që futen në “zonën gri”, mes studimit dhe punës, që përbëhet nga formimi profesional<sup>48</sup>. Megjithatë, përfshirja më vonë e kategorisë së studentëve në subjektet “ekonomikisht jo aktivë” nuk është shoqëruar me kritika dhe probleme doktrinale, (Mattera.A,1990 :448) sepse studentët konsiderohen gjithsesi persona “përfitues të shërbimeve” dhe “përfitues” të veprimtarive ekonomike.

---

<sup>45</sup> 13 shkurt 1984, çështja nr. 293/83, 1985.

<sup>46</sup> Shih paragrafin 24 të çështjes *Gravier*.

<sup>47</sup> Dispozitat e përmbajtura në këtë Direktivë fillimisht ishin të përfshira në Direktivën 90/366 / EEC në lidhje me të drejtën e qëndrimit për studentët, por direktiva u anulua nga Gjykata e Drejtësisë në Parlamentit Evropian

<sup>48</sup> Shih paragrafin 30 të çështjes *Gravier* ku realizohet një analizë e jurisprudencës për aftësimin profesional tregon se ajo është kuptuar në një kontekst më të gjerë. Shih vendimin *Blaizot* të 2 shkurtit 1988 në rast 24/86 1988, p. 379 ku Gjykata e njohur se edhe arsimi universitar përbëjnë aftësimin profesional me përjashtim të kurseve të caktuara të veçanta të studimit të dizajnuara për të përmirësuar njohuritë e përgjithshme në vend që të përgatiten për një profesion. Shih gjithashtu çështjen *Humbel* e 27 shtator 1988, rasti 263/86 *Coll.*, 1988, p. 5365 ku gjykata, ndërsa ajo mohon se mësimi i ofruar nga një institut teknik përbën pjesë të sistemit të arsimit kombëtar mund të klasifikohet si një ofrimin e shërbimeve për shkak se i mungon elementi thelbësor i pagës, pala tjetër pranon që një Kursi i studimeve të mesme, një pjesë e së cilës është e përgjithshme dhe jo mësimi trajnimit profesional, mund të konsiderohet si trajnim profesional nëse karakteristika të tilla si një e tërë.

Bazuar në disiplinën aktuale, studentëve u rezervohet një regjim më liberal se ai i kategorive të tjera të përfituesve<sup>49</sup>. Kështu së pari në nenin 8 paragrafi 3, studentëve u kërkohet të “paraqesin deklaratën” e të ardhurave ekonomike, të konsideruara si të mjaftueshme, në mënyrë që të mos bëhen një ngarkesë financiare për shtetin pritës, dhe shtetet anëtare nuk “mund të kërkojnë që kjo deklaratë të ketë një shumë të caktuar të ardhurash”. Në radhë të dytë, legjislacioni kërkon që studenti të jetë i regjistruar në një institut të njohur (publik apo privat), për të marrë kryesisht një formim profesional. Bëhet fjalë për kërkesa themelore në mënyrë që studenti të mos bëhet ngarkesë në sistemin e asistencës sociale, dhe instituti të jetë i “njohur” si dhe në mënyrë që të evitohet fluksi i studentëve fals, të cilët në të vërtetë nuk ndjekin asnjë kurs, ose e ndjekin vetëm për të mashtruar normativën në temën e lirisë së lëvizjes.

Personat ekonomikisht jo aktivë përbëjnë një kategori të veçantë të qytetarëve komunitare që shfrytëzojnë të drejtën e qëndrimit. Në kategorinë e personave ekonomikisht jo aktivë futen të punësuarit apo të vetëpunësuarit që dëshirojnë të qëndrojnë në shtetin pritës edhe pasi ka mbaruar veprimtaria e tyre e punës (që mund të konsiderohen persona ekonomikisht aktivë formalisht), përfshirë këtu personat që kanë një pension pleqërie dhe që dëshirojnë të s’postohen në një tjetër shtet anëtar të Bashkimit Europian si dhe personat që kanë, të ardhura ekonomike të mjaftueshme për vete dhe për familjarët e tyre, që u krijon mundësin që të mos bëhen ngarkesë e asistencës sociale të shtetit anëtar pritës.

Të drejtën e qëndrimit në shtetin anëtar sipas nenit 17 të direktivës 2004/38, përpara maturimit të një periudhe pesë vjeçare të vazhdueshme qëndrimi e gëzon i punësuarit apo i

---

<sup>49</sup> Shih nenet 8 paragrafi 3 pika 2 të Direktivës 2004/38.

vetëpunësuar, i cili në momentin e mbylljes së aktivitetit ka mbërritur moshën e parashikuar nga shteti anëtar pritës për të pasur të drejtën e pensionit të pleqërisë, ose i punësuar i cili del në pension të parakohshëm, me kushtin që të ketë kryer aktivitetin e tij të paktën në dymbëdhjetë muajt e fundit dhe të ketë qëndruar në mënyrë të vazhdueshme për më shumë se tre vite. Për rrjedhojë kushtet që këto punonjës duhet të respektojnë janë të njëjta me kushtet e vendosura nga normativa e mëparshme në këtë temë. Në mënyrë specifike, është e nevojshme që personi të ketë zhvilluar një aktivitet në dymbëdhjetë muajt e fundit dhe të ketë qëndruar pa shkëputje për më shumë se tre vite në shtetin anëtar pritës.

Kategoria e dytë e personave jo aktivë nga ana ekonomike, siç është përmendur, përbëhet nga personat që kanë të ardhurat ekonomike të mjaftueshme apo të të ashtë-quajturit, subjekte jo aktive. Direktiva i jep në mënyrë të përgjithshme të drejtën për të qëndruar qytetarëve të shteteve anëtare që nuk përfitojnë nga kjo e drejtë, duke u mbështetur në nene të tjera. Sipas nenit 7 paragrafi 1 shkronja d, gëzon të drejtën e qëndrimit për një periudhë më shumë se tre muaj, çdo qytetar i Bashkimit European, me kushtin që *“të ketë të ardhurat ekonomike të mjaftueshme, për vete dhe për familjarët e tij, në mënyrë që të mos bëhet një ngarkesë për sistemin e asistencës sociale të shtetit anëtar pritës gjatë periudhës së qëndrimit, dhe të jetë i siguar nga sëmundjet dhe i mbuluar nga rreziqet në vendin pritës”*. Dispozita në fjalë i favorizon çdo qytetari të Bashkimit European dhe familjarëve të tij, të drejtën e qëndrimit në territorin e Bashkimit European.

### **3.3. Subjektet pasive të të drejtës së bashkimit familjar**

Direktiva 2004/38 përcakton lirin e lëvizjes dhe të qëndrimit jo vetëm në aspektin individual, por edhe aspektin familjar dhe gëzon shtrirje edhe tek familjarët që nuk janë

qytetarë të shteteve anëtare të Bashkimit Europian. (Angelini.F,2011:173) Direktiva njeh dhe garanton të drejtën e familjarëve të shoqërojnë dhe të bashkohen me bashkëshortin, duke legjitimuar qëndrimet afatshkurtra si dhe ato afatgjatë<sup>50</sup>, në ndryshim nga qytetarët ekstra-komunitarë, të cilët mund të shoqërohen nga familjarët e tyre vetëm në qëndrimet afatgjata. Aktualisht në bazë të normave aktuale familja e qytetarit komunitar që ushtron të drejtën e lëvizjes së lirë dhe të qëndrimit është e përbërë nga:

- a) bashkëshorti/ja,
- b) partneri *edhe homoseksual* që ka me qytetarin e Bashkimit Europian një bashkejetese të regjistruar në bazë të legjislacionit të një shteti anëtar, atëherë kur legjislacioni i shtetit pritës e baraspeshon bashkimin e regjistruar me martesë.
- c) pasardhësit direkt në moshë më të vogël se 21 vjeç ose në ngarkim edhe ato të bashkëshortit/es apo partnerit/es
- d) paraardhësit direkt në ngarkim dhe ato të bashkëshortit/es apo të partnerit/es. Shtetet anëtare nuk bëjnë asnjë diferencë në njohjen e këtyre të drejtave.
- e) çdo familjari tjetër, me çfarëdo nënshtetësie, por që është në ngarkim ose bashkëjeton në shtetin e origjinës me qytetarin komunitar.
- f) partneri me të cilin qytetari komunitar ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe e të provuar.

---

<sup>50</sup> Shih nenet 6 paragrafi 2. 7 paragrafi 1 të Direktivës 2004/38.



### 3.3.1. Bashkëshorti/ja

Të gjithë titullarët aktivë të të drejtës së bashkimit familjar gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar me bashkëshortin i cili ndodhet në territorin e një shteti anëtar të ndryshëm nga shteti i tij përkatës<sup>51</sup>.

Në trajtimin e “bashkëshorteve”, është e qartë që normat komunitare në fjalë kufizohen në kërkesën e ekzistencës së një lidhjeje formale martese që bashkon subjektin në fjalë me qytetarin e një shteti anëtar me të cilin kërkohet bashkimi familjar. Kështu nocioni i bashkëshortit/es ka qenë një nga më të përpunuarit nga Gjykata e Drejtësisë, ndërsa nocioni i “martesës” ka qenë i përdorur në aktet komunitare, por pa i dhënë një përcaktim. (Bariatti.S,2007:51) Kjo temë tashmë është e përjashtuar nga kompetencat e Bashkimit European dhe që tashmë u është lënë shteteve. Njohja e martesës i atribuohet të drejtës ndërkombëtare private.

Normativa komunitare në lidhje me bashkimin familjar bazohet në një vizion ligjor-formal të raportit në çift (Pallaro.P,2001:261) dhe jo në dinamikat e jetës private dhe familjare të individëve (Lamce: 2011, 97). Në çështjen *Diatta* të vitit 1985, Gjykata ka vendosur që quhet “bashkëshort/e”, derisa kufizimi formal i martesës nuk është zgjidhur nga një vendim zyrtar divorci, kjo edhe kur ky kufizim nuk korrespondon me ndarjen e

---

<sup>51</sup> Bashkimi familjar është në fakt i garantuar nga neni 2 i Direktivës 2004/38. Më parë, bashkimi familjar me bashkëshortin parashikohet në nenin 10, paragrafi 1 të Rregullores 1612/68 të punësuarit; në nenin 1 të Direktivës 68/360 lidhje me pezullimin e kufizimeve në lëvizjes dhe qëndrimit të punëtorëve të Shteteve Anëtare; në nenin. 2 Dir. 73/148 për të vetëpunësuarit; me nenin 3 të Rregullores 1251/70 dhe Direktivën 75/34 të personave të punësuar të cilët mbeten në territorin e një Shteti Anëtar kur dalin në pension; në nenin 1 i Direktivës 72/194 zgjeruar fushëveprimin e Direktivës së 25 shkurtit 1964 mbi koordinimin e masave të veçanta që kanë të bëjnë me lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj që janë të justifikuar në bazë të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik; në nenin 1 i Direktivës 75/35 zgjeruar fushëveprimin e Direktivës 64/221, për bashkërendimin e masave të veçanta që kanë të bëjnë me lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj të cilët për arsye të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik ushtrojnë të drejtën e qëndrimit në territorin e një shteti tjetër anëtar pasi ka të angazhuar në punë të pavarur; Nenet 1, par. 2. Direktivat 90/364 dhe 90/365 të bëjnë me qytetarët jo-ekonomikisht aktive që përfitojnë, megjithatë, e drejta e qëndrimit; në nenin 1 i Direktivës 93/96 studenteve.

jetës shtëpiake që duhet të ekzistojë në bazën e çdo raporti bashkëshortor”.(Franco.P,2007:531) Ky interpretim i nocionit të bashkëshortit/es është konfirmuar edhe në vendimin *Singh*<sup>52</sup> të Gjykatës së Drejtësisë,. Në këtë çështje, Gjykata i njeh kërkuarit të drejtën e qëndrimit, sepse bazuar në normat komunitare ai konsiderohej si “bashkëshort” i një qytetareje të një shteti anëtar, akoma i padivorcur<sup>53</sup>.

Problemet dhe polemikat u shfaqën në momentin kur duhen përfshirë brenda nocionit “martesë”, të bashkëshorteve dhe nocionet “bashkëjetesë” apo bashkimeve *de facto*. Gjykatës së Drejtësisë në çështjen *Reed* iu kërkuar për herë të parë baraspeshimi i bashkëshortit/es me bashkëjetuesin e faktit ose *more uxorio*, qëndrueshmërisht bashkëjetues me punëtorin emigrant qytetar komunitar, me qëllimin e dhënies së lejes së qëndrimit. Gjykata në këtë rast ka vendosur që “në mungesë të çdo prove të një evolucioni social të karakterit të përgjithshëm që do të justifikonte interpretimin e zgjeruar, dhe në mungesë të çdo prove të kundërt në rregullore, duhet thënë që duke përdorur fjalën “bashkëshort/e”, neni 10 i rregullores i referohet vetëm raportit të bazuar në martesë”<sup>54</sup>. Ajo pranoi

---

<sup>52</sup> Gjykata e Drejtësisë, vendimi i datës 7 korrik 1992, në rastin 370/90 ka vlerësuar rastin e *Z. Singh* i cili ishte i martuar me një shtetas britanik dhe zhvendosën në Gjermani për të kryer një veprimtari tregtare. Këtu Mr. Singh mori një urdhër dëbimi të përkohshëm pas divorcit nga shtetasi anglez, i ndjekur më pas nga një urdhër përfundimtar. Pyetja përpara Gjykatës kishte për qëllim që të përcaktonte nëse, në këto rrethana, e drejta komunitare është aplikuar për *Singh* dhe në qoftë se, për këtë arsye, në bazë të kësaj të fundit, ai kishte të drejtë për të drejtën e qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar si "bashkëshort" i një qytetari britanik. Gjykata, pasi konstatoi se martesë nuk ishte fiktive pohoi se kjo martesë u prish në vitin 1989 dhe nuk ka asnjë ndikim në çështjen e përmendur dhe fokusohet në të drejtën e qëndrimit të periudhës para datës së gjykimit.

<sup>53</sup> Në qoftë se në kohën e gjykimit të çështjes së Gjykatës, lidhja e martesës ishte shpërbërë me vendim të formës së prerë që ka forcën e *res judicata*, atëherë qytetari indian nuk mund të shfrytëzojë legjislacionin komunitar si burim të mbrojtjes së të drejtës së tij për të qëndruar në territorin anglez . Kështu Zoti Singh kishte plotësisht të drejtë për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar.

<sup>54</sup> Shih shtojcën në çështjen *Reed* paragrafi 15.

megjithatë, të drejtën e qytetarit anglez të ketë pranë vetes bashkëjetuesen e tij dhe e përfshin në “avantazhe sociale” neni 7, paragrafi 2 e rregullores nr. 1612/68<sup>55</sup>.

E njëjta procedurë është ndjekur edhe në vendimin *Arauxo-Dumay*<sup>56</sup>, që kishte lidhje me gruan e një zyrtari të vdekur, pak pasi ishin bashkuar formalisht në martesë, pas shumë vitesh bashkëjetese. Zonjës i ishte refuzuar pensioni familjar për shkak të jetëgjatësisë së shkurtër të martesës, në bazë të kohëzgjatjes së gjatë të kufizimit civil të kërkuar, duke mos i dhënë peshë marrëdhënies së gjatë të mëparshme të faktuar. Gjykata e Shkallës së Parë ka miratuar vendimet e Gjykatës, duke shtuar që e quan veten kompetente për të zgjeruar interpretimin juridik të termave precizë të përdorur në statut, me qëllimin që të fusë në nocionin “martesë” situata bashkëjetese ose bashkime *de facto*, apo nocionin “bashkëshort” apo “grua” në situatën e një bashkëjetese. (Lamce: 2011, 102).

Ky modifikim mund të lindë vetëm nga një ndërhyrje e ligjvënësit komunitar, atëherë kur ky i fundit e kërkon si mundësi. (Pallaro.P,2001:269) Me anë të këtij vendimi Gjykata nuk ka qëllim të pengojë jetën familjare apo unitetin familjar të personave jo të bashkuar në martesë, por refuzimi lind, për shkak se në rastet më të shumta, kërkesa bëhet veçanërisht për motive ekonomike.

### 3.3.2. Bashkëjetuesi/ja

---

<sup>55</sup> Shih nenin 7 paragrafi 2 Rregullores 1612/68. sipas të cilit punëtori migrant duhet të gëzojnë të njëjtat “avantazhe sociale dhe taksa si punëtorët vendas”. Gjykata, në interpretimin e saj se mundësia për një punëtorit migrant për tu bashkuar me partnerin e tij/saj të pamartuar do të kontribuojë në integrimin e tij në mjedisin e vendit pritës dhe në realizimin e lëvizjen e lirë të punëtorëve ”

<sup>56</sup> Shih çështjen *Arauxo-dumay kundër Komisionit* të datës 17 qershor 1993 në rasti T-65/92, Rec. 1993 p. II-597

Risia më e madhe e futur në direktivë është tejkalimi i identifikimit të familjes me atë tradicionale, e bazuar domethënë në martesën e heteroseksualëve, përmes shtrirjes së kualifikimit familjar edhe për “partnerin që ka lidhur me qytetarin e Bashkimit European një bashkejetese të regjistruar në bazë të legjislacionit të shtetit anëtar”. (Bergamini.E,2006:361)

Direktiva zgjeron nocionin e familjes në krahasim me nenin 10 dhe 11 të Rregullores. Nr. 1612/68, duke përfshirë edhe partnerët e lidhur me shtetasin komunitare nga një bashkim i regjistruar atëherë kur legjislacioni i shtetit pritës e barazon me martesën. Direktiva nuk i imponon shteteve asnjë modifikim në legjislacionin e brendshëm mbi të drejtën familjare dhe nuk ka asnjë nen specifik për të njohur si bashkëshortë persona të të njëjtit seks<sup>57</sup>. Pra, normativa aktuale zgjeron konceptin e “familjarëve” vetëm për format e bashkëjetesës të njohura nga legjislacioni kombëtar dhe neni 2 paragrafi 2, tregon qëllimin e mëtejshëm të politikave ligjore për të mos krijuar mekanizma ndërhyrëse në zgjedhjet e bëra nga shtetet anëtare, të tilla që t’i kushtëzojë në temën e modeleve familjare jo tradicionale. (Caggia.F, 2006:73)

Kjo Direktivë parashikon që të zbatohet normativa komunitare për ato shtete ku bashkimet e regjistruara janë të barazuara me martesën, por nuk qartësohet se çfarë kuptohet me “e barabartë me martesën”. (De Schutter.O,2008:61) Duke mbajtur në konsideratë lirinë e interpretimit dhe të veprimit që anë shtetet në këtë çështje, si dhe në sovranitetin e shtetit në qartësimin e përmbajtjes së normativës së brendshme mbi bashkimet e regjistruar, duhet thënë që marzhi i lirisë së veprimit mbi “barazimin” i duhet lënë objektivisht dhe ekskluzivisht vetë shteteve anëtare. (Iglesias Sánchez.S,2007:927)

---

<sup>57</sup> Shih çështjen *D dhe Suedia kundër Këshillit*.

Sipas Direktivës, atëherë kur bashkimi i regjistruar barazohet me martesën, ushtrimi i të drejtës së hyrjes dhe qëndrimit shtrihet në këtë mënyrë edhe tek pasardhësit dhe paraardhësit. (De Cesari.P,2009:33) Njohja është pjesë e politikës së legjislacionit të shtetit anëtar të destinacionit, jo atë të origjinës. Ky aspekt mund të sjellë frikë në transferime për një person që është i lidhur në një bashkejetese të regjistruar nga frika që nuk do të mund të marrë me vete partnerin e tij aty ku ky bashkim nuk është i njohur (Lamce: 2011, 96).

### **3.3.3. Pasardhësit**

Legjislacioni komunitar në fuqi pranon bashkimin me familjen e tyre, në përputhje me nenin 2 paragrafi 2 të Direktivës: pasardhësit direkt të moshës më të vogël se 21 vjeç ose në ngarkim të bashkëshortit/es ose partnerit/es sipas pikës b)”. Fëmijët e punëtorit, për të shoqëruar ose për t’u bashkaur me prindin, duhet të jenë në një moshë më të vogël se 21 vjeç ose sidoqoftë, të jenë në ngarkim të tij. (Bergamini.E,2006:361) Fusha e zbatimit të direktivës për sa i përket kësaj kategorie të tretë të familjarëve është më e kufizuar se neni 10 Rregullores 1612/68, sepse nuk i referohet “pasardhësve” në kuptimin e përgjithshëm, por “pasardhësve direktë”, (domethënë vetëm fëmijët), duke përjashtuar në këtë mënyrë pasardhësit e tjerë, si për shembull, nipërit.(Urbano De Sousa.C,2000 :109)

Kufizimi i moshës i vendosur për fëmijët shënon një tendencë për të përqendruar parimin e respektit për jetën familjare dhe vendos pengesa të panevojshme për lëvizjen e punëtorëve. Ky kufizim përcakton pamundësinë për pasardhësin që nuk është më në ngarkim të prindit të gëzojë nga dispozitat komunitare në këtë fushë. Në rastin kur fëmija i e kalon moshën 21 vjeç, mund të pranohet në bashkimin familjar vetëm në qoftë se tregon

se është në ngarkim të punonjësit, ose ka jetuar në vendin e origjinës në të njëjtën banesë të punëtorit emigrant. (Lasok. K.P.E,2002:100)

Kjo dispozitë, nga njëra anë kërkon të realizojë kontrollin e fluksit të emigrantëve brenda Bashkimit European, por nga ana tjetër është në kundërshtim me parimin themelor të respektit të jetës familjare. Jemi përpara një tjetër zgjerimi apo shtrirje të së drejtës tek pasardhësit, pasi njihet bashkimi familjar me një qytetar të një shteti anëtar i “pasardhësve direkt dhe atyre të bashkëshortit apo bashkëjetuesit”. Në këtë kuptim, direktiva shënon një hap të rëndësishëm përpara drejt mbrojtjes “së konsiderueshme” të familjes, pasi mbrohen lidhjet efektive dhe autentike duke tejkaluar ekzistencën e lidhjeve legjitime<sup>58</sup>. Për sa i përket kushtit tjetër të kërkuar “në ngarkim”, gjykata ka pasur mundësi të shprehet në çështjen *Lebon*<sup>59</sup>, duke treguar tendencë për një interpretim të zgjeruar të këtij koncepti. Gjykata ka vendosur që “kushti i familjarit në ngarkim vërehet nga një situatë faktike” dhe jo juridike.

Bëhet fjalë për një familjar të mbajtur ekonomikisht nga punëtori, pa qenë e nevojshme të sqarohen motive, apo të pyetet në qoftë se i interesuari është në gjendje të mbajë veten e tij duke ushtruar një aktivitet fitimprurës: konsiderohet, ndër të tjera, në “ngarkim”, familjari që në pamundësi të tij, nuk është në gjendje të përmbushë nevojat e tij. Kjo vlen edhe në rastet kur subjekti zgjedh të jetojë në varfëri dhe të mbahet nga punonjësi me të cilin është i lidhur me një lidhje gjaku. (Lasok. K.P.E,2002:103) Në përputhje me nevojat e mësipërme komunitare, Gjykata e Drejtësisë ka shtrirë më tej konceptin e

---

<sup>58</sup> Duhet theksuar se Rregullorja 1612/68 nuk u jep të drejtën e hyrjes dhe qëndrimit fëmijëve të lindur jashtë martese që dëshirojnë të shoqërojnë prindërit e tyre kur ata zhvendosen për punë në një shtet tjetër anëtar; edhe kur se fëmija ishte konsideruar "një djalë i familjes", ai nuk mund të përdorni të legjislacionit të Komunitetit në fjalë.

<sup>59</sup> Shih çështjen Nr 316/85 të 18 qershor 1987. P. 2811.

“pasardhës në ngarkim”, deri në përfshirjen e fëmijës me të meta të punëtorit emigrant edhe pse e ka kaluar moshën e pjekurisë. Me këtë vendim, Gjykata ka shënuar fillimin e një praktike gjyqësore konstante, e cila përfshin edhe fëmijët me handicap, tashmë të rritur, të punëtorëve emigrantë në nocionin e “pasardhës në ngarkim”, e përmbajtur në normativën komunitare në fushën e lëvizjes së lirë.(Bergamini.E,2006:362)

### **3.3.4. Paraardhësit**

Përveç bashkëshortit, bashkëjetuesit/es dhe pasardhësve, legjislacioni komunitar u njeh të drejtën e bashkimit familjar edhe paraardhësve direktë në ngarkim të punëtorit dhe të bashkëshortit/es apo partnerit/es. Kjo normativë zbatohet pa dallim shtetësie duke bërë që edhe qytetarët e shteteve të treta mund të përfitojnë nga kjo e drejtë. (Urbano De Sousa.C,2000 :109) Kushti që kërkohet me qëllim zbatimin e të drejtës së bashkimit familjar është që të jenë “në ngarkim të punëtorit emigrant.(Caggia.F, 2006:66). Edhe për këtë kategori direktiva ngushton fushën e zbatimit, pasi nuk i referohet përgjithësisht paraardhësve, por atyre në ngarkim të punëtorit komunitar ose të bashkëshortit/es apo partnerit/es të regjistruar, duke përjashtuar në këtë mënyrë, për shembull, gjyshërit.

Familjarët në ngarkim, pra, edhe paraardhësit munden nga ana e tyre të ndërmarrin një aktivitet ekonomik, qoftë punësimi apo autonom, dhe që nga ky moment të mos quhen më në ngarkim. (Lamce: 2011, 99). Në legjislacion vërehet mungesa e parashikimit të të drejtës së bashkimit familjar për paraardhësit e studentit që ka shfrytëzuar lëvizjen e lirë, parashikim që ndjen akoma konotacionin “ekonomik” të lëvizjes së lirë. (Bergamini.E,2006:356)

Pranohen vetëm paraardhësit e studentëve në një qëndrim të shkurtër, deri në tre muaj. Prindërit e studentit, atëherë kur duan të bashkohen me të, kanë të drejtën të kenë një hyrje të përshpejtuar në shtetin anëtar pritës.

### **3.3.5. Përfituesit e të drejtave**

Legjislacioni komunitar u njeh të drejtën e bashkimit familjar duke i konsideruar si përfitues të kësaj të drejte edhe disa kategori të tjera familjarësh të punëtorit komunitar.

Sipas nenit 3 në kategorinë e përfituesve të të drejtës përfshihen:

- a) çdo familjar, cilado qoftë shtetësia e tij, të papërcaktuar në nenin 2 paragrafi 2, nëse është në ngarkim apo bashkëjeton, në vendin e origjinës, me shtetasin komunitar që ka të drejtën e qëndrimit për motive të përgjithshme ose në qoftë se motivet shëndetësore imponojnë asistimin e shtetasit komunitar;
- b) partneri me të cilin shtetasi i Bashkimit European ka një lidhje të qëndrueshme që mund të provohet.

Kjo kategori familjarësh dhe partnerësh nuk gëzon garantimin e të drejtës se bashkimit familjar që të shoqërojnë apo të bashkohet me shtetasin komunitar, dhe për këtë arsye e drejta e tyre e hyrjes dhe e qëndrimit është në fakt në diskrecion të shtetit anëtar. (Pascucci.L,2007:1045) Në lidhje me kategorinë e parë të familjarëve, Direktiva nuk i detyron shtetet anëtare që të pranojnë në territorin e tyre, duke qenë e parashikuar që shtetet vetëm të favorizojnë hyrjen. (De Schutter.O,2008:66)

Këto familjarë nuk kanë të drejtën për të hyrë apo qëndruar në shtetin anëtar pritës, por shtetet janë të detyruara t'i favorizojnë pranimin. (Lasok. K.P.E,2002:498) Kështu, punëtori në këto raste që duhet të tregojë kushtet në ngarkim të këtyre familjarëve dhe të



ketë mundësinë ekonomike për t'i mbajtur. Kërkesa themelore për këtë kategori për të shoqëruar shtetasin komunitar është ajo e të qenit në ngarkim apo të bashkëjetojë, në vendin e origjinës, me shtetasin e Bashkimit Europian, përfitues të së drejtës së qëndrimit për arsye të përgjithshme apo për rastet kur motive të rënda shëndetësore imponojnë që shtetasi komunitar ta asistojë personalisht. (Urbano De Sousa.C,2000 :109) Kjo zbatohet edhe për prindërit që nuk janë në ngarkim, ose për fëmijët me moshë më të madhe se 21 vjeç (dhe që ndërkohë nuk mund të kenë të drejtën e hyrjes apo qëndrimit, sipas nenit 2, par. 2) në qoftë se jetojnë me shtetasin komunitar.

Kategoria e dytë përbëhet nga “partneri me të cilin shtetasi i BE ka një marrëdhënie të qëndrueshme lehtësisht të provueshme” nuk konsiderohet familjar në kuptim të nenit 2 paragrafi 1. (Giubboni.S &Orlandini.G,2007:52) Janë shtetet anëtare që në bazë të një analize të situatës familjare të çiftit që ka një marrëdhënie të qëndrueshme të vendos nëse do t'i atribuoj të drejtën e bashkimit familjar ose jo. (Urbano De Sousa.C,2000 :111) Kujdesi i legjislacionit komunitar për të drejtën e bashkimeve familjare është rezultat i një qëndrimi ligjor formal, në të cilin Gjykata e Drejtësisë ka përkufizuar konceptet e “bashkëshortit/es” dhe “jetë familjare”, duke e lidhur të drejtën e bashkimit familjar me situatën e ligjeve kombëtare të secilit shtet anëtar: në qoftë se normat e të drejtës së brendshme pranojnë bashkëjetuesin *more uxorio* të qendroje me shtetasin e tij, njësia e familjes është e garantuar edhe në nivel komunitar. (Lamce: 2011, 100). Referimi tekstualisht në direktivë i partnerit të pamartuar duke se krijon mundësinë e bashkimit familjar edhe për çiftet homoseksuale. (Pascucci.L,2007:1045) Në përgjithësi, për problemin e bashkëjetesave *more uxorio*, i referohemi ndjeshmërisë se ndryshme të

rregullave kombëtare, duke e konsideruar si të vetmin arbitër të aftë të zgjedhë kategoritë e “familjarëve” që mund të pranohen për bashkim familjar. (Lamce: 2011, 97).

### **3.4. Te drejtat qe perfitojne familjaret perfitues pas bashkimit familjar. E drejta e levizjes se lire dhe e qëndrimit**

Familjarët e shtetasit komunitar të cilëve u është akorduar e drejta e bashkimit familjar, pavarësisht shtetësisë, gëzojnë të drejtën të lëvizin lirisht në territorin e shtetit ku shtetasi komunitar banon. (Cellamare.G,2006:104) Familjarët gëzojnë të drejtën e trajtimit në mënyrë të barabartë me trajtimin që i rezervohet personit me të cilin bashkohen<sup>60</sup>; përsa i përket familjarëve që janë shtetas të një shteti anëtar, kjo rrjedh nga parimi i përgjithshëm i mosdiskriminimit në bazë të kombësisë, i sanksionuar direkt në Traktat (ish neni 12). (Adinolfi.A,2000:152) Në nenin 24 të direktivës, përcaktohet se familjarëve u jepet e drejta e trajtimit të barabartë kundrejt shtetasve të një shteti në fushën e zbatimit të Traktatit.(Giubboni.S &Orlandini.G,2007:54)

Nga ky rregull kemi vetëm dy përjashtime:

1. Kur emigrantët nuk kanë akses në asistencën sociale tre muajt e parë të qëndrimit
2. Kur nuk kanë ndihma ekonomike për vazhdimin e studimeve.

E parë në këtë këndvështrim duhet të theksohet se direktiva paraqitet shumë më kufizuese kundrejt jurisprudencës komunitare në akordimin e të drejtave persona përfitues. (Urbano De Sousa.C,2000 :122). Anëtarët e familjes së një shtetasi të Bashkimit European kanë të

---

<sup>60</sup> E drejta për trajtim të barabartë të punëtorëve migrantë është e sanksionuar në nenin 24 të Direktivës 2004/38. Ky parim më parë është zbatuar për qytetarët Komunitarë dhe familjen tyre, por ai tani është një "vlerë e shtuar" për rregullat e Traktatit falë interpretimin të Gjykatës së Drejtësisë. Gjykata ka përqafuar integrimin e plotë të shtetasit të huaj në Shtetin Anëtar pritës.

drejtë të lëvizin lirisht brenda territorit të shtetit në të cilin banojnë. (Cellamare.G,2006:104) E drejta e rezidencës shtrihet, edhe për familjarët e punëtorëve të pranuar në bashkim familjar. (Lasok. K.P.E,2002:497) Pas një periudhe pesë vjeçare rezidence ligjore dhe të pandërprerë, familjarët fitojnë, njësoj si shtetasi komunitar, të drejtën e qëndrimit të përhershëm. Kjo e drejtë autonome qëndrimi prezantohet si një risi e parashikuar nga direktiva 2004/38, e cila ka plotësuar një boshllëk në këtë sektor. (Guild.E,2006:51)

Familjari gëzon të drejtën e qëndrimit deri në tre muaj së bashku me shtetasin komunitar, pa asnjë kusht, përveçse posedimit të vizës ose pasaportës së vlefshme. E drejta e qëndrimit i jepet në të njëjtën mënyrë shtetasit komunitar dhe familjarit të tij, jo komunitar për një periudhë qëndrimi më të gjatë se tre muaj. Në legjislacionin komunitar është parashikuar që familjari përfiton të drejtën e qëndrimit të përhershëm, në qoftë se qëndron ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme për pesë vite në territorin e shtetit, së bashku me shtetasin e Bashkimit Europian. (Angelini.F,2011:167) Këtë të drejtë familjari e mban edhe në rastet kur shtetasi komunitar lëviz, divorcohet, ose anulon martesën ose bashkimin e regjistruar, të parashikuar nga normativa komunitare.

Perfundimi i lidhjeve familjare, vdekja apo transferimi i shtetasit komunitar ka pasoja në pozicionin juridik të anëtarëve të familjes së tij në shtetin pritës. Në rastin e vdekjes së shtetasit komunitar, e drejta e qëndrimit për familjarët mund të ruhet, nëse kanë jetuar për më shumë se një vit përpara vdekjes së personit. (Cellamare.G,2006:104) Në rastin kur punonjësi largohet nga shteti në të cilin është i punësuar, edhe familjarët e tij duhet të largohen nga ky shtet përveç rastit kur kanë marrë gjatë kësaj periudhe një leje qëndrimi autonome. (Adinolfi.A,2000:150)

Në çdo rast largimi i një shtetasi komunitar ose vdekja e tij nuk shkaktojnë humbjen e lejes së qëndrimit për fëmijët ose të prindit që ka pasur në ngarkim nëqoftëse fëmijët janë të regjistruar në një institut shkollor për të ndjekur studimet, deri sa ata të mbarojnë studimet.

### **3.5.E drejta për të ushtruar një aktivitet ekonomik**

Legjislacioni aktual komunitar parashikon që familjarët e pranuar në bashkimin familjar gëzojnë të drejtën të ushtrojnë një aktivitet ekonomik si të punësuar dhe si vetëpunësuar. (Giubboni.S &Orlandini.G, 2007:56). Në këtë kuptim, nuk ka rëndësi nëse shtetasi në fjalë punon, studion apo thjesht qëndron aty: familjarët mund të fillojnë aktivitetin e tyre të punës duke ndjekur të njëjtat formalitete që i krijohen shtetasve të shtetit në fjalë.

Kjo e drejtë ka treguar në mënyrë të veçantë për shtetasit e vendeve të treta që, meqenëse janë familjarë të shtetasve të BE-së, kanë një të drejtë “autonome” të rrjedhur nga Traktati për të kryer aktivitet pune. (Adinolfi.A,2000:366) Gjykata ka qartësuar që aktivitetet e punës nga ana e familjarit duhet të ushtrohen në të njëjtën mënyrë si punëtori ushtron të tijat, i cili është mbajtës i të drejtës së lëvizjes së lirë. Kjo shkakton që familjarët e pranuar në bashkimin familjar të kenë të drejtën e ushtrimit të aktiviteteve të punës, të nënshtruara në një regjim autorizimesh administrative dhe normash specifike të të drejtave profesionale, me kushtin që punonjësi të plotësojë “kushtin” e dyfishtë: posedimin e kualifikimeve dhe të diplomave të nevojshme, sipas ligjeve të shtetit anëtar pritës, për të ushtruar të tillë profesion, dhe të vërejë normativën specifike që disiplinon ushtrimin e

profesionit në fjalë, kushte që duhen të jenë të njëjta me ato të vendosura nga shteti anëtar pritës për shtetasit e tij.

Gjykata ka vendosur që familjari i punëtorit komunitar të pranuar për bashkim duhet të këtë hapësirë për të punuar në forma të barabarta me shtetasit e Shtetit anëtar pritës. Në fakt, trajtimi jodiskriminues “*konsiston në zbatimin ndaj personave këtu të përmendur të njëjtat dispozita rregulluese dhe administrative që zbatohen për shtetasit kombëtar, dhe të ndjekin të njëjtat praktika administrative*”. (Adinolfi.A,2000:143) Pra, legjislacioni aktual komunitar parashikon disa risi në lidhje me futjen në aktivitete pune: në radhë të parë, lejon familjarët të futen në çdo lloj aktiviteti ekonomik duke pranuar edhe punësimin, edhe punën autonome; në radhë të dytë, rinovon kategorinë e familjarëve që mund të futen në një aktivitet pune, pasi nuk kufizohet vetëm me bashkëshortin/en dhe fëmijët, por shtrihet edhe për çdo pjesëtar tjetër të familjes, të pranuar në bashkimin familjar. (Urbano De Sousa.C,2000 :122)

### **3.6. Kufizimet për hyrjen dhe qëndrimin për arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe shëndetit publik.**

Në nenin 45 paragrafi 3 TFBE përcaktohet se lëvizja e lirë e punonjësve mund të kufizohet vetëm për arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe shëndetit publik. (Giubboni.S &Orlandini.G,2007:72) Në këto raste shteti mund të refuzojë hyrjen e një punonjësi shtetas komunitar ose mund të marrë masa kufizuese të lëvizjes së lirë të punëtorit të pranuar tashmë në territorin e tij. Paragrafët e fundit të nenit 45 shkurtimisht përcaktojnë hapësirën brenda së cilës shtetet mund të vazhdojnë të ushtrojnë sovranitetin e tyre në temën e lëvizjes së lirë të punëtorëve.

Përmbajtja e këtyre kufizimeve është qartësuar që më parë tek Direktiva Nr. 64/221 mbi koordinimin e masave që i përkasin transferimit apo qëndrimit të të huajve, të justifikuar nga arsye të rendit publik, të sigurisë publike dhe të shëndetit publik, dhe tani nga Direktiva Nr. 2004/38 në kapitullin VI në nenet 27 e në vazhdim, në të cilin janë futur edhe parimet e afirmuara gjatë viteve nga Gjykata e Drejtësisë. (Angelini.F,2011:163) Kjo e fundit ka luajtur një rol vendimtar duke afirmuar që konceptet e paraqitura mund të interpretohen njëanshmërisht nga shtetet anëtare.

Gjykata, në të drejtën që i akordon shteteve që të përcaktojnë lirisht masat e nevojshme për të mbajtur rendin publik, në funksion të nevojave kombëtare, ka nënvizuar karakterin e veçantë të masave kufizuese të përdorura në bazë të këtyre kritereve. Këto nuk mund të konsiderohen si një kusht parandalues për hyrjen dhe qëndrimin, por si një përjashtim kundrejt ushtrimit të një të drejte të njohur nga Traktati. Pra duhet të jene shume te reduktuara dhe për rrjedhojë, këto koncepte duhet të interpretohen ngushtësisht. (Adinolfi.A,2000:123) Më tej, bazuar në këto kritere, Gjykata ka konfirmuar që liria e lëvizjes së personave mund të jetë e kufizuar vetëm nëse prania apo sjellja e punëtorit emigrant përbën një kërcënim efektiv dhe të rëndë për rendin publik: ky kërcënim duhet të jetë aktual dhe duhet t'i takojë “një prej interesave themelore të shoqërisë”. (Adinolfi.A,2000:370) Këto parime interpretuese të Gjykatës së Drejtësisë janë tashmë të kodifikuara në legjislacion.

Arsyet ekonomike nuk mund të futen në kategorinë e arsyeve të rendit publik (neni 27, pika 1 dir.2004/38). Janë gjithashtu të qarta parimet udhëzuese që cilat shtetet duhet të unifikojnë vendimet e marra në kufizim të lirisë së lëvizjes. Këto duhet t'i përgjigjen sjelljeve personale të individit dhe duhet të përmbajnë masa proporcionale me faktin e

kontestuar: nuk mund të merren për arsye të parandalimit të përgjithshëm. (Giubboni.S &Orlandini.G,2007:74) Në fakt, sjellja personale e emigrantit duhet të përfaqësojë një “rrezikshmëri reale, aktuale dhe mjaftueshmërisht të rënde që të cenojë interesat themelore të shoqërisë”. Gjykata me kalimin viteve ka afirmuar që në marrjen e masës së dëbimit, duhet të sigurohet respektimi i të drejtës themelore të mbrojtjes së jetës familjare. (Angelini.F,2011:163) E rëndësishme në këtë kuptim është pyetja e lindur së fundmi në qoftë se, për shembull, një qëndrim ilegal futet në motivet e “rendit publik” ose të “sigurisë publike”, të parashikuar nga neni 27 i direktivës 2004/38, që vendos një kufizim të lëvizjes së lirë të këtij personi<sup>61</sup>. Sipas Gjykatës, në çështjen C-33/07 *Jipa* e 10 korrik 2008 neni. 27 i Direktivës duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që Shtetet Anëtare edhe mund të imponojnë kufizime në lirinë e lëvizjes dhe qëndrimit të një qytetari të Bashkimit për arsye të "politikave publike" ose "të sigurisë publike", por kjo nuk sjell automatikisht, pa verifikim të "sjelljes personale" largimin e shtetasit komunitar.

Kjo ndodh vetëm atëherë kur verifikohen kushtet që sjellja personale e këtij shtetasi të përbëjë një kërcënim real, aktual dhe mjaftueshmërisht të rëndë, sa që kërcënon interesat themelore të shoqërisë dhe, nga ana tjetër, masa kufizuese që do të merret të jetë e mjaftueshme për të arritur realizimin e objektivit. I takon gjykatës të çështjes të përcaktojë nëse çështja që ka përpara paraqitet në këto terma.

Gjykata gjithashtu ka afirmuar që një shtet anëtar në mbrojtje të rendit publik, sipas nenit 48 dhe 56 të Traktatit, nuk mundet, të largojë nga territori i tij një shtetas të një tjetër shteti anëtar dhe as t'i refuzojë hyrjen në territorin e tij për mënyrën e sjelljes që, sikur të

---

<sup>61</sup> Shih çështjen C-33/07 *Jipa* e 10 korrik 2008 Coll., 2008 I-05157.

ishte kryer nga shtetasit e tij, nuk lë vend për masa shtrënguese ose masa të tjera konkrete dhe efektive që e luftojnë. Pra duhet të kemi trajtim të njëjtte për të dy shtetasit komunitare.

Sipas Gjykatës, në çështjen *Bouchereau*, e vitit 2012 mungesa e një dënimi penal nuk justifikon në vetvete masat shtrënguese të lirisë së lëvizjes nëse nuk paraqitet rreziku i ripërsëritjes<sup>62</sup>, ose nga fakti që përfaqëson një kërcënim aktual të rendit publik. Së fundmi, orientimi i Gjykatës duket më shtrëngues. Për t'u përmendur vlen edhe deklarata e fundit e Gjykatës në çështjen *Gaydarov*<sup>63</sup>, të 17 e nëntorit 2011, e cila ka deklaruar që nenet 21 TFBE dhe 27 të direktivës 2004/38, nuk përjashtojnë legjislacionin kombëtar që lejon kufizimet ndaj të drejtës së një shtetasi të një shteti anëtar të s'postohet në një tjetër shtet anëtar për shkak të një dënimi penal të marrë nga shtetasi në një shtet tjetër, për shembull, për trafik të lëndëve narkotike. Në varësi të gjendjes, përcaktohet, në radhë të parë, nëse sjellja personale e tij përbën një kërcënim real, aktual dhe mjaftueshmërisht të rëndë kundrejt interesave themelore të shoqërisë, në radhë të dyte, që masa shtrënguese e parashikuar të jetë e mjaftueshme për të garantuar realizimin e objektivit të vënë dhe të mos e tejkalojë atë që është e nevojshme për ta arritur, dhe së treti, që masa e marrë të mund të përbëjë objekt të rishikimit gjyqësor efikas që lejon verifikimin e ligjshmërisë, në fakt dhe në ligj, në lidhje me kërkesat e legjislacionit të BE-së.

Shteti në marrjen e masave të largimit duhet të ketë parasysh një sërë situatash, mes të cilave kohëzgjatja e qëndrimit në shtetin pritës, situata familjare dhe ekonomike, integrimi social dhe kulturor.

---

<sup>62</sup> Shih çështjen *Bouchereau*, e vitit 2012, paragrafet 28 dhe 29.

<sup>63</sup> Shih çështjen C-430/10, *Gaydarov*, të 17 nëntorit të vitit 2011.



Në këtë kuptim, të drejtat e emigrantit përforcohen në proporcion me kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit në Shtetin ku është transferuar, si dhe integrimin e tyre. Në bazë të kësaj parashikohet një “statut i përforcuar” për ato që kanë qëndruar për një kohë të gjatë në shtetin pritës, në mënyrë që masa e largimit të bëhet *extrema ratio* në dispozicion të autoriteteve të shtetit.

Ky është aspekti më inovativ i disiplinës së kufizimeve të lëvizjes së lirë kundrejt normave të mëparshme. Sipas dispozitave të direktivës, titullari i një të drejte qëndrimi të përhershme mund të largohet vetëm për motive “të rënda” të rendit ose të sigurisë publike<sup>64</sup>.

Kohet e fundit duket me rëndësi edhe vendimi i Gjykatës në çështjen *Aladzhev* me objekt ndalimin dhe largimin nga territori kombëtar si pasojë e mos pagesës së një detyrimi tatimor, masë e justifikueshme nga motive të rendit publik,<sup>65</sup> ku është vendosur që “e drejta e Bashkimit Europian” nuk përjashton një dispozitë ligjore të një shteti anëtar që lejon administratën e tij publike të ndalojë një shtetas të tij të largohet nga territori për shkak të mos shlyerjes së një detyrimi tatimor rëndues mbi një kompani në të cilën shtetasi është administrator. Megjithatë, me kushtin e dyfishtë që masa e marrë të jetë përgjigje, në prezencë të situatave të jashtëzakonshme, nga natyra apo nga madhësia e detyrimit, e një kërcënimi real, aktual dhe mjaftueshmërisht të rëndë kundrejt interesave themelore të

---

<sup>64</sup> Shih nenin 28, paragrafi 2 i Direktivës 2004/38 i cili thotë: “shteti anëtar mikpritës nuk mund të marrë një vendim dëbimi kundër qytetarëve të Bashkimit apo familjarët e tyre, pavarësisht nga kombësia e tyre, të cilët kanë të drejtën e qëndrimit Duke qëndruar në territorin e saj, përveçse për arsye të rënda të politikës publike ose sigurinë publike

<sup>65</sup> Shih çështjen C-434/10 të 17 nëntorit të vitit 2011, ende i pabotuar në Fletoren Zyrtare të BE-së.

shoqërisë dhe që objektivi i ndjekur të mos jetë i drejtuar vetëm në qëllimet ekonomike. I takon gjykatësit kombëtar të verifikojë që ky kusht i dyfishtë plotësohet.”

Mbrojtja e shtetasit komunitar emigrant shihet edhe më e përforcuar në rastet e moshave të mitura ose në rastet e qëndrimit më të gjatë se dhjetë vite, duke qenë se në këto raste, masa e largimit merret në prani të “motiveve thelbësore të sigurisë publike” (neni. 28, presja 3). Kjo bën që shteti të jetë i kufizuar në treguesin taksativ të ligjit “motive thelbësore” dhe në këtë rast do të shqyrtohet roli i Gjykatës së Drejtësisë në interpretimin e shtrirjes së këtij ndikimi, dhe gjithashtu edhe dallimin midis koncepteve të rendit publik dhe sigurisë publike<sup>66</sup>. Në këtë mënyrë përforcohet mbrojtja e këtyre dy kategorive, të emigrantëve dhe komunitarëve, duke parashikuar direktivën që motivet e rendit publik duhet të jenë për të parët të rënda dhe për të dytët thelbësore. Është e qartë që një dispozitë e tillë, duke vendosur si objektiv mbrojtjen e lidhjeve të një shtetasi komunitar dhe të gjithë pjesëtarëve të familjes së tij, cilado qoftë shtetësia e tyre në shtetin pritës, shkon drejt varësisë së masave të dëbimit të vëmendja e ligjit kundrejt jetës private apo familjare të vendosur me nenin 6 KEDNJ, si dhe nga neni 7 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

Nuk mund të jetë e njëjta shkallë mbrojtjeje dhe për emigrantin që ka ushtruar të drejtën e lëvizjes së lirë dhe qëndrimit të afat shkurtër, dhe të ketë bërë kërkesë për asistencë sociale, pasi këtë të drejtë e humb kur bëhet një rëndesë e tepërt për asistencën sociale (neni 14 paragrafi 1). Megjithatë, që rëndesa të konsiderohet “e tepërt” duhet parë nën parimin që nuk lejohet një masë automatike largimi, për të vetmin fakt që punëtori

---

<sup>66</sup> Deri më tani gjykata nuk ka pasur rastin për të dhënë një përkufizim të konceptit të sigurisë publike, rëndësia e cila dukshëm është rritur vetëm kohët e fundit.

emigrant apo familjari i tij të ketë bërë kërkesë për ndihme ekonomike në sistemin e asistencës sociale të vendit. (Giubboni.S &Orlandini.G,2007:57)

Disiplina e kufizimeve të justifikuara nga motive të *shëndetit publik*, është e përcaktuar në nenin 29 të Direktivës Nr.2004/38. Kufizimet e vendosura ndaj lëvizjes së lirë në këto raste vlejnë vetëm për të drejtën e hyrjes dhe për të penguar lindjen e të drejtës së qëndrimit (dhe jo për të drejtën e qëndrimit), sepse janë të zbatueshme vetëm brenda tre muajve nga data e hyrjes. Lista e përcaktuar në Direktivë që përmban përshkrimet e sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore që mund të rrezikojnë shëndetin publik është hedhur poshtë dhe është zëvendësuar me “sëmundje me potencial epidemik, siç përcaktohen nga dokumentet e Organizatës Botërore të Shëndetit, apo sëmundje të tjera infektive ose parazitare ngjitëse”. Qëndron, pra, referimi ndaj sëmundjeve infektive ose parazitare ngjitëse që janë objekt i dispozitave të parashikuara për shtetasit e shtetit pritës. Asnjë referim nuk i bëhet hipotezës më kontroverse, asaj të infektimit me SIDA, shumë herë e përdorur nga shtetet anëtare në justifikim të ndalimit të hyrjes. (Van Overbeek.W,1990:792)

### **3.7.Mënyrat e ushtrimit të të drejtës së bashkimit familjar**

Familjarët mund të bashkohen me shtetasin komunitar duke treguar një dokument identifikimi të vlefshëm në mënyrë që të përcaktohet kombësia dhe dokumentet që provojnë lidhjet familjare. Familjarët e shteteve të treta që dëshirojnë të shoqërojnë ose arrijnë shtetasin komunitar në shtetin pritës nuk gëzojnë të drejtën e hyrjes në këtë shtet. Në bazë të akteve nënligjore, shtetet mund t’i kërkojnë familjarit të pajiset me një vizë hyrëse, por duhet t’i ndihmojnë në thjeshtësimin e dhënies së kësaj vize. Familjarët, sapo të kenë

marrë vizën e hyrjes, duhet të futen në territorin e shtetit anëtar: pra, viza nuk është një titull qëndrimi, por vetëm hyrjeje. Nëqoftëse familjarët qëndrojnë në territorin e shtetit pritës për më shumë se tre muaj, atyre u jepet karta e qëndrimit në bazë të kërkesës<sup>67</sup>.

Megjithëse kjo fushë mbetet në diskrecionalitetin e shtetit anëtar, Gjykata e Drejtësisë ka patur mundësi të përcaktojë disa parime. Në veçanti, shteti nuk mund të largojë në kufi një qytetar jo-komunitar të papajisur me vizë në qoftë se ky i fundit paraqet prova për lidhjen si bashkëshort/e me një shtetas komunitar, përveç rastit kur paraqet kërcënim për rendin publik, sigurinë publike apo shëndetin publik dhe duhet t'i japë vizën edhe në pikat e hyrjes në territorin kombëtar<sup>68</sup>. Ndër të tjera, Gjykata ka vendosur që shtetasi komunitar mund të ketë kundrejt shtetit të origjinës të drejtën e hyrjes të familjarit të tij, gjithmonë nëse ka ushtruar të drejtën e lëvizjes së lirë dhe ka ndër mend të kthehet në vendin e tij të origjinës<sup>69</sup>. Nëse shtetasi komunitar nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lëvizjes së lirë, hyrja dhe qëndrimi i familjarit disiplinohet nga legjislacioni kombëtar dhe jo nga ai komunitar, duke konsideruar që në këto raste çështja është krejtësisht e brendshme dhe nuk paraqet asnjë lidhje me legjislacionin komunitar<sup>70</sup>.

Një problem që meriton të trajtohet në këtë punim konsiston në dëbimin e një familjari të një shteti të tretë për parregullsi të lidhura me hyrjen në shtet. Gjykata ka afirmuar që cenon të drejtën komunitare dhe respektimin e jetës familjare dëbimi i bashkëshortit/es për parregullsi administrative, të lidhura me formalitetet e hyrjes, kur martesë është reale dhe bashkëshorti/ja, duke u kujdesur për familjen, lejon shtetasin

---

<sup>67</sup> Karta është e vlefshme për pesë vjet dhe moszbatimi i aj shoqerohet me sanksione administrative

<sup>68</sup> Shih çështjen C-459/99 *MRAX* e 25 korrikut të vitit 2002 fq. I-6591.

<sup>69</sup> Shih çështjen *Singh kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

<sup>70</sup> Shih çështjen *Morson* e datës 27 tetor 1982

komunitar të ushtrojë të drejtën e tij të lëvizjes së lirë të garantuar nga Traktati. Gjykata ka tërhequr vëmendjen në lidhje me këtë problem. Në të tilla kushte, Gjykata ka vendosur që për të gëzuar të drejtat e nenit 10, të Rregullores Nr. 1612/68, pra bashkimin familjar shtetasi i një shteti të tretë, bashkëshort/e e një shtetasi të BE-së, duhet të qëndrojë ligjërisht në një shtet anëtar përpara spostimit në një tjetër shtet anëtar me shtetasin e BE-së. (Zanobetti Pagnetti.A,2004:552) Në vendimin *Akrich* dhe në vendimin *Jia*, Gjykata ka vendosur që shtetasi i shtetit të tretë për të përfituar nga dispozitat komunitare në temën e lëvizjes së lirë duhet të ketë qëndruar ligjërisht në njërin nga vendet anëtare të BE-së. Vetëm së fundmi, në çështjen *Metock*, (Costello.C,2009:587) është prononcuar nëse direktiva 2004/38 lejon shtetet anëtare të parashikojnë një kusht të përgjithshëm sipas së cilit, për të përfituar nga dispozitet e kësaj direktive, bashkëshorti/ja ekstra-komunitare e një shtetasi të BE-së duhet të ketë qëndruar ligjërisht në një tjetër shtet anëtar përpara se të shkojë në shtetin anëtar pritës. Orientimi i Gjykatës shihet tani i përmbysur kundrejt ngushtësisë që vendoste më përpara: nuk është një kusht i nevojshëm. Gjykata vendos që bashkëshorti/ja e një shtetasi komunitar që ka ushtruar të drejtën e lëvizjes së lirë, shoqëron ose arrin shtetasin në fjalë sipas nenit 3, pika 1 e direktivës 2004/38, dhe gëzon plotësisht dispozitat e kësaj direktive, pavarësisht nga vendi dhe data e martesës, apo nga situata në të cilën ai ka hyrë në shtetin anëtar pritës. Ky orientim konfirmohet më tej edhe nga vendimi Sahin.

Gjykata, në interpretimin e neneve 3 paragraf 1, 6 paragraf 2 dhe 7 paragraf 1, shkronja d) dhe 2, ka konfirmuar që dispozita të tilla të direktivës duhet të jenë të kuptuara si përfshirëse të familjarëve që kanë ardhur në shtetin anëtar pritës pavarësisht nga shtetasi i

BE-së dhe të kenë marrë cilësimin si familjarë të tij, duke kryer me këtë shtetas një bashkëjetesë vetëm pasi kanë hyrë në këtë shtet<sup>71</sup>.

Gjykata po kështu ka vendosur që refuzimi i përfitimit të Kartës së Qëndrimit si familjar i një shtetasi të BE-së për të vetmin motiv që të qëndrojnë në mënyrë provizore në këtë shtet pritës, në bazë të ligjeve kombëtare në fuqi në temën e azilit, duke i shtuar një tjetër kusht atyre të renditura në mënyrë taksative në nenin 10 paragrafi 2 të Direktivës<sup>72</sup>. Gjykata, në të lartpërmendurën çështje Sahin, afirmon që nenet 9 paragrafi 1 dhe 10 të Direktivës përjashtohen nga normativa kombëtare, në kuptimin e së cilës familjarët e një shtetasi të BE-së, të cilët nuk janë shtetas të një shteti anëtar dhe gëzojnë të drejtën e qëndrimit në zbatim të të drejtës komunitare, shënuar në nenin 7 n paragrafi 2 të direktivës, nuk mund të marrin një kartë qëndrimi si familjarë të shtetasit të BE-së, për shkak se janë të ligjëruar që të qëndrojnë provizorisht në shtetin anëtar pritës, në bazë të ligjit të këtij shteti në fushën e azilit.

---

<sup>71</sup> Shih paragrafin 33 të çështjes Sahin, ku, ndër të tjera, Gjykata thekson se është e parëndësishme në këtë drejtim, që në kohën e krijimit të marrëdhënies familjare një anëtar i familjes banon përkohësisht në Shtetin Anëtar pritës sipas ligjit të atij Shteti azilit.

<sup>72</sup> Shih paragrafët 39 dhe 40 të çështjes Sahin

## **KAPITULLI IV: E DREJTA E BASHKIMIT FAMILJAR PËR QYTETARËT JO-KOMUNITARË NË BASHKIMIN EUROPIAN**

### **4.1. Evoluimi i politikave komunitare mbi emigracionin e shtetasve të vendeve të treta**

Njohja dhe akordimi i të drejtës së bashkimit familjar për shtetasit e shteteve të vendeve të treta është konsideruar një sektor i panjohur për një kohë relativisht të gjatë, kjo për faktin se kjo e drejtë që ka qenë kompetencë ekskluzive e shtetit anëtar si sektor i bashkëpunimit ndërqeveritar. (Colacino, 2004:136) Në të drejtën komunitare mungonin dispozitat që mund të favorizonin edhe pse minimalisht harmonizimin e legjislacioneve dhe politikave të shteteve anëtare në sektorin e emigracionit, duke u lënë shteteve të drejtën e kontrollit të emigracionit. (Pascucci, L, 2008:117) Mungesa në Traktatin e Romës të një norme që parashikon një kompetencë komunitare mbi emigracionin ka qenë shkak kryesor që ka ndaluar Komunitetin Europian të miratojë instrumente juridike më efikase, të tilla që t'u vendosë shteteve anëtare detyrime të vërteta juridike. (Manca. L, 2005:6) Nisur nga pamundësia që tema e emigracionit të jetë objekt i transferimit në favor të komunitetit, shtetet kanë preferuar të kenë në këtë temë një bashkëpunim në nivel ndërqeveritar.

Orientimet e para që çuan drejt tendencës së akordimit të kësaj të drejte për shtetasit e shteteve të treta erdhën fillimisht nga udhëzimet e Gjykatës së Drejtësisë së Komunitetit Europian dhe nga disa iniciativa të izoluar. Ku si iniciativat më të rëndësishme janë:

1. Programi i Aksionit për punëtorët emigrantë dhe familjet e tyre i 18 shtatorit 1974, i cili rekomandonte heqjen e kontrolleve që zbatohen ndaj shtetasve të shteteve anëtare përmes kufijve ndërkomunitarë. (Manca, L, 2005:12)

2. Raporti i Komitetit *ad hoc* “Europa e qytetarëve”, që nxiste harmonizimin e ligjeve kombëtare mbi të huajt, në mënyrë që të realizonte progresivisht një politik të përbashkët në këtë temë. (Rossi. L.S, 2005:135)
3. Libri i Bardhë mbi realizimin e tregut të brendshëm, në të cilin Komisioni tregonte masat funksionale të heqjes së kontrollit në kufijtë ndërkombëtar.

Me miratimin e Traktatit të Maastricht ku në, në Shtyllën e Tretë, Titulli VI parashikohen dispozitat me lidhje me “bashkëpunimit në sektorët e drejtësisë dhe të punëve të brendshme”, shënohet një fazë e rëndësishme për politikën e emigracionit dhe të azilit në përgjithësi. (Tufano.M.L,2005:744) Ky traktat në Titullin VI parashikon detyrimin që shtetet anëtare të Komunitetit të fillojnë krijimin e një bashkëpunimi në sektorët e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, duke i përmbledhur me detaje në nenin K1. Ky nen vendos në “interes të përbashkët” disa çështje të lidhura me fenomenin e emigracionit. Futen në kuadër të kësaj kategorie sektorë si ai i kalimit të kufijve, trajtimi i shtetasve të ardhur nga vende të treta në lidhje me hyrjen, qëndrimin, lëvizjen si dhe bashkimin familjar<sup>73</sup>. (Nascimbene.B,2006:111)

Neni 3 i Traktatit të Maastrichtit i ka akorduar Këshillit kompetenca për të adoptuar politika në lidhje me qëndrimet ose aksionet e përbashkëta, kompetenca të cilat nuk kanë dhënë në praktikë rezultate të qenësishme. (Adinolfi.A,2000:125) Këshilli ka miratuar, në

---

<sup>73</sup> Sektorë të tjerë me interes të përbashkët të parashikuar nga neni 1 janë 1. politika e azilit; 2. rregullat për kalimin e kufijve të jashtëm të shteteve anëtare nga ana e njerëzve dhe 3. ushtrimin e kontrollit; 4. luftën kundër varësisë nga droga në masën që kjo nuk është e mbuluar nga 7, 8 dhe 9; 5. luftën kundër mashtrimit në shkallë ndërkombëtare për aq sa kjo nuk është e mbuluar nga 7, 8 dhe 9; 6. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile; 7. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale; 8. zakonet e bashkëpunimit; 9. bashkëpunimi policor në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogës dhe formave të tjera të rënda të krimit ndërkombëtar, duke përfshirë edhe nëse është e nevojshme disa aspekte të bashkëpunimit doganor, në lidhje me nivelin e organizimit Bashkimi i një sistemi për shkëmbimin e informacionit brenda një zyre të policisë evropiane.



lidhje më këtë çështje, disa rezoluta që orientojnë shtetet anëtare të vendosin disa norma me karakter shtrëngues për emigracionin e shtetasve të vendeve të treta si:

- 🇫🇷 Rezoluta e datës 1 Dhjetor 1992 mbi dëbimet,
- 🇫🇷 Rezoluta e datës 20 Qershor 1994 për kufizimet e pranimeve të shtetasve ekstra-komunitar për qëllime punësimi
- 🇫🇷 Rezoluta e datës 11 Qershor 1993 në lidhje me harmonizimin e politikave kombëtare në temën e bashkimit familjar. (Nascimbene.B,2006:104)

Por pavarësisht rezolutave të hartuara Traktati i Maastricht është kritikuar për mungesën e shprehjes së objektivave që duhen ndjekur në lidhje me disiplinën e temave në interes të përbashkët, si dhe mungesën e një kontrolli juridik që i referohet akteve të shtyllës së tretë.(Cellamare.G,2006:27)

Me hartimin e Traktatit të Amsterdimit, nuk u realizuan reformat e pritshme institucionale në kuadër të zgjerimit të BE-së, por në lidhje me politikat e migracionit ai solli disa risi të rëndësishme. (Angelini.F,2011:171) Kështu të gjitha dispozitat e Titullit III të këtij traktati i`u dedikuan emigracionit nga shtetet e treta, duke i atribuuar Komunitetit kompetenca më të gjera në këtë fushë<sup>74</sup>. (Nascimbene.B,2006:104) Në lidhje me sektorin e emigracionit dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta, Traktati i Amsterdimit bëri kalimin nga shtylla e tretë në shtyllën e parë,. Aktualisht këta sektor janë të disiplinuar nga Titulli IV i ri i quajtur “vizat, azili, emigracioni dhe të tjera politika të lidhura me lëvizjen e lirë të personave”<sup>75</sup>. (Manca.L,2005:165)

---

<sup>74</sup> Shih nenin 2, paragrafi 15 i Traktatit të Amsterdimit

<sup>75</sup> Shih pjesën IV të Traktatit të Amsterdimit ku kjo pjesë është konsideruar si pjesa e masave që synojnë në mënyrë progresive krijimin e një "zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë", shprehimisht të vendosur si një nga objektivat Bashkimi tenton të procedojë sipas nenit. 2 te Traktatit të Amsterdimit.

Dispozitat që do të miratohem menjëherë pas hyrjes në fuqi të Traktatit janë të të përcaktuara në nenin 63 të Traktatit. Kështu në pikën 3shkronja a) e nenit 63, trajton kushtet e hyrjes, të qëndrimit, normat dhe procedurat për lëshimin nga ana e shteteve anëtare, të vizave afatgjata dhe të lejeve të qëndrimit, përfshirë ato të dhëna me qëllimin e bashkimit familjar” (Liguori.A,2002:143) Në neni 63 pika 4 të Traktatit të Amsterdimit, trajtohen masat që përcakton të drejtat dhe kushtet e qytetarët të shteteve të treta për qëndrimin ligjërisht në një shtet anëtar. Neni 63 paragrafi 3 i Traktatit të BE-së i ka atribuuar Këshillit kompetenca për të ndërmarrë masa në fushën e politikës së emigracionit, fushë në të cilën janë ndërmarrë në total nëntë akte kryesore, prej të cilëve shtatë direktiva, një rregullore dhe një vendim<sup>76</sup>. Një nga direktivat me të rëndësishme është dhe Direktiva 2003/86/BE e cila trajton të drejtën e bashkimit familjar të shtetasve ekstra-komunitar, të cilët qëndrojnë ligjërisht në një shtet anëtar të BE-së. (Tufano.M.L,2005:74)

Traktati i Nisës konsiderohet si një vazhdimësi e Traktatit të Amsterdait, kjo për shkak të ndryshimeve minimaliste të sjella në fushën objekt të studimit tonë. Një nga risitë e këtij traktati është vendimi Nr. 2004/927/BE të 22 Dhjetorit 2004, me atë të të cilit Këshilli ka vendosur zbatimin e procedurave të bashkëvendosjes. Nëpërmjet këtij vendimi i atribuohet e drejta e bashkëpunimit Parlamentit Europian, si dhe i krijohet mundësia Këshillit për të arritur një maxhorancë të kualifikuar për adoptimin e masave të parashikuara nga neni 62 pika 1, 2 dhe 3, si dhe nga neni 63, pika 2, shkronja b dhe pika e 3 –të shkronja b. (Manca.L,2005:193)

---

<sup>76</sup> Shih Direktivën 2003/86/EC e 22 shtator 2003; Direktivën 2003/109/EC e 25 nëntorit 2003; Direktivën 2004/114/EC të 13 dhjetorit 2004; Direktivën 2004/81/EC e 29 prillit 2004; Direktivën 2001/40/EC të datës 28 maj 2001; Direktivën 2003/110/EC e 25 nëntorit 2003; Vendimi 2004/573/EC e 29 prillit 2004; Rregullorja 377/2004/EC i datës 19 shkurt 2004 dhe Direktivën 2005/71/EC e 12 tetor 2005.

Në vitin 2009 hyri në fuqi Traktati i Lisbonës i cili parashikon politika të reja të përbashkëta në temën e kontrollit të kufijve, të azilit dhe të emigracionit, të përmbledhura në Titullin V të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit European (TFBE). (Carta.M:176)

Në paragrafin 1 të nenit 63 të TTBE-së parashikohet që Bashkimi European zhvillon një politikë të përbashkët të emigracionit e cila siguron, në çdo fazë, menaxhimin efikas të flukseve emigratore, trajtimin e barabartë të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë rregullisht në shtetet anëtare dhe parandalimin dhe luftimin e përforcuar ndaj emigracionit ilegal dhe të trafikimit të njerëzve”.

#### **4.2. Direktiva 2003/86 në lidhje me bashkimin familjar të qytetarëve të vendeve të treta**

Koordinimi i të drejtës së bashkimit familjar të shtetasve të shteteve të treta, ligjërisht banorë të Bashkimit European realizohet nga Direktiva 2003/86. Kjo Direktivë është miratuar më 22 Shtator 2003 dhe synon harmonizimin e legjislacioneve kombëtare duke garantuar të drejtën e fjalës. Ajo e trajton të drejtën familjare jo vetëm si një të drejtë themelore, por edhe si faktor i promovimit të qëndrueshmërisë social-kulturore të emigranteve dhe të integritetit të tyre në shtresat sociale të shtetit pritës<sup>77</sup>. Direktiva njeh të drejtën për bashkim familjar si një të drejtë subjektive të pranuar dhe njohur nga të gjitha shtetet anëtare. (Ciciriello. M.C,2006:114)

---

<sup>77</sup> Shih pjesën e tretë të direktivës i cili përcakton se: "Këshilli Evropian ka përcaktuar se Bashkimi Evropian duhet të sigurojë një trajtim të drejtë për shtetasit e vendeve të treta që banojnë ligjërisht në territorin e Shteteve Anëtare dhe duhet të garantoj integritetin e tyre duke u dhënë atyre të drejta dhe detyrime të krahasueshme me ato të qytetarëve të BE-së ... "dhe pjesa e katërt specifikon se:" bashkimi familjar është një mënyrë e domosdoshme për të bërë jetën familjare . Kjo ndihmon për të krijuar stabilitet social-kulturore të lehtësuar integritetin e shtetasve të vendeve të treta, të cilat gjithashtu shërben për të promovuar kohezionin ekonomik dhe social, një objektiv themelor i Komunitetit, siç përcaktohet në Traktatin. "

Në tekstin e direktivës trajtohet përmbajtja progresiste (Tomasì.L,2003:202), duke iu referuar veçanërisht kufizimeve të familjarëve të pranuar në bashkim familjar. (Morozzo della Rocca.P,2004:65) Kritikë dhe studiues të shumtë shprehen se direktiva ka lënë një hapësirë të gjerë interpretimi nga ana e shteteve anëtare, kur duhet të vendoste dhe përcaktonte disa parime të përbashkëta, në mënyrë të veçantë për kategoritë e personave të pranuar në bashkimin familjar dhe mbrojtjen e tyre nga dëbimi.(Colacino,2004:141)

Po kështu, nuk bëhet e mundur arritja e objektivit të Tampere (Liguori.A,2002:146) i cili konsistonte në atribuimin ndaj shtetasve të ardhur nga shtetet e treta të një “sërë të drejtash uniforme, të ngjashme me ato nga të cilat përfitojnë shtetasit e BE-së”. (Barret.G,2003:370) Gjatë fazës së përpunimit të tekstit të kësaj direktive Parlamenti Europian si rezultat i kontrasteve që kishte me Këshillin, paraqiti pranë Gjykatës së Drejtësisë kërkesën për anulimin e këtij akti. (Masson.B,2006:637)

Parlamenti ka konstatuar pajtueshmëri të të drejtës familjare midis nenit 230, paragrafi 2 i Traktatit të BE-së dhe nenit 4 paragrafi 1, presja e fundit, 4 paragrafi 6 dhe 8, me parimin e barazisë, me të drejtën themelore të respektit të jetës familjare, të përcaktuar nga neni 8 KEDNJ<sup>78</sup>.

---

<sup>78</sup> Apeli i Parlamentit Evropian i ka bërë thirrje Gjykatës së Drejtësisë të vendosë mbi pajtueshmërinë e dispozitave të tre përjashtimeve të përcaktuara nga Direktiva për respektimin e të drejtës familjar edhe parimin e mos-diskriminimit, të cilat, siç parashikohet nga nenet e ECHR, nga traktatet e ndryshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të detyrueshme për shtetet anëtare dhe nga traditat e përbashkëta kushtetuese të tyre, janë parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare. Përjashtimi i parë është hedhur poshtë. Në nenin 4 paragrafi i fundit i cili i lejon shtetet për të realizuar bashkimin familjar të fëmijëve bëri që fëmijet dymbëdhjetë vjeç që arrijnë në një shtet anëtar të BE-së në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e familjes duhen shqyrtuar nga ekzistenca e kushteve për integrim. Përjashtimi i dytë është hedhur poshtë nga nenin 4 paragrafi 6 i cili i jep shteteve anëtare të drejtë të kërkojë dorëzimin e aplikimit për bashkim para se ata kanë përfunduar vitin e tyre të moshës pesëmbëdhjetë vjeçare që të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin e të miturit "për arsye të tjera se bashkimit familjar." Përjashtim final është hedhur poshtë nga neni 8, sipas të cilit shtetet mund të kërkojnë që migranti që ka banuar ligjërisht në territorin e tyre për një periudhë prej dy vjetësh. Paragrafi 2 i këtij neni parashikon që, në qoftë se legjislacioni merr parasysh kapacitetin e pritjes së shtetit, ky i fundit mund të sigurojë për një periudhë pritje prej jo më shumë se tre vjet ndërmjet paraqitjes së kërkesës për

Direktiva parashikon që një shtetas i një vendi të tretë që jeton legalisht në Bashkimin European gëzon në bazë të kësaj Direktive, të drejtën e bashkimit familjar duke bërë që shteti anëtar pritës të lejojë fëmijët e tij të qëndrojnë në shtetin pritës në kuadër të të drejtës së bashkimit familjar. Direktiva i lejon shteteve anëtare që në varësi të disa rrethanave specifike të zbatojnë një normativë kombëtare e cila shmang rregullat në parim. Çka do të thotë që kur një fëmijë i moshës mbi 12 vjeç, i mbërritur në shtetin pritës, pavarësisht nga familja e tij, shteti anëtar, përpara se të autorizojë hyrjen e tij, mund të ekzaminojë në qoftë se i mituri i plotëson kushtet e integritetit të parashikuara nga normativa. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që kërkesat në lidhje me bashkimin familjar të fëmijëve të mitur të paraqiten përpara moshës 15 vjeç, në konformitet të normativës në fuqi në datën e miratimit të direktivës (2006).

Shtetet anëtare mund të kërkojnë që kërkuuesi përpara se të bashkohet me pjesën tjetër të familjes së tij, të ketë jetuar në territorin e tyre për një periudhë jo më shumë se dy vite. Po kështu sipas Direktivës një shtet anëtar mund të vendos një periudhë pritjeje jo më të gjatë se tre vite, nga momenti i dorëzimit të kërkesës për bashkim familjar deri në dhënien e lejes së qëndrimit familjarëve që e kërkojnë, në rastin kur normativa e shtetit përdor si kriter kapacitetin pritës të tij. Parlamenti European i konsideron këto dispozita në kundërshtim me të drejtat themelore, në veçanti, e drejta e respektit të jetës familjare dhe e drejta e mosdiskriminimit dhe për këtë arsye ai ka paraqitur një kërkesë për anulim përpara Gjykatës së Drejtësisë, e cila e ka refuzuar atë. Gjykata ka konstatuar përputhshmëri me

---

bashkim dhe çështjen një leje qëndrimi për anëtarët e familjes. Shih në pikën e konkluzioneve të Përgjithshme dorëzuar më 8 shtator 2005, gjithashtu në dispozicion në faqen [www.curia.eu](http://www.curia.eu).

parimin e respektimit të jetës familjare, e vendosur nga nenin 8 KEDNJ dhe nga traktatet ndërkombëtare, si dhe me parimin e barazisë. (Franco.P,2007:537)

Pavarësisht kritikave dhe kërkesave për anulim Direktiva Nr. 2003/86 konsiderohet instrumenti i parë në nivel komunitar që përcakton një kuadër ligjor të integruar mbi bashkimin familjar. Ajo është një dokument i rëndësishëm, pasi për herë të parë kodifikon të drejtën e bashkimit familjar për shtetasit ekstra-komunitar në BE. Humbet pra, karakteri i thjeshtë dhe klasifikohet si një e drejtë e vërtetë.(Groenendijk.K,2004:118) Nëqoftëse nuk mund t'u garantohet shtetasve ekstra-komunitarë një tutelë maksimale e kësaj të drejte. Edhe vendimi i përmendur i Gjykatës Parlamenti. Këshilli konfirmon qartësisht ekzistencën e kësaj të drejte, pasi që afirmon që direktiva i imponon një detyrim pozitiv shteteve anëtare duke kërkuar që, në rrethana të përcaktuara në direktivë, të autorizojnë bashkimin familjar të disa familjarëve të qëndruesit pa i lënë atyre asnjë hapësirë për të vendosur në këtë temë<sup>79</sup>.

Direktiva aplikohet për shtetet anëtare të BE-së, përveç Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës dhe Danimarkës, për shkak të pozicionit të veçantë që kanë këto shtete brenda Titullit VI të Traktatit të BE. (Adamo.S,2007:12)

#### **4.2.1. Fusha e aplikimit të *ratione personae*. Përfituesit e të drejtës së bashkimit familjar**

Direktiva përcakton shprehimisht se të drejtën e bashkimit familjar e përfitojnë vetëm shtetasit e vendeve të treta që qëndrojnë rregullisht në territorin komunitar me një

---

<sup>79</sup>Shih raportin e Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian në zbatimin e Direktivës 2003/86 mbi të drejtën për bashkim familjar të 8.10.2008, COM (2008) 610 final, Bruksel.

leje qëndrimi të vlefshme të paktën një vit dhe refugjatët, pavarësisht nga kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes së qëndrimit. (Bergamini.E,2006:4085) “Shtetas i një vendi të tretë” përcaktohet të jete “çdo kush që nuk është shtetas i BE-së”. (Guild.E,2006:111)

Nga e drejta e bashkimit familjar, sipas Direktivës 2003/86 përjashtohen

- azil-kërkuesit,
- përfituesit e mbrojtjes së përkohshme,
- dhe në propozim të Parlamentit European, edhe shtetasit e shteteve të treta, të autorizuar për të qëndruar në një shtet anëtar në përputhje me forma mbrojtjeje mbështetëse apo punëtorë dhe praktikantë. (Peers.S,2006:214)

Objektivi i direktivës është të garantojë një trajtim të barabartë për shtetasit e vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në territorin komunitar. Fusha e zbatimit *ratione personae* përfshin shtetasit e vendeve të treta që qëndrojnë për motive pune duke përjashtuar punonjësit me kohë të caktuar, ato sezonal si dhe studentët .(Colacino,2004:144) Por shqyrtimi i kërkesës për të marrë një të drejtë qëndrimi në një nga vendet e Bashkimit European mbetet me kompetencën ekskluzive të shteteve anëtare duke i lënë në këtë mënyra dhe interpretimin e kësaj dispozite. (Tufano.M.L,2005:63)

Komisioni European shprehet se nuk duhet të gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar personat që qëndrojnë në mënyrë të përkohshme, dhe që nuk kanë “mundësinë e rinovimit” të lejes së qëndrimit. kjo sepse e drejta e qëndrimit të afatgjatë varet nga politikat migratore të cila është e ndryshme nga shteti në shtet. (Cellamare.G,2006:154)

Kështu, marrim rastin e një punëtori që qëndron ligjërisht në Itali për 4 vite rresht dhe ka filluar procedurën e aplikimit për bashkim familjar, por gjatë kësaj kohe ai humbet vendin e punës, duke u kualifikuar si punonjës sezonal (me një leje pune me kohëzgjatje 6-8 muaj), e cila mund të zgjatet në kohë. Në këto kushte ky punonjës mund të plotësoj kushtet e përgjithshme ekonomike dhe atë të banesës, por kërkesa e lejes së qëndrimit prevalon si kusht kundrejt dy të parëve duke e shndërruar atë në një rrezik të barrës sociale të vendit pritës.

Në këtë situatë dhe në të tjera, do të kishte qenë shumë më e thjeshtë dhe efektive nëqoftëse do t'i ishte referuar konceptit “qëndrueshmëri” ose “vlerësim i përgjithshëm i situatës personale”, në vend të “perspektivës së qëndrimit”, duke konsideruar faktin që shtetasi vetëm në këto kushte “qëndrueshmërie” do të kërkonte bashkimin familjar. Por në lidhje me këtë kusht Komisioni nuk i qartëson cilët janë rastet në të cilat do të merret si referencë në akordimin e të drejtës së bashkimit familjarë, dhe në mungesë të një interpretimi uniform, atëherë e drejta e vlerësimit i lihet diskrecionit të brendshëm të shteteve.

Megjithatë, shtetet duhet të jenë shumë të kujdesshëm në vlerësimin e të drejtës së bashkimit familjar, me qëllim që të mos paragjykojnë situatat e ndryshme të punësimit të kërkuarit, i kushtëzuar shumë herë nga nevojat e tregut të punës, dhe ta përdorë këtë diskrecion për të bërë më të mirën. Në lidhje me të drejtën e bashkimit familjar të personave që disponojnë një leje qëndrimi e më të shkurtër se një vit duhet thënë se dhe ky vlerësim mbetet në diskrecionin e shteteve anëtare. (Liguori.A,2002:149)

Direktiva Nr. 2003/86 zbatohet edhe për të gjithë shtetasit ekstra-komunitar që kanë marrë statusin e qëndruesit afatgjatë, në bazë të Direktivës së Këshillit 2003/109 të 23



Nëntorit të vitit 2003, “*Në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë për një kohë të gjatë*”, (Liakopoulos.D,2007:122) në rastin kur vendosin të transferohen në një tjetër shtet anëtar.

Neni 16 i Direktivës 2003/109 përcakton se familjarët e qëndruesit, të përcaktuar në nenin 4 të direktivës 2003/86 (bashkëshorti, fëmijët e mitur dhe të pamartuar, paraardhësit, fëmijët e rritur të pamartuar, partneri) kanë të drejtë t’a shoqërojnë apo të bashkohen në shtetin tjetër anëtar me kërkuesin sepse familja ka qenë e bashkuar që në shtetin e parë anëtar. (Manca.L,2005:229)

Në rastet kur kërkesa për bashkim familjar bëhet për herë të parë në shtetin anëtar, atëherë aplikohen dispozitat e direktivës 2003/86. (Liakopoulos.D,2007:122) Në përfundim, mund të themi që kundrejt ligjeve të shteteve anëtare, direktiva vendos standartet minimale, të cilat shtetet anëtare mund t’i mbajnë në fuqi ose të miratojnë dispozita më të favorshme.

#### **4.2.2. Subjektet përfituese të të drejtës së bashkimit familjar të vendeve të treta**

Direktiva, në lidhje me familjarët që do të përfitojnë bashkimin familjar, përcakton që edhe pjesëtarët e familjes së aplikuesit duhet të jenë shtetas të shteteve të treta, pavarësisht nga statusi i tyre juridik. Kategoria e familjarëve të pranuar në bashkim familjar është reduktuar shumë gjatë diskutimeve për miratimin e direktivës. Në identifikimin e subjekteve pasive të bashkimit familjar, direktiva parashikon si detyrime, ashtu edhe mundësi.

Detyrimi konsiston në bërthamën familjare, pra, janë të pranuar në bashkim familjar bashkëshorti dhe fëmijët e mitur, përfshirë këtu edhe ato të adoptuar, qoftë edhe nga njëri

nga bashkëshortët, ndërsa mundësia ka të bëjë me paraardhësit dhe me fëmijët e rritur (maxhorenë). (Colacino,2004:144) Bashkimi familjar i pjesëtarëve të tjerë të familjes apo i subjekteve të tjerë të lidhur me qëndruesin i lihet në diskrecion shteteve anëtare.

Direktiva në trajtimin e konceptit të familjes gjatë vlerësimit të bashkimit familjar i referohet vetëm bërthamës së familjes. (Velluti.S,2007:65) Sipas kësaj Direktivës pjesë e bërthamës familjare janë:

- a) bashkëshort/e i/e qëndruesit;
- b) fëmijë të mitur të qëndruesit apo bashkëshortit/es, përfshirë këtu ato të adoptuar;
- c) fëmijët e mitur të qëndruesit përfshirë këtu edhe ato të adoptuar, kur qëndruesi është titullar i mbajtjes së tyre;
- d) së fundmi, fëmijët e mitur, të bashkëshortit/es, përfshirë këtu edhe ato të adoptuar, kur bashkëshorti/ja të jetë titullar për mbajtjen e tyre.

Direktiva zbatohet jo vetëm për familjen që ka pasur kërkuesi përpara se të jetë subjekt i kësaj të drejte, por edhe kur familja është krijuar pas mbërritjes në vendin pritës. (Groenendijk.K,2004:118)

#### **4.2.2.1. Bashkëshorti/ja**

Në interpretimin e konceptit të familjes për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjar Direktiva parashikon se pjesa kryesore e bërthamës familjare është bashkëshorti/ja. (Angelini.F,2011:172) Kështu shtetet anëtare detyrohen të autorizojnë sipas nenit 4, paragrafi 1, bashkimin familjar për bashkëshortin/en e emigrantit. Shtetet anëtare përcaktojnë limitin minimal të moshës 21 vjeç për qëndruesin dhe bashkëshortin/en, si një mënyrë kjo për të evituar praktikën e martesave midis të miturve pa dëshirën e tyre të lirë.

(Groenendijk.K,2004:118) Krijimi i kësaj dispozite synon të sigurojë një integrim më të mirë si dhe të shmangë martesat e detyruara. Kështu, një shtetas 20 vjeç Turk rezident i ligjshëm në Holandë martohet me një bashkëkombëse të tij 18 vjeç, në këto kushte martesa e tyre është e ligjshme dhe njihet në Hollandë, por, për të siguruar një integrim më të mirë të bashkëshortes së tij, Hollanda e detyron atë të presë dhe tre vite në Turqi përpara se të bashkohet me bashkëshortin e saj rezident në Holandë.

Direktiva parashikon përjashtime në rastin e poligamisë në lidhje me të drejtën e bashkimit familjar. (Colacino,2004:145) Kështu në raste se qëndruesi ka bërë më shumë martesa dhe në këto kushte ka krijuar më shumë se një familje, në bazë të nenin 4 të Direktivës shtetet mund të vendosin në momentin e akordimit të bashkimit familjar, mospranimin në territorin e tyre të “bashkëshortit/es së dytë” dhe as të fëmijëve të tij/saj.(Peers.S,2006:214) (Lamce: 2013)

Direktiva përcakton që kur kërkuesi ka një bashkëshort me të cilin bashkëjeton në territorin e shtetit anëtar pritës, ky i fundit nuk autorizon hyrjen apo qëndrimin e një tjetër bashkëshorti/e dhe as fëmijët e saj. Pra grua e dytë nuk gëzon të drejtën e bashkimit familjar dhe në këto kushte shteteve anëtarë u ndalohet akordimi i dhënies së lejes së qëndrimit nën kuadrin e bashkimit familjar. (Pascucci.L,2007: Campiglio .C 49)

Shteteve anëtare u lihet diskrecion dhe mundësia për të vendosur nëse do të pranojnë apo jo në territorin e tyre fëmijët e mitur të bashkëshortit të dytë. (Peers.S,2006:214) Neni 1 paragrafi 4 përcakton se “Shtetet anëtare mund të kufizojnë bashkimin familjar të fëmijëve të qëndruesit apo të një tjetër bashkëshorti/e”, dhe krijon një hapësirë interpretimi në lidhje me mundësin e pranimit në bashkim familjar të fëmijëve të bashkëshortit të dytë, në rastin kur është në interes të të miturit apo në raste të tjera të

veçanta (për shembull kur e ëma e fëmijës ka vdekur ose nuk mundet për arsye objektive të përkujdeset për të).

Në këtë rastë ato që duhet të dominojnë më shumë mbi respektin për vlerat, parimet apo rendi publik i shteteve anëtare janë vlerat njerëzore. Nga momenti që normativa komunitare ka miratuar një koncept të pavarur dhe të gjerë për “fëmijët” (Tomasi.L,2003:73) dhe ka një të drejtë subjektive të pavarur të fëmijës *uti singulus*, atëherë është e qartë që masat shtrënguese duhet të justifikojnë plotësisht përdorimin e tyre duke dominuar mbi interesi kryesor të fëmijës për t’u bashkuar me të atin. (Campiglio.C,2007:49)

#### **4.2.2.2. Fëmijët**

Direktiva 2003/86 detyron shtetet që të autorizojnë që së bashku me bashkëshorten dhe hyrjen e fëmijëve të mitur të pamartuar. (Cellamare.G,2006:156) Kategoria e familjarëve është e përbërë vetëm nga fëmijët dhe jo nga pasardhësit në përgjithësi. Fëmijët ndahen në tre kategori.

1. Në kategorinë e parë futen fëmijët e mitur të aplikuesit dhe të bashkëshortes, përfshirë, fëmijët e adoptuar sipas një vendimi të marre nga shteti anëtar i interesuar ose një vendim automatikisht i zbatueshëm në sajë të detyrimeve ndërkombëtare të kontraktuara nga shteti anëtar ose duhet të jetë e njohur konform disa detyrimeve ndërkombëtare;
2. në kategorinë e dytë futen fëmijët e mitur, përfshirë ato të adoptuar, të qëndruesit, kur ky i fundit është titullar i kujdestarisë dhe përgjegjës për mbajtjen e tyre.
3. në kategorinë e tretë futen fëmijët në kujdestari të përbashkët,

Neni 4 paragrafi 1 shkronja c) dhe d) të Direktivës 2003/86 parashikon se shtetet anëtare mund të autorizojnë bashkimin familjar të fëmijëve në kujdestari të të dy prindërve, me kushtin që kujdestari tjetër të ketë dhënë miratimin e tij. (Liakopoulos.D,2007:435) Pra diskrecionaliteti që Direktiva i lënë shteteve anëtare në lidhje me fëmijët e mitur në kujdestari, nënkupton edhe fuqinë nga ana e shteteve anëtare për të refuzuar bashkimin familjar kur ka të bëjë me fëmijë në kujdestari të përbashkët.

E drejta e vendimmarrjes në lidhje me fëmijët në kujdestari të përbashkët krijon konfuzion sepse krijohet një regjim i ndryshëm mes një kategorie në të cilën nuk duhet të ketë diferenca. Direktiva përcakton që fëmijët e mitur duhet të kenë një moshë më të vogël se sa ajo me të cilën bëhen madhorë në shtetin anëtar të interesuar (në rastin kur ndodh bashkimi familjar) dhe nuk duhet të jenë të martuar. (Brinkmann.G,2002:257) Pra, fëmijët duhet të jenë ekonomikisht të varur nga prindërit.

Përcaktimi i moshës madhore të fëmijëve të shtetasit të shtetit të tretë i lihet legjislacionit të shtetit anëtar dhe jo atij komunitar, i cili parashikon që kufizimi i moshës për të mund të përfitohet nga legjislacioni komunitar, dhe në temën e bashkimit familjar është 21 vjeç.(Guild.E,2006:112) Pra, për të përfituar nga bashkimi familjar në Bashkimin Europian, fëmijët e emigrantëve ekstra-komunitare duhet të kenë si kufizim maksimal moshën 18 vjeçare, ndërsa kufizimi i moshës për fëmijët e shtetasve komunitarë duhet të jetë 21 vjeç.

Kryesisht në të gjitha shtetet anëtare mosha madhore arrihet në momentin që mbush 18 vjeç. Sipas direktivës për bashkimin familjar mosha madhore vendoset nga ana e shteteve anëtare të interesuara. Ky kriter në shtete si Gjermania dhe Holanda është edhe më i ulët dhe mund të arrijë në 14 vjeç (Hollandë). Në disa raste disa fëmijë në moshën

shtatëmbëdhjetë vjeçare nuk kanë mundur të të përfitojnë nga bashkimi familjar, pasi legjislacioni i shtetit pritës parashikon që kufizimi i moshës madhore të jetë 16 vjeç. Pra, kriteri i moshës është variabël në varësi të legjislacionit të shtetit pritës duke qenë fillimisht konform me direktivën, por jo konform me parimet njerëzore dhe mbi të gjitha me barazinë. Përsa i përket kriterit që fëmijët nuk duhet të jenë të martuar në momentin e kërkesës për bashkim familjar Direktiva përjashton nga kuadri i zbatimit kur janë të mitur, por të martuar dhe akoma në varësi ekonomike nga prindërit.

Për fëmijët e biresuar direktiva specifikon që vendimi në lidhje me bashkimin familjar duhet të merret nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar ose nga një vendim automatikisht i zbatueshëm në sajë të detyrimeve ndërkombëtare. Pra, biresimi duhet të njihet në shtetin anëtar të interesuar dhe të zbatohet direkt. Dua të theksoj që ekzistojnë edhe forma të ndryshme të përkujdesjes së të miturve të cilat nuk identifikohen me adoptimin tradicional: por që janë të parashikuara si format e tjera të adoptimit, ato në veçanti të botës muslimane kafala<sup>80</sup>. (Lamce, Vasjari: 2014, 121) Meqenëse kafala nuk krijon asnjë kufizim, mbetet e vështirë të përcaktohet regjimi juridik në legjislacione të ndryshme perëndimore, duke paraqitur vështirësi në pajtimin e këtij instituti në të drejtën pozitive. Në Itali problemet e përballuara nga gjykatësit janë të dyfishta, dhe i referohen

---

<sup>80</sup> Kafala është institucioni, për mbrojtjen e fëmijëve të njohura shprehimisht nga Konventa e New York-ut për të Drejtat e Fëmijës (neni 20 paragrafi 3) dhe e pranuar për të mbrojtur masat "perëndimore" me Konventën e Hagës të 19 tetorit 1961 (e art. 3, shkronja. a), me të cilën një palë merr përsipër detyrimin, në praninë e një gjyqtari ose një noteri, të kujdeset për fëmijën, por në këtë mënyrë nuk ka marrë këto me një marrëdhënie prind-fëmijë. Për sa i përket pikërisht, marrëdhënia e ligjit gjini islam njihet vetëm një: ajo e bijësisë legjitime. Miratimi është e ndaluar nga Kurani. Prandaj, kafala, nuk ndërprerë lidhjet ligjore me familjen e origjinës, nuk përcakton në skajet e të miturit një ndryshim i statusit personal dhe përfundon zakonisht me moshën. Shih për me shume nje studim te vecante te Lamce, Vasjari,

njohjes së kafala-s edhe si motiv për bashkim familjar, por edhe si adoptim apo kujdestari para-adoptuese. (Lamce, Vasjari: 2014, 121)

Një çështje me interes të veçantë që i përket fëmijëve dhe që ka shkaktuar jo pak diskutime dhe kritika është dispozita në bazë të së cilës shteteve anëtare u jepet e drejta që t'i kërkojnë fëmijëve që kanë kaluar moshën dymbëdhjetë vjeçare të plotësojnë disa kushte për integrimin. (Groenendijk.K,2004:217) Në nenin 4, paragrafi i fundit përcakton që një shtet anëtar, në rastin kur një fëmijë ka kaluar dymbëdhjetë vjeç dhe vjen në territorin e shtetit pavarësisht nga familja, përpara se të autorizohet hyrja apo qëndrimi i tij, mund të ekzaminojë nëse janë të plotësuara kushtet për integrimin e tij të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Kjo dispozitë ka efekt vetëm në rastet e rrethanave të mirë përcaktuara nga ku vlen të përmendet rasti kur një i mitur i moshës më të madhe se dymbëdhjetë vjeç vjen i/e pavarur nga familja.(Colacino,2004:10) Direktiva i lejon shteteve anëtarë që të jenë ato që do të përcaktojnë dhe do të kenë kompetenca ekskluzive duke i lejuar atyre ekzaminimin nëse i mituri i përgjigjet kriterëve të integrimit të parashikuar nga ligji kombëtar. (Di Pascale.A & Pastore.M,2003:15) Norma në një interpretim të parë duket sikur kufizon të drejtën e bashkimit familjar, por sipas Gjykatës, ajo konfiguron një fuqi diskrecionale të kufizuar që nuk mund të jetë në kundërshtim me respektin e jetës familjare, e njëjtë me atë që njeh edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj në temën e të drejtës për respektimin e jetës familjare, duke peshuar në çdo rast konkret interesat në lojë. Po kështu edhe zgjedhja e moshës 12 vjeçare përbënë një diskriminim të bazuar në moshë, sepse sipas gjykatës, *“kemi të bëjmë me një kriter korrespondues me një fazë të jetës së një fëmije të mitur në të cilën ky i fundit e ka kaluar tashmë një periudhë të gjatë të ekzistencës së tij në*

*një shtet të tretë pa familjarët e tij, arsye kjo për të cilën integrimi në një ambient të ri mund të rezultojë burim i problematikave më të mëdha”.* (Aveta.R,2007:25)

Gjykatësi komunitar e konsideron të ligjshme mundësinë e njohur ndaj shteteve për të verifikuar përmes një testi të integritetit, futjen e të miturve, të ardhur pavarësisht nga pjesa tjetër e familjes. Zgjidhja e dhënë nga Gjykata, megjithëse nuk i bind të gjithë, jep motiv për të mbajtur qëndrimin (dhe mbi të gjitha, duke rikujtuar kriteret e adoptimit të direktivës). (Zanobetti Pagnetti.A,2004:404) Gjykata e Drejtësisë ka preferuar t’i japë këtë interpretim, mendoj për motivin e thjeshtë që të ruhet kompromisi politik dhe për të mbajtur, kushtet e ekuilibrit të fiksuara në direktivë. Do ta quaja këtë kusht problematik me fjalët e Guild, sipas së cilës diskrecionaliteti i lënë shteteve anëtare *“does not lead towards convergence of criteria or standards but rather in the opposite direction”*.

Po ashtu, Gjykata është shprehur që mundësia për shtetet anëtare të zbatojnë disa kërkesa në lidhje me bashkimin familjar të parashikuar në direktivë për kërkesat e bashkimit familjar të bëra përpara se fëmija të ketë arritur moshën 15 vjeç nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me të drejtën e respektit të jetës familjare, me detyrimin që të mbajë parasysh interesin kryesor të të miturit, ose me parimin e mosdiskriminimit në bazë të moshës. (Guild.E,2006:113) Në nenin 4 paragrafi 6 përcaktohet që shtetet anëtare mund të kërkojnë që kërkesat në lidhje me bashkimin familjar të fëmijëve të mitur duhet të paraqiten përpara mbushjes së moshës 15 vjeçare, dhe kur këto kërkesa paraqiten pas mbushjes së kësaj moshe, shtetet anëtare që vendosin ta zbatojnë këtë kufizim, autorizojnë hyrjen dhe qëndrimin e këtyre fëmijëve për motive të ndryshme nga ai i bashkimit familjar.

Sipas Gjykatës kjo dispozitë nuk mund të interpretohet në kuptimin, që t’i ndalojë shteteve anëtare të marrin në konsideratë një kërkesë në lidhje me një fëmijë të moshës mbi



15 vjeç, ose t'i autorizojë për të mos i mbajtur. Në fakt, edhe pse është e vërtetë që për efekt të kësaj dispozite një shtet anëtar mund të përjashtojë ligjërisht që kërkesat e propozuara për fëmijë të mitur të moshës mbi 15 vjeç t'i referohen kërkesave të përgjithshme të direktivës, shteti anëtar duhet të ekzaminojë kërkesën në interes të fëmijës së mitur në mënyrë që t'i favorizohet jeta familjare. (Franco.P,2007:538)

Kjo normë, sipas Gjykatës duhet të lexohet në dritën e parimeve që vendosen më tej nga direktiva, e cila i imponon shteteve anëtare të marrin në konsideratë interesin kryesor të të miturit dhe të mbajnë parasysh një sërë elementesh, mes të cilëve lidhjet familjare të personit. Pra, edhe pse efektivisht neni 4 paragrafi 6 i lejon shtetet të përjashtojnë kërkesat e bashkimit familjar që i përkasin fëmijëve të mitur që kanë mbushur moshën 15 vjeç, është e vërtetë që shteti “mbetet i ngarkuar me ekzaminimin e kërkesave në interes të të miturit dhe në optikën e favorizimit të jetës familjare”. Përsa i përket kufizimit të moshës së fiksuar 15 vjeç, Gjykata përsërit “*aforfe*” atë që thuhet në nenin 4 paragrafi 1. (Zanobetti Pagnetti.A,2004:404) Gjykimi i Gjykatës, zhgënjyes për pjesën më të madhe të argumenteve në fjale, mbaron duke mos përjashtuar që çështje të tjera në lidhje me direktivën dhe interpretimin e saj mundën në të ardhmen të vendosen në gjykim nga gjykatësit kombëtare, sipas modaliteteve të parashikuara nga neni 68 dhe 234 Bashkimit European. Duke e mbyllur në këtë mënyrë, Gjykata duket sikur i fton gjykatësit kombëtarë për të nxitur interpretimin e direktivës.

Se fundmi paraqet interes ketu edhe orientimi i fundit i GJED-se lidhur me kushtet e integritetit që u kerkohen familjareve. Sipas saj, në çështjen C-153/14, *K dhe A* e datës 09/07/2015 pyetjet referuar nenit 7 par. 2 duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mund të kërkojnë një anëtar të familjes së një

titullari aktiv të tregojë se ai ose ajo ka njohuri të gjuhës zyrtare të Shtetit anëtar në fjalë në një nivel që i korrespondon nivelit A1, si dhe njohuri baze të shoqërisë së atij shteti anëtar, përpara se ato autoritete të autorizojë hyrjen e atij anëtarit të familjes dhe të qëndrimit. Legjislacioni kombëtar që përmban kërkesën e përmendur në pyetjen 1 (a) parashikon se, duke lënë mënjane rastin në të cilën anëtari i familjes ka treguar se, për shkak të paaftësisë mendore apo fizike, ai/ajo është në mënyrë të përhershme në gjendje për të kaluar testin e integritetit qytetar nuk bie në kundërshtim me direktivën në fjalë.

#### **4.2.2.3. Anëtarë të tjerë të familjes**

Shtetet anëtare, gëzojnë sipas dispozitave të brendshme ligjore, të drejtën e përcaktimit të familjarëve të tjerë që do të jenë pjesë e të drejtës së bashkimit familjar. (Di Pascale.A & Pastore M, 2003:14) Neni 4 paragrafi 2 dhe 3 i Direktivës i lejon shteteve anëtare të autorizojnë hyrjen dhe qëndrimin e “familjarëve të tjerë” në pajtueshmëri me plotësimin e kushteve të përcaktuara në kreun IV të saj. Në momentin që shtetet anëtare vendosin të autorizojnë këtë kategori të jetë pjesë e bashkimit familjar atëherë do të gjejnë zbatim kushtet normale të vendosura më parë nga direktiva.

Sipas direktivës kategoria e familjarëve të lënë në diskrecionin e shteteve anëtare përbëhet nga:

- a) paraardhësit direkt
- b) paraardhës të brezit të parë të kërkuesit apo të bashkëshortit/es, kur janë në ngarkim të këtij të fundit dhe nuk kanë një mbështetje familjare në shtetin e origjinës

- c) fëmijët e rritur të pamartuar të qëndruesit dhe të bashkëshortit/es kur objektivisht nuk mund të përballojnë nevojat e tyre si pasojë e gjendjes së tyre shëndetësore. (Bergamini.E,2006:4086)

Si pasardhës të kërkuesit apo të bashkëshortit/es janë vetëm babai dhe nëna. Dy kushtet që jane vendosur në ngarkim të tyre janë:

1. vartësit duhet të jenë në ngarkim të qëndruesit apo bashkëshortit/es,
2. nuk duhet të kenë mbështetje familjare në vendin e origjinës.

Në rastin e fëmijëve parashikohet shprehimisht që duhet të:

1. konsiderohen madhorë sipas ligjit të shtetit pritës
2. të pamartuar dhe
3. në gjendje shëndetësore të paaftë për të kryer nevojat e veta, për të përfituar nga e drejta e bashkimit familjar në atë shtet,

Direktiva në nenin 4 paragrafi 3 në lidhje me partnerin e pa martuar merr një pozicion jashtëzakonisht fleksibël, duke ia lënë përcaktimin e kriterëve vlerësues shteteve anëtare<sup>81</sup>.

Partneri duhet të ketë me kërkuesin një lidhje të qëndrueshme në kohë dhe të provueshme nga një marrëdhënie formalisht e regjistruar. (Liakopoulos.D,2007:435) Në lidhje me shtetasit ekstra-komunitar direktiva u ka lënë shteteve zgjedhjen nëse do të autorizojnë apo jo bashkimin familjar të këtyre personave. Në lidhje me partnerin e pamartuar, shtetas i një shteti të tretë, Direktiva në dispozitat e saj lë të hapur mundësinë e bashkimit familjar edhe të çifteve jo heteroseksuale kur sigurisht nëse shteti anëtar e lejon. (Lamce: 2011, 102)

---

<sup>81</sup> Propozimi fillestar përbënë kusht të detyrueshëm që partneri i pamartuar të jetë në kategorinë e familjarëve të pranuar për bashkim familjar, aty ku ligji kombëtar garanton të drejta të barabarta për partnerët e martuara dhe të pamartuara.

Shtetet anëtare, në ekzaminimin e kërkesave për bashkim familjar që i përket partnerit të pamartuar, duhet të marrin në konsideratë edhe nëse kanë fëmijët të përbashkët, një bashkëjetesë të mëparshme, apo një regjistrim formal apo elemente të tjera provuese<sup>82</sup>. Sapo partneri i pamartuar të jetë pranuar në bashkimin familjar, direktiva parashikon që mund të përfitojnë nga bashkimi familjar edhe fëmijët e rritur të pamartuar në rastin kur nuk janë në gjendje të kryejnë nevojat e tyre.(Colacino,2004:145)

Në pjesën e fundit të nenit 4 Direktiva diferencon dy kategoritë e partnerëve të pamartuar, duke u dhënë partnerëve që janë të lidhur me një regjistrim formal, kur shtetet e lejojnë, të njëjtin trajtim si bashkëshortë. Normat e Direktivës i atribuojnë shtetit anëtar fuqi të ndryshme diskrecionale në lidhje me pjesëtarët e familjes, duke përforcuar edhe më shumë, edhe pse në kurriz të familjarëve të tjerë të shtetasve ekstra-komunitar, bashkimin vetëm të familjes së ligjshme, apo të themeluar në martesë. (Di Pascale.A & Pastore.M,2003:14) Por nga ana tjetër, direktiva, në këtë mënyrë lë jashtë pjesëtarë të tjerë, për mendimin tim të rëndësishëm, të familjarëve që mund të përfitojnë nga bashkimi familjar. Ndër të tjera, në direktivë mungon dispozita që u lejon shteteve anëtare mundësinë për të pranuar në bashkim familjar edhe pjesëtarë të tjerë të familjes, të paidentifikuar në kategorinë e ekzaminuar: për shembull, fëmijët maxhorenë të varur de fakto nga prindërit e tyre apo një nip. Pra, në rastin kur kemi të bëjmë me fëmijë minorene në shtetin e tretë, por maxhorenë në shtetin pritës, prevalon legjislacioni i shtetit pritës: ky është rregulli. Në raste të veçanta rrezikohet efektivisht një prishje e njësisë familjare.

#### **4.3. Kushtet e kërkuara për ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar**

---

<sup>82</sup> Shih nenin 5 paragrafi 2 pika 3 të Direktivës.

Për të ushtruar të drejtën e bashkimit me familjarët e tyre kërkuesit duhet të plotësojnë kushtet e vendosura nga ana e shtetit pritës. Neni 7 i direktivës përcakton kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë shtetasit e vendeve të treta për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjar. (Franco.P,2007:535) Kushtet e përgjithshme për t'u plotësuar janë ato të vendosura në legjislacionin kombëtar të çdo shteti, edhe përpara adoptimit të direktivës. Në disa raste shtetet anëtare janë të lirë të vendosin disa kushte si ajo e posedimit të një:

a) banese të përshtatshme, domethënë një banesë të konsideruar normale për një familje të krahasueshme që jeton në të njëjtën zonë të shtetit anëtar të interesuar;

b) një siguracionin kundër sëmundjeve që mbulon përgjithësisht rreziqet në shtetin anëtar të interesuar, për të dhe për pjesëtarët e familjes së tij;

c) të ardhura të qëndrueshme dhe të mjaftueshme, më të mëdha ose të paktën të barabarta me nivelin e të ardhurave nën të cilin jepet ndihma sociale në shtetin anëtar të interesuar. (Groenendijk.K,2004:217)

Kërkesa për banesë, të ardhura ekonomike dhe siguracion janë në përgjithësi koherente me standartet e kërkuara nga legjislacioni komunitar për shtetasit komunitar, përjashtuar kërkesa e banesës së përshtatshme. (Angelini.F,2011:172) Kjo e fundit është kërkuar për një kohë të gjatë për shtetasit komunitar nën parashikimet e rregullores 1612/68, por aktualisht ky kusht nuk konsiderohet më di domosdoshmëri.(Lasok. K.P.E,2002:498) Banesa duhet të konsiderohet normale për një familje analoge në të njëjtën zonë dhe duhet të plotësoj normat e përgjithshme të sigurisë në fuqi në shtetin anëtar të interesuar. Por jo të gjitha shtetet kanë të njëjtën qasje legjislative në lidhje me kushtin e banesës, kështu disa shtete ende e konsiderojnë banesën si kusht të nevojshëm për të kërkuar bashkimin

familjar. Në disa shtete i referohen banesës si “normale”, ndërsa të tjerë përdorin një qasje më të specifikuar, duke kërkuar metrat katrorë të nevojshëm për çdo person shtesë<sup>83</sup>.

Kushtet e përgjithshme të sipërcituara, bazuar në legjislacionin e vendit pritës, duhet të plotësohen në momentin e prezantimit të kërkesës, përpara hyrjes së familjarit, sepse bazuar në kohëzgjatjen e procedurës së bashkimit familjar mund të vendoset dhe një ngarkesë financiare e konsiderueshme për kërkuuesin.

Të ardhurave ekonomike duhet të jenë të qëndrueshme dhe të rregullta, të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe familjarët, pa përdorur sistemin e asistencës sociale të shtetit anëtar të interesuar”. Në lidhje me vlerësimin e sistemit të të ardhurave të qëndrueshme shtetet duhet të marrin në konsideratë në momentin e përcaktimit të këtij kriteri natyrën dhe ligjshmërinë e të ardhurave duke bazuar në limitin e të ardhurave minimale, të pensioneve shtetërore, si dhe të numrit të familjarëve të pranuar për bashkimin familjar. Nisur nga ky fakt shtetet anëtarë kërkojnë rregull, qëndrueshmëri dhe që ky kusht të plotësohet jo vetëm në momentin e kërkesës për bashkim familjar, por edhe më gjatë: në çdo moment të prezantimit të kërkesës për rinovim të lejes së qëndrimit të qëndruesit apo të familjarëve të pranuar në bashkim familjar.

Kontrolli rigoroz në lidhje me sistemin e të ardhurave trajtohet në nenin 7 dhe në nenin 16, paragrafi 1 shkronja b), në të cilën përcaktohet shprehimisht se : *“Shtetet anëtare mund të kthejnë kërkesën për hyrje dhe qëndrim me qëllim bashkimin familjar ose, nëse është e rastit, të tërheqë apo refuzojë rinovimin e lejes së qëndrimit të një familjari në*

---

<sup>83</sup> Shih raportin e Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian në zbatimin të Direktivës 2003/86 për të drejtën e bashkimit familjar cit..

*rastet e mëposhtme: a) atëherë kur kushtet e fiksuar nga direktiva nuk janë, ose nuk mund të plotësohen më”.*

Neni 7 i Direktivës trajton edhe rastin e rinovimit të lejes së qëndrimit kur kërkuesi nuk ka të ardhurat e mjaftueshme që i lejojnë të mos ketë nevojë për asistencën sociale të shtetit anëtar, dhe më konkretisht në paragrafin 1 të nenit 7 shkronja c), parashikohet se shteti anëtar mban parasysh kontributin e familjarëve në të ardhurat familjare për rinovimin e lejes së qëndrimit”

Për shtetasit ekstra-komunitar leja e qëndrimit mund të tërhiqet ose të refuzohet rinovimi nëqoftëse kushtet e fiksuar nga direktiva nuk plotësohen më. Në këtë kuptim, kushti i banesës, i të ardhurave ekonomike dhe të siguracionit nga sëmundjet duhet të jenë prezentë jo vetëm në momentin e paraqitjes së kërkesës së bashkimit familjar deri në përfundimin e tij, por duhet të jenë edhe më pas, për sa kohë që familja qëndron në territorin e shtetit pritës, përveç rastit kur ndryshon statusi i familjarëve ose motivi i lejes së qëndrimit. Të gjithë shtetet anëtare (përveç Zvicrës), e kanë këtë kriter, por në forma të ndryshme, duke i deleguar saktësimet dispozitave lokale, duke iu referuar të ardhurave minimale, ose duke përmendur të ardhurat minimale nën të cilat jepet ndihma sociale. Disa shtete anëtare parashikojnë pragje që rriten proporcionalisht me numrin e familjarëve që duan të bashkohen me qëndruesin.

Kohet e fundit Gjykata Europiane e Drejtësisë ka theksuar në vendimin datës 21 prill 2016 (një vendim paraprak nga Tribunal Superior de Justicia del Pais Vasco e Spanjës) - Mimoun Khachab (Case C-558/14) lidhur me kushtet për ushtrimin e të drejtës për bashkim familjar se burimet duhet të jenë të qëndrueshme, të rregullta dhe të mjaftueshme. Sipas saj neni 7, paragrafi 1, shkronja c) të Direktivës 2003/86 / EC e 22 shtatorit 2003 mbi

të drejtën e bashkimit familjar, duhet të interpretohet që e lejon autoritetin kompetent të një Shteti Anëtar që të refuzojë kërkesën për bashkim familjar bazuar në një vlerësim probabiliteti që qytetari do të mbajë ose jo burime të qëndrueshme dhe të rregullta të mjaftueshme të cilat duhet të jenë në dispozicion për të mbajtur veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar sistemin e ndihmës sociale të këtij shteti anëtar gjatë vitit në vijim të datës së aplikimit. Ky vlerësim bazohet në evolucionin e të ardhurave rezident gjatë gjashtë muajve të mëparshme të asaj date.



## KAPITULLI V: MBROJTJA E TË DREJTËS SË BASHKIMIT FAMILJAR NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

### 5.1. E drejta e bashkimit familjar në Shqipëri

E drejta e migracionit në vendin tonë, në formë të shkruar është sanksionuar në Statutet e Shkodrës ku parashikohet për herë të parë e drejta e të huajve për t'u vendosur në qytetin e Shkodrës.<sup>84</sup> Kjo dispozitë është konsideruar mjaft bashkohore për kohën pasi nëpërmjet saj është vendosur barazia në pozitën juridike të të huajve me banorët e qytetit të Shkodrës. Të drejtën e bashkimit familjar nuk e gjejmë shprehimisht të sanksionuar në këtë nen dhe as në ndonjë nen tjetër të statuteve të Shkodrës, por ajo është e nënkuptuar, dhe në momentin që një individ trajtohej në bazë të nenit 1 të Statuteve të Shkodrës ai gëzonte të gjitha të drejtat e parashikuara për banorët vendas, sepse nëpërmjet nenit 1 të statuteve synohej të evidentohet barazia me çdo qytetar të komunës, shkodran apo jo. Pas shpalljes së Pavarësisë gjatë dy luftërave botërore Shqipëria, vuajti nga ndryshimi i shpeshtë i regjimeve dhe okupimeve periodike për një periudhë të gjatë kohore. Në vitin 1944 me marrjen e pushtetit nga Partia Komuniste mund të themi që vendi pësoi një izolim total i cili përjashtoi në mënyrë kategorike zhvillimin e të drejtës migratore dhe të drejtave që përftoheshin prej saj, siç ishte dhe e drejta e bashkimit familjar. Ky regjim ndalonte kategorikisht vendosjen e personave të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

---

<sup>84</sup> Në nenin 1 të statuteve të Shkodrës parashikohej që “Nëse ndokush do të dëshironte të vendosej në qytetin tonë, qoftë ky njeri i Mbretit apo i ndonjë fisniku, ai duhet t'i shërbejë vetëm Komunës sonë dhe askujt tjetër. Qytetari ynë, apo sllavi ose arbëreshi, që do të përpiqeshin ta kapnin e ta bënë pronë të tyre, do të detyroheshin t'i paguanin 50 perperë mbretit, ndërsa robin duhet ta lenë të lirë. Çdo qytetar i Komunës sonë duhet ta mbrojë atë me çdo kusht.”

Pas vitit 1991 me krijimin e Parlamentit të parë pluralist i cili shpalli Republikën Parlamentare të Shqipërisë, sistemi ligjor shqiptar hodhi hapat e para të sigurta drejt zhvillimit të politikave të reja zgjeruese të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e shoqërisë. Fillimisht e drejta e bashkimit familjar është shprehur në nenin 23 të Ligjit Nr. 8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, ku sanksionohej leja e qëndrimit si rezultat i bashkimit familjar.

Aktualisht e drejta e bashkimit familjar gëzon një mbrojtje të plotë ligjore në legjislacionin shqiptar dhe në përputhje me standartet europiane. Bashkimi familjar konsiderohet si instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shtetasit e huaj titullarë aktivë të bashkimit familjar janë të punësuarit, të vetëpunësuarit dhe refugjatët. (Canaj. E, 2014:6) Pra, bashkim familjar, sipas të drejtës shqiptare, konsiderohet hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë i anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar banor në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose janë pa shtetësi.

Kuadri ligjor aktual respekton të drejtën për bashkim familjar duke i njohur këtë të drejtë edhe çdo të huaji që ka hyrë dhe qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe është i pajisur me leje qëndrimi me kohëzgjatje jo më të vogël se një vit. Bashkimi familjar synon ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë. Kur në Shqipëri personat hyjnë familjarisht, ata që janë mbi moshën 18 vjeç duhet të aplikojnë secili më vete për një leje qëndrimi. Të miturit përfshihen në aplikimet e prindërve, gjithsesi, në momentin që ata mbushin moshën 18 vjeç dhe ndodhen akoma në Shqipëri, ata duhet të aplikojnë për të marrë një leje qëndrimi për veten e tyre.

Vendi ynë ka bërë përparim të rëndësishëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, i orientuar kryesisht në drejtim të përmbushjes së kriterëve politike dhe krijimin e institucioneve të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira me vendet e zgjerimit dhe Shtetet Anëtare. Ajo fitoi statusin e vendit kandidat për të hyrë në BE në qershor 2014 dhe ka garantimi he respektimi i të drejtave të njeriut është prioritet i tij. Në këtë kuadër janë marrë masat e duhura ligjor për garantimin dhe respektimin e të drejtës së bashkimit familjar.

## **5.2. Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të drejtës së bashkimit familjar**

Shqipëria si një vend i cili ka qenë në izolim për një kohë shumë të gjatë, ka kërkuar me padurim integrimin në sistemet ndërkombëtare dhe europiane. Dalja nga izolimi e gjeti Shqipërinë me një kuadër ligjor të munguar në fusha të rëndësishme, ku një ndër këto ishte dhe ligji i të huajve në Republikën e Shqipërisë. E gjendur në kushtet e mungesës së legjislacionit përkatës dhe ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike të cilat kishin stimuluar lëvizjen e personave në shtete të ndryshme, u pa e nevojshme hartimi i ligjeve përkatëse të cilat do të rregullonin hyrjen, kalimin dhe qëndrimin e të huajve në vendin tonë. Shqipëria është përballur gjithmonë me fenomenin e migracionit i cili ka qenë në evoluim të vazhdueshëm. Për rrjedhojë, janë bërë dhe ndryshime të vazhdueshme në kuadrin e qeverisjes të legjislacionit të migracionit duke krijuar një lidhje të ngushtë ndërmjet legjislacionit shqiptar dhe konventave ndërkombëtare që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në fushën e migracionit.

Ndryshimet e vazhdueshme të legjislacionit shqiptar kanë ardhur si domosdoshmëri për harmonizimin e tij me standardet e Bashkimit Evropian në kuadër të anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian. Kështu Shqipëria ka hyrë në një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian, nënshkruar atë më 12 qershor 2006 dhe mori liberalizimin e vizave për qytetarët e saj brenda zonës së Shengenit në vitin 2010. (Canaj.E& Bana.S.2011: 262) Vendi ka bërë përparim të rëndësishëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, i orientuar kryesisht në drejtim të përmbushjes së kriterëve politike dhe krijimin e institucioneve të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira me vendet e zgjerimit dhe Shtetet Anëtare. Ajo fitoi statusin e vendit kandidat për të hyrë në BE në qershor 2014. Shqipëria ka integruar të gjitha direktivat që lidhen me emigracionin dhe azilin të paraqitura nga BE-ja dhe merr pjesë në negociatat rreth masave të reja të migrimit dhe azilit në nivel rajonal.

Kuadri i parë ligjor për të huajt në Republikën e Shqipërisë u krijua me ligjin nr. 9959 datë 18.7.2008 “Për të huajt”,<sup>85</sup> ligjin nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 9098 datë 03.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”, të cilat janë pasur

---

<sup>85</sup>Sipas nenit 32 të Ligjit nr. 9959 Për të Huajt i vitit 2008 përcaktohet se : “1. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi, i cili qëndron dhe punon në Republikën e Shqipërisë, mund të bëjë kërkesë pranë Policisë Kufitare dhe Migracionit, vendore, për të sjellë familjen, për efekt të ribashkimit familjar, nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; b) qëndron prej jo më pak se 1 vit në Republikën e Shqipërisë; c) siguron jetesën, në mënyrë të rregullt, në Republikën e Shqipërisë nga të ardhurat apo pronat e bashkëshortit, që qëndron në Republikën e Shqipërisë ose, në rastin e të miturve, nga të ardhurat apo pronat e prindërve; ç) derdh kontribute në sigurimet shëndetësore, për të mbuluar shërbimet e kujdesit shëndetësor; d) garanton mjedise dhe kushte të përshtatshme qëndrimi për familjen; dh) paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave. 2. Leja e qëndrimit për ribashkim familjar jepet për një periudhë kohe jo më shumë se leja e qëndrimit të personit, i cili bën kërkesën për ribashkim familjar. 3. Në rast se i refuzohet dhënia e lejes për ribashkim familjar, i huaji ka të drejtë të ankohet pranë ministrit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim”.

nga ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme duke u përshtatur mjaftë mirë me kërkesat aktuale.

Aktualisht burimet kryesore të së drejtës për bashkim familjar dhe unitet familjar të të huajve të vendin tonë janë: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt”; Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë”. Në fokus të studimit tonë do të jetë pikerisht e drejta e bashkimit familjar ne territorin e Republikes se Shqiperise.

### **5.2.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e miratuar në 1998 është dokumenti themeltar i cili garanton dhe mbron liritë dhe të drejtat e njeriut.<sup>86</sup> Më shumë se një e katërta e neneve të Kushtetutës shqyrton çështjet e të drejtave të njeriut dhe institucioneve që përgjigjen për garantimin e tyre, funksioni i drejtpërdrejtë i të cilave është mbrojtja e të drejtave të njeriut. Si çdo kushtetutë e vendeve me demokraci të konsoliduar edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm të gjitha marrëveshjet dhe aktet ndërkombëtarë të cilat garantojnë të drejtat e njeriut. (Daci.J,2011:387) Kushtetuta në përputhje me aspektin universal të këtyre të drejtave përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara janë njësoj të zbatueshme për shtetasit shqiptarë, të huajt dhe personat pa shtetësi. Kushtetuta në përputhje me aspektin universal të këtyre të drejtave përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e

---

<sup>86</sup> Shih nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: "Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat e njeriut dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i popullit shqiptar me pakicat, përbëjnë themelet e këtij shteti, detyrë e të cilit është të vëzhgojë dhe mbrojë këto të drejta dhe liritë e njeriut".

parashikuara janë njësoj të zbatueshme për shtetasit shqiptarë, të huajt dhe personat pa shtetësi. Kështu, në nenin 16 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se “Të gjitha të drejtat dhe liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë njëloj edhe për të huajt dhe personat pa shtetësi që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Kushtetuta e lidh ushtrimin e tyre në mënyrë të posaçme me shtetësinë”.

Si një nga të drejtat që mbron familjen si njësi natyrore, e drejta e bashkimit familjar garantohet edhe nga sistemi ligjor shqiptar. Ajo është një e drejtë kushtetuese e cila është e sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se “Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje”. E drejta e bashkimit familjar parashikohet edhe për të huajt që gjenden në Shqipëri.<sup>87</sup> Sanksionimi i kësaj të drejte në Kushtetutë tregon që e drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore dhe shumë e rëndësishme për individët sepse nëpërmjet institutit të bashkimit familjar një personi i njihet e drejta për t’u bashkuar me anëtarët e familjes së tij në një Shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes.

### **5.2.2. Ligjin Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt”**

Legjislacioni ynë është i plotë dhe aktualisht janë bërë dhe ndryshimet e fundit në përputhje me standartet evropiane në lidhje me trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht e drejta e bashkimit familjar për personat e huaj që janë vendosur në territorin shqiptar rregullohet me Ligjin Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt”. Me anë të këtij ligji rregullohet regjimi i hyrjes, qëndrimit, punësimit dhe daljes së të huajve në Shqipëri. Të gjithë personat të huaj dhe shtetasit pa shtetësi, të cilët hyjnë ose synojnë të

---

<sup>87</sup> Shih neni 16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

hyjnë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin, si dhe daljen e tyre nga Republika e Shqipërisë<sup>88</sup> janë subjekt të tij. Ligji në nenin 1 të tij përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike dhe private, shqiptare ose të huaja që kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë. Marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura me qeveritë e shteteve të tjera, të ratifikuara me ligj, mund të parashikojnë dispozita të veçanta e më të favorshme për shtetasit e këtyre vendeve, që zbatohen reciprokisht.

Me hartimin e këtij ligji është synuar lehtësimi i aksesit në tregun shqiptar të punës duke garantuar një trajtim të barabartë të qytetarëve shqiptarë me qytetarët e BE-së, dhe jo vetëm. Ligji Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” është përafruar plotësisht me Direktivën 2003/86 KE “Mbi të drejtën e bashkimit familjar” dhe me aktet e tjera evropiane në lidhje me këtë temë. Vlen të theksojmë këtu se rendesi ka edhe perputhja me Direktivën 2004/38 KE, nisur nga fakti që kjo direktivë trajton bashkimin familjarë të qytetarëve evropian dhe pse Shqipëria ende nuk është anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

E drejta për bashkim familjar si një e drejtë themelore e sanksionuar në shumë akte ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe evropiane gjendet e sanksionuar edhe në Ligjin Nr. 108 datë 28.03.2013 “Për të huajt” në Republikën e Shqipërisë. Kjo e drejtë është shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi, si dhe në mënyrë të veçantë në kuadër të ruajtjes së unitetit familjar. (Canaj.E:2013:6) Të drejtën e bashkimit familjarë e gjejmë të përcaktuar në Seksioni V ku rregullohet leja e qëndrimit për motive të bashkimit familjar. Në bazë të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” në

---

<sup>88</sup>Shih Nenin 2 i Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë

Republikën e Shqipërisë e drejta e bashkimit familjar i njihet çdo të huaji që ka hyrë dhe qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe është i pajisur me leje qëndrimi me kohëzgjatje jo më të vogël se një vit.<sup>89</sup> Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet se do t'i hiqet leja e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, çdo të huaji që vërtetohet se ka kryes një martesë fiktive.

Sipas këtij ligji anëtarë të familjes që mund të aplikojnë për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjarë janë bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç, fëmijët e birësuar ose në kujdestarinë e të huajit, fëmijët e bashkëshortit/ bashkëshortes së tij/saj, prindërit e moshuar, në ngarkim të të huajit. Kërkesa për bashkim i referohet familjes që buron nga martesa monogame. Përfshihet në këtë kategori partneri. Në rast të të huajve që vijnë nga një vend ku poligamia është e ligjshme, i huaji që kërkon bashkim familjar duhet të zgjedhë vetëm një nga bashkëshortet. Zgjidhja për këta anëtarë të familjes është në përputhje të plotë me legjislacionin komunitar, madje shkon edhe më tej, duke lejuar edhe prindërit nëse janë në ngarkim. Ligji përcakton kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e të drejtës së bashkimit familjarë që të përfitojnë nga kjo të drejtë.<sup>90</sup> Po kështu përcakton dhe procedurat për marrjen e lejes së qëndrimit afatgjatë<sup>91</sup> dhe lejet qëndrimit afatshkurtër etj. Këto proceduar do të trajtohet në mënyrë të detajuar më poshtë në punime.

### **5.2.3. Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë”.**

Shqipëria përpara viteve 90 ishte një vend i izoluar dhe individët ishin të privuar nga shumë të drejta, duke përfshirë të drejtën e lëvizjes drejt vendeve të ndryshme por ishte

---

<sup>89</sup> Shih nenin 55 të Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt” të Republikën e Shqipërisë.

<sup>90</sup> Shih nenin 56 të Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt” të Republikën e Shqipërisë.

<sup>91</sup> Shih nenin 66 të Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt” të Republikën e Shqipërisë.



dhe e privuar edhe e drejta e vendosjes së të huajve në vendin tonë. Dalja nga izolimi u shoqërua me nisma të rëndësishme ligjore të cilat synonin krijimin dhe përafrimin e legjislacionit me standartet ndërkombëtare. (Canaj,2010:31) Nismat e para në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve datojnë në vitin 1992 ku Shqipëria në bashkëpunim me organizatat e huaja ka ofruar asistencë dhe ndihmë për azilantët, dhe azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shqipëria si një shtet që promovon dhe nxit vlerat themelore njerëzore, ka krijuar kuadrin ligjor, infrastrukturor dhe burimet e nevojshme (sipas kushteve) për sistemin e azilit. Shqipëria ka ratifikuar thuajse të gjitha aktet ndërkombëtare të mbrojnë të drejtat e refugjatëve si Konventa e Gjenevës e vitit 1951 bashkë me Protokollin Shtesë të vitit 1967. (Janeczko,2013:135)

Ratifikimi i akteve ndërkombëtare kërkon domosdoshmërisht miratimin e legjislacionit kombëtar dhe akteve nënligjore që lidhen me azilin, i cili do të garantonte respektimin e këtyre akteve. Ligji i parë i krijuar i cili rregullonte të drejtën e azilit në Shqipëri është Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 "Për azilin". Ai ishte akti kryesor ligjor që i ofronte mbrojtje të përkohshme për të huajt të cilët janë në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatët apo personat e tjerë, si dhe u siguronte njohjen e të drejtës për azil. Ky ligj ka qenë subjekt i disa ndryshimeve dhe aktualisht rregullimi ligjor i të drejtave të azilkërkuesve në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet nga Ligji Nr. 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë".

Në Kreun VII të Ligjit Nr. 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë" trajtohet bashkimin familjar i refugjatit<sup>92</sup> dhe e drejta për bashkimin familjar të refugjatit sanksionohet në nenin 64 të tij. Në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet që "Anëtarët e

---

<sup>92</sup> Shih nenin 65 të Ligjit Nr. 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë".

familjes së refugjatit dhe ata nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar. Këtë të drejtë mund ta gëzojnë përjashtimisht edhe personat që janë nën mbrojtje të përkohshme.” Po ashtu dhe refugjati i mitur dhe i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me prindërit, motrat, vëllezërit, anëtarë të tjerë të familjes, të cilët bashkëjetojnë me të ligjërisht ose që janë të mitur dhe të pamartuar.<sup>93</sup> Aplikimi për bashkim familjar mund të bëhet vetëm pas dhënies së vendimit përfundimtar. Po kështu ligji trajton dhe të drejtat e anëtarëve të familjes së refugjatit për bashkim familjar <sup>94</sup> si dhe rregullat për hyrjen dhe qëndrimin e anëtarëve të familjes, çështje që to të trajtohen në mënyrë më të detajuar në vazhdimësi të punimit.

### 5.3. Subjektet që përfitojnë të drejtën e bashkimit familjar

Kushtetuta është baza e legjislacionit shqiptar për të huajit në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nenin 15 të saj parashikohet së të huajit gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë. Kushtetuta në nenin 53 garanton të drejtën familjarë për çdo individ<sup>95</sup> duke i siguruar mbrojtje të veçantë nga shteti.<sup>96</sup> Bashkimi familjar është një e drejtë që garantohet edhe në vendin tonë dhe për shtetasit e huaj. (Canaj.E ,2013:6) Kuadri ligjor aktual rregullon dhe garanton të drejtën e bashkimit familjar në përputhje me dispozitat

---

<sup>93</sup> Shih nenin 64 të Ligjit Nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>94</sup> Shih nenin 66 të Ligjit Nr. 121/2014 Për Azilin në Republikën e Shqipërisë ku përcaktohet se “Anëtarët e familjes së refugjatit, që kanë përfituar nga vendimi për bashkim familjar, kanë të njëjtat të drejta sikurse dhe aplikuesi për: a) arsimim në institucionet arsimore publike; b) punësim dhe vetëpunësim; c) këshillim profesional dhe trajnim”

<sup>95</sup> Shih nenin 53 paragrafi 2 I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,” Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. “

<sup>96</sup> Shih nenin 53 paragrafi 2 I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,” Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit’

kushtetuese dhe direktivat e Këshillit të BE-së.<sup>97</sup> Në nenin 56 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” përcakton kriteret që duhet të plotësojë i huaji që të mund të ushtrojë të drejtën e bashkimit familjarë. Sipas këtij neni e drejta e bashkimit familjar i njihet çdo të huaji që:

1. anëtarët e familjes së tij ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. është i pajisur me leje qëndrimi me afat minimalisht 1-vjeçar në Republikën e Shqipërisë
3. siguron strehim në kushte normale jetese, sipas standardeve të përgjithshme mbi shëndetin dhe sigurinë;
4. ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij,
5. garanton burime të qëndrueshme të ardhurash financiare për të mbajtur veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike etj.

Kërkesën për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjar e bën vetë i huaji, dhe ajo i referohet familjes e cila vjen nga një martesë monogame. (Ikononi.L,2011:174) Në nenin 3 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” jepet një shpjegim i termave të cilët trajtohen dhe janë subjekt të këtij ligji, dhe në paragrafin 14 të nenit 3 përcaktohet<sup>98</sup>, anëtarë të familjes janë:

- bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar;
- të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të

---

<sup>97</sup> Shih Direktivën Nr86/2003

<sup>98</sup>Shih nenin 3 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt”

birësuar me vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundën objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore;

- paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.

Po e njëjta kategori subjektësh përfituese parashikohet edhe nga Ligji Nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, të cilëve u akordohet e drejta për bashkim familjar.

Koncepti i anëtarëve të familjes ka evoluar dhe ka pësuar ndryshime, kjo pasi në ligjin Nr. 8492, datë 27.5.1999 “Për të Huajt”, konsideroheshin anëtarë të familjes vetëm bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, fëmijët nën 18 vjeç, të pamartuar dhe që bashkëjetojnë me prindërit; anëtarë të tjerë të familjes të cilët bashkëjetojnë ligjërisht, njerku/njerka.<sup>99</sup>

Ndërsa sipas ligjit Nr. 9959, dt 17.7.2008 “Për të Huajt” anëtar të familjes konsiderohen: bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç, fëmijët e birësuar ose në kujdestarinë e të huajit, fëmijët e bashkëshortit/bashkëshortes së tij/saj, prindërit e moshuar, në ngarkim të të huajit.<sup>100</sup>

### **5.3.1. Bashkëshorti/ja, bashkëjetuesit/si**

---

<sup>99</sup> Shih nenin 2 paragrafi Ligjit Nr. 8492, datë 27.5.1999 “Për të Huajt”,

<sup>100</sup> Shih nenin 3 paragrafi 1 të ligjit Nr. 9959, dt 17.7.2008 “Për të Huajt”

Në bazë të kuadrit aktual ligjor bashkimi familjar lejohet vetëm për kategori të caktuar personash të cilët gëzojnë statusin e familjarit. Kështu, kategoria e parë që në bazë të legjislacionit tonë është ajo e bashkëshortëve dhe e bashkëjetuesve. Në Kodin e Familjes përcaktohen cilët konsiderohen bashkëshortë nga martesë, përcaktohen gjithashtu dhe ndalimet për lidhjen e martesës dhe rastet e pavlefshmërisë së martesës. Kështu, në nenin 7 të Ligjit Nr. 9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes në paragrafin e parë përcaktohet se “Martesë mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.”. Pra legjislacioni shqiptar përjashton martesën poligame<sup>101</sup> duke specifikuar fare qartë që bashkëshortë konsiderohen personat që vijnë nga një martë monogame. Ndalimet ligjore të vendosura nga legjislacioni shqiptar rëndojnë edhe mbi martesën e shtetasit të huaj kur ai kërkon bashkimin familjar në Republikën e Shqipërisë.<sup>102</sup> Nëse në shtetin e origjinës të të huajit lejohet martesë e personave me gjini të njëjtë atëherë bashkëshorti i të huajit nuk mund të gëzojë të drejtën e bashkimit familjar sepse në bazë të legjislacionit shqiptar martesë midis personave të të njëjtit seks nuk është e lejuar.<sup>103</sup> Pra, sipas legjislacionit shqiptar martesë lidhet midis një burri dhe një gruaje, për rrjedhojë nuk mund

<sup>101</sup> Shih nenin 9 të Ligjit Nr. 9098, dt 3.7.2003, ku në nenin 9 përcaktohet se “Nuk mund të lidhet martesë të re personi që është martuar, derisa martesë e mëparshme nuk është shpallur e pavlefshme ose nuk është zgjidhur.”

<sup>102</sup> Shih nenet 9-14 të Ligjit Nr. 9098, dt 3.7.2003, ku në nenin 10 përcaktohet se “Nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungji dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave. Gjykata, për shkakë me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave.” neni 11 përcaktohet se “Nuk mund të lidhin martesë midis tyre vjehrrit dhe nusja, vjehrra dhe dhëndri, njerku dhe thjeshtër, njerka dhe thjeshtër, pavarësisht se martesë që ka krijuar këtë lidhje është shpallur e pavlefshme, ka pushuar ose është zgjidhur” neni 12 përcaktohet se “Nuk mund të lidhet martesë personi që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të pa aftë të kuptojë qëllimin e martesës.” Neni 13 përcaktohet se “Ndalohej martesë midis kujdestarit dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria.” Neni 14 përcaktohet se “Ndalohej martesë midis birësuesit e të birësuarit dhe pasardhësve të tyre, të birësuarit dhe bashkëshortit të birësuesit, midis birësuesit e bashkëshortit të të birësuarit, midis të birësuarve, si dhe midis të birësuarit dhe fëmijëve të birësuesit.”

<sup>103</sup> Shih nenin 7 të Ligjit Nr. 9098, dt 3.7.2003 ku përcaktohet se “Martesë mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.”

të ketë statusin e bashkëshortit burri i cili ka lidhur martesë me person të të njëjtës gjini në shtetin e origjinës. Kjo është një risi e ligjit aktual sepse legjislacioni i mëparshëm i lejonte personat që vinin nga një martesë poligame që të ushtronin të drejtën e bashkimit familjar, kur bashkëshortët jetonin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pra, i huaji kishte të drejtë të kërkonte të ushtronte të drejtën e bashkimit familjar me bashkëshortin ose bashkëshorten e martesës së parë dhe me fëmijët e këtij bashkëshorti ose bashkëshorteje<sup>104</sup>.

Legjislacioni kombëtar njeh bashkëjetesën si një formë juridike të rregullt të krijimit të raporteve familjare duke e parashikuar atë në nenin 163 të Ligjit Nr. 9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes ku përcaktohet se “Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”. Në lidhje me kategorinë e bashkëjetuesve legjislacioni ynë përfshin në këtë kategori personat, bashkëjetesa e të cilëve ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar.<sup>105</sup> Në rastet e bashkëjetesës vlejnë të njëjtat rregulla si të martesës, që kanë të njëjtin rregullim ligjor. Kështu, nuk mund të kërkojnë bashkim familjar në cilësinë e familjarit, personat që kanë një raport bashkëjetese e cila nuk njihet nga legjislacioni shqiptar.

Në nenin 63 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” përcaktohet se “i huaji kërkuar (ftues) dhe përfituesi kanë lidhur një martesë fiktive për përfitimin e lejes së qëndrimit”. Nga interpretimi i kësaj dispozite arrijmë në përfundimin se në raste se

---

<sup>104</sup> Shih nenin 26 i Ligjit Nr 9098, dt 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”

<sup>105</sup> Shih nenin 164 të të Ligjit Nr .9098, dt 3.7.2003 ku përcaktohet se “Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.”

provohet që bashkëshortët kanë realizuar një martesë fiktive<sup>106</sup> me synimin e përfitimit të bashkimit familjar atëherë do të mohohet e drejta e bashkimit familjar dhe nëse kjo e drejtë është akorduar ajo duhet të anulohet. Madje legjislacioni ynë shkon përtej heqjes së lejes së qëndrimit të këtë raste duke parashikuar dhe ndëshkime administrative për të huajin ose shtetasin shqiptar që lidh martesë fiktive me qëllim përftimin e lejes së qëndrimit pa pasur për qëllim realizimin e qëllimeve të martesës. (Ikonomi, L,2011:175) Në rastin kur ka prova të një martesë fiktive të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër, atëherë martesë do të konsiderohet fiktive. Kjo dispozitë është në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit, kjo për faktin sepse ligji nuk përcakton cilat o t konsiderohen prova të cilat o të vërtetojnë fiktivitetin e një martesë, duke lënë hapësirë për abuzime dhe seleksionime. Pra, personat të cilat do të gjykojnë vërtetësinë e provave mund të jenë paragjykses dhe subjektiv në marrjen e vendimit të tyre duke u mohuar në këtë mënyrë të drejtën e bashkimit familjar personave. Në rast të vdekjes së të huajit që ka kërkuar bashkimin familjar, bashkëshorti/ja apo paraardhësit dhe pasardhësit, të cilët kanë qëndruar në Republikën e Shqipërisë me leje qëndrimi për motiv të bashkimit familjar së paku 3 vjet, gëzojnë të drejtën e aplikimit për leje qëndrimi në mënyrë të pavarur<sup>107</sup>.

---

<sup>106</sup> Shih nenin 59 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” ku përcaktohet se “Do të quhet martesë fiktive, në bazë të legjislacionit shqiptar nëse plotëson një nga rrethanat: bashkëshortët, pas bashkimit familjar, nuk jetojnë së bashku pa ndonjë arsye; bashkëshortët, pas bashkimit familjar, nuk përmbushin detyrimet martesore ndaj njëri-tjetrit; bashkëshortët nuk janë takuar përpara se ata të lidhnin martesën; bashkëshortët nuk janë në gjendje të japin të dhëna personale të njëri-tjetrit që përputhen në mes tyre; bashkëshortët nuk flasin një gjuhë apo formë komunikimi të kuptueshme nga të dy; për lidhjen e martesës ose bashkimin familjar janë paguar shuma financiare ose janë shkëmbyer pasuritë martesore, përveç rastit kur këto pasuri janë pjesë e pajës dhe bashkëshortët vijnë nga vende ku shkëmbimi i pajës është traditë; ka prova të një martesë fiktive të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër.

<sup>107</sup> Shih nenin 57 pika 3 e Ligjit Nr.108/2013 “Për të Huajt”.

E drejta e bashkimit familjar mund të kërkohej edhe pas zgjidhjes së martesës në bazë të legjislacionit evropian. Legjislacioni kombëtarë mbanë një qëndrim të kundërt me atë europin në këtë drejtim. Kështu në vendin tonë nëse i huaji ka përfituar lejen e qëndrimit për shkak të bashkimit familjar dhe martesa prej nga ka marrë statusin e familjarit, në cilësinë e bashkëshortit është zgjidhur, atij mund të refuzohet ripërtëritja apo të anulohet. Në nenin 57 paragrafi 2 përcaktohet se në rast të zgjidhjes të martesës apo bashkëjetesës, brenda periudhës 5-vjeçare nga përfitimi i lejes së parë të qëndrimit, për efekt të bashkimit familjar, kjo e drejtë humbet.

### **5.3.2. Fëmijët**

Pavarësisht faktit nëse marrëdhëniet familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, synimi i bashkimit familjar është ruajtja e unitetit familjar dhe ruajtja e familjes. Në lidhje me bashkimin familjar të fëmijëve në legjislacionin shqiptar parashikohet se fëmijët në moshë madhore, pra që janë mbi 18 vjeç, duhet të aplikojnë më vete për të fituar këtë të drejtë. Ndërsa të miturit përfshihen në aplikimet e prindërve, por, në momentin që ata mbushin moshën 18 vjeç dhe ndodhen akoma në Shqipëri, ata duhet të aplikojnë për të marrë një leje qëndrimi për veten e tyre. (Canaj. E,2013:7) Legjislacioni ynë përfshin në kategorinë e pasardhësve të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykatë apo një vendim që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk



munden objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.<sup>108</sup>

Kjo është korniza familjare e një familje të përbërë nga shtetasit jo komunitarë në kuadër të bashkimit familjar, pra familja e vogël. Shteti nuk mund të refuzojnë hyrjen dhe qëndrimin e familjes së përbërë në këtë mënyrë përveç rasteve kur anëtari i familjes përbën një kërcënim real dhe serioz për rendin publik, sigurinë kombëtare ose shëndetin publik. Legjislacioni ynë i brendshëm parashikon mundësinë që me anë të akteve ligjore të tjera mund të autorizohet hyrja e të afërmeve të tjerë që janë fëmijët e rritur të pamartuar të titullarit ose të bashkëshortit ose bashkëshortes, kur ata nuk janë objektivisht në gjendje për të siguruar nevojat vetjake për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore. Në nenin 69 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” jepet parashikon se në rast të një martese poligame, ku titullari e ka një bashkëshorte që jeton në territorin e një Shteti tjetër, Shteti ynë pritës nuk duhet të autorizojë bashkimin familjar të bashkëshortes së dytë. Pavarësisht nga sa fëmijë ka titullari në fjalë, ne e kufizojmë bashkimin familjar të fëmijëve të mitur të tij dhe të një bashkëshorte tjetër. Nuk ka rëndësi cilat nga bashkëshortet kërkon dhe përfiton bashkimin familjar. Me anë të kësaj dispozite kërkohet të ndalohen të gjitha rastet e familjeve poligame, edhe që realizohen në territorin e Shqipërisë, pasi këto martesë nuk janë të ligjshme në shume vende. Fëmijët që vijnë nga bashkëjetesa Në pothuajse të gjitha elementet e ligjit për të huajt kemi përputhje me legjislacionin europian përkatës, edhe pse nuk specifikohet kategoria e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë. I vetmi ndryshim dhe mospërputhje haset në përcaktimin e saktë të kategorive si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj.

---

<sup>108</sup> Shih nenin 3 paragrafi 14 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt”.

pasi ligji në fjalë e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejtë themelore. Fëmijët e pamartuar mund të aplikojnë për leje qëndrimi për bashkim familjar deri në moshën 30 vjeç, me kusht që i huaji kërkues të garantojë mbulimin e të gjitha shpenzimeve të jetesës për ta.

### **5.3.3. Paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë**

Legjislacioni i brendshëm parashikon mundësinë e paraardhësve të drejtpërdrejtë të titullarit ose të bashkëshortit kur ata janë ekonomikisht të varur prej tyre dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës. Pra paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të personit që kërkon bashkim familjar, ose paraardhësi i bashkëshortit përfshihen në kategorinë e familjarit. Që të lejohet bashkimi familjar këto persona duhet që në vendin e origjinës të mos kenë mbështetjen e duhur familjare. Kjo kategori pajiset me leje qëndrimi si raste përjashtimore.

## KAPITULLI VI: PROCEDURAT E BASHKIMIT FAMILJAR NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR DHE PROBLEMATIKAT QE HASEN NE PRAKTIKE

### 6.1. Procedura e aplikimit për bashkim familjar në legjislacionin shqiptar

I huaji i pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, mund të bëjë kërkesë pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për bashkim familjar, nëse plotëson kriteret e përcaktuara<sup>109</sup> në Ligjin Nr. 108/2013 “Për të Huajt”. Institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e qarkullimit të personave që kalojnë kufirin e Shqipërisë, në kuadër të politikave për menaxhimin e emigrimit është MPB-ja. Ajo vlerëson gjithashtu dhe rastet e azilit dhe vendosjen nëse duhet dhënë ose jo statusi i refugjatit azilkërkuesve. MBP-ja e ushtron kontrollin nëse kalimi kufitar është në përputhje me ligjin me anë të Policisë Kufitare, e cila ka për detyrë të mbajë nën vëzhgim kufirin shtetëror, kontrollon dhe refuzon në vendkalimet kufitare dhe në vijën e kufirit shtetasit e huaj dhe mjetet që kalojnë ose përpiqen të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme. Kërkesat themelore për hyrjen e të huajve dhe familjarëve të tyre në Shqipëri janë të parashikuara Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë”<sup>110</sup> dhe në Vendimin Nr 513 të 13 qershorit 2013 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë". Në nenin 6 të Ligjit për të Huajt paraqiten kërkesat formale përmbajnë detyrimin e hyrjes dhe daljes nëpërmjet

---

<sup>109</sup> Shih nenet 32, 33, 34, dhe 35 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë

<sup>110</sup> Shih nenet 6.7.8.9.10.11 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë

portave kufitare me pasaportë të vlefshme ose dokumenteve zëvendësuese të pasaportave dhe detyrimin për të marrë një vizë<sup>111</sup>, kriteret që vlejnë edhe për familjarët e të huajit.

Në nenin 56 të Ligjit Nr.108/2013 “Për të Huajt” përcaktohen procedura dhe kriteret që duhet të plotësoj i huaji që të mund të ushtroj të drejtën e bashkimit familjar. Kështu i huaji mund të kërkojë të ushtroj të drejtën e bashkimit familjar vetëm nëse ai ka hyrë në mënyrë të ligjshme në RSH dh është i pajisur me leje qëndrimi jo më pak se 1 vit dhe ka mundësi ta ripërtërijë lejen.(Ikonomi. L,2013:175) Kërkesën për bashkim familjarë e paraqet pranë autoritetit shtetëror përgjegjës, në nivel vendor, për trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë. I huaji, për të kërkuar bashkimin familjar duhet të që vërtetoj që <sup>112</sup>:

1. anëtarët e familjes së tij ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.<sup>113</sup>
2. është i pajisur me leje qëndrimi me afat së paku 1-vjeçar në Republikën e Shqipërisë dhe ka mundësi ta ripërtërijë lejen
3. siguron kushte normale jetese, sipas standardeve të përgjithshme mbi shëndetin dhe sigurinë;
4. disponon sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij, për të cilët kërkon bashkimin familjar;
5. garanton burime të qëndrueshme të të ardhurave financiare për të mbajtur veten familjen e tij,

---

<sup>111</sup> Shih Nenin 6 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë “Kriteret e hyrjes, qëndrimit, daljes dhe transitit “

<sup>112</sup> Shih nenin 56 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë

<sup>113</sup> Shih nenin 56 paragrafi 1/a të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë “Përjashtimisht, për arsye humanitare, sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe procedurave të miratuara me udhëzim të Ministrit të Brendshëm, kërkesa mund të bëhet dhe kur anëtar/ët e familjes ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë; “

6. nuk duhet të jetë një individ që mund të mbahet me ndihmë ekonomike etj.

Nga analizimi i kësaj dispozite vërejmë se legjislacioni shqiptar është hartuar duke ndjekur modelin e legjislacionit Italian porsa i përket bashkimit familjar, duke vendosur kështu kushtet minimale financiare për jetesë. Në legjislacionin shqiptarë gjendet një kushte i cili nuk haset në legjislacionet komunitar, i cili trajtoj pagimin e sigurimit shoqërore. Po kështu një tjetër kriter i cili është në kundërshtim me legjislacionin komunitar është kriteri që i huaji duhet të ketë hyrë në mënyrë të ligjshme në RSH. Kjo është në kundërshtim me qëndrimet e mbajtura nga GJEDNJ-ja dhe nga Bashkimi Evropian. Për fëmijët e pamartuar, si dhe paraardhësit e kërkuesit, që janë objektivisht të pamundur të plotësojnë nevojat e tyre, për arsye të gjendjes shëndetësore, mund të jepet leje qëndrimi si raste përjashtimore.

Familjarëve për të qëndruar në territorin e RSH u jepet leje “D/BF, vizë e tipit D për bashkim familjar me vlefshmëri njëvjeçare, kohë qëndrimi 90 ditë, me një, dy apo më shumë hyrje-dalje, e cila i jep të drejtë mbajtësit të aplikojë për t’u pajisur me leje qëndrimi pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë<sup>114</sup>. Kjo është viza që i jepet fillimisht. Leja e qëndrimit ripërtërihet më pas për një periudhë dyvjeçare<sup>115</sup>.

Në fushën e azilit, korniza institucionale dhe ligjore është vënë në funksion, dhe Ligji për Azilin është gjithashtu në përputhje me standardet e BE. Përsa i përket të drejtës së bashkimit familjar dhe procedurës së bashkimit familjarë të azilkërkuesit Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë” parashikon në nenin 64 që “Anëtarët e

---

<sup>114</sup>Shih nenin 22 të Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt.

<sup>115</sup>Shih nenin 55 të Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt.

familjes së refugjatit dhe ata nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë<sup>116</sup> gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar. Këtë të drejtë mund ta gëzojnë përjashtimisht edhe personat që janë nën mbrojtje të përkohshme.”. Kërkesa për bashkim familjar paraqitet duke plotësuar formularin e veçantë të aplikimit, pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët nga ana e refugjatit dhe personave në mbrojtje.<sup>117</sup> Procedura e bashkimit familjarë kërkon që aplikuesi për të qenë subjekt i ushtrimit të të drejtës së bashkimit familjarë duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 63 të Ligjit Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë”<sup>118</sup> Legjislacioni ynë kërkon një standard të të provuarit të lartë në momenti që kërkon që dokumentat e aplikimit duhet të jenë të noterizuara, çka synon eliminimin e dokumentacioneve të falsifikuara.<sup>119</sup> Procedura e shqyrtimi i aplikimit për bashkim familjar fillon brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të aplikimit, ndërsa vendimi për aplikimin për bashkim familjar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merret brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit.<sup>120</sup> Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë” përcakton e në rastin kur aplikimi për bashkimin familjar ka lidhje me një të mitur të pashoqëruar, vendimi merret brenda 20 ditëve nga dita

---

<sup>s</sup> Shih nenin 3 të Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë” “Status i mbrojtjes plotësuese” është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i të huajt ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese.

<sup>117</sup> Shih nenin 7 paragrafi 1 të Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>118</sup> Shih nenin 63 të Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë”. Në rastin e paraqitjes së aplikimit për bashkim familjar, aplikuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme: a) të sigurojë strehim në kushte normale jetese, sipas standardeve për shëndetin dhe sigurinë; b) të garantojë sigurimin shëndetësor për vete dhe familjen e tij; c) të garantojë burime të qëndrueshme të ardhurash financiare për të siguruar veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar skemës së sigurimeve shoqërore apo pa qenë në ngarkim të Buxhetit të Shtetit.”

<sup>119</sup> Shih nenin 63 paragrafi 4 i Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” Formulari i aplikimit duhet të shoqërohet me një kopje të noterizuar të dokumenteve të udhëtimit të anëtarëve të familjes dhe me prova të dokumentuara të 23 lidhjes familjare të aplikuesit me personin ose personat me të cilin/të cilët kërkohet bashkimi familjar. Në formular përfshihen të dhënat biografike të personit me të cilin kërkohet bashkimi familjar dhe të dhëna për lidhjen familjare me aplikuesin. Nëse është e mundur, në mënyrë që të marrë dëshmi se ekziston një marrëdhënie familjare, organi përgjegjës mund të zhvillojë intervista apo hetime të tjera që janë të nevojshme.

<sup>120</sup> Shih nenin 63 paragrafi 9 të Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin”.

e paraqitjes së aplikimit dhe brenda 5 ditëve nga marrje e vendimit autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton me shkrim aplikuesin për vendimin.<sup>121</sup>

## **6.2. Procedura e aplikimit për bashkim familjar në legjislacionin shqiptar për refugjatet. Arritjet dhe mangesite.**

Zanafilla e veprimtarise konkrete me refugjatet perkon me pranveren e vitit 1999 kur Shqiperia hapi dyert per shtetasit kosovare (afro gjysem milione njerez) si pasoje e gjenocidit serb. Ne kete shtate, ne vendin tone vemendja u fokusua tek procesi i integritimit te refugjateve dhe gjithë personave te tjere qe gezonin azil te Republiken e Shqiperise. Pas perballimit thujse me sukses te krizes se Kosoves ne vitin 1999 shteti shqiptar ka nen administrimin e vet qe prej vitit 2004 një qendër pritje për azilkërkuesit në nivelin e kërkuar të standarteve ndërkombëtare. Po ashtu menaxhon një sistem të përzgjedhjes të zbatuar nga policia kufitare e RSH. Me rendesi ne kete drejtim paraqitet edhe përfshirja e gjithë të huajve që kërkojnë apo përfitojnë azil në RSH në skemën e sigurimeve shëndetësore dhe të ofrimit të shërbimeve shëndetësore si për shtetasit shqiptarë.

Studimi i funksionimit dhe efijencës së një sistemi azili, që korrespondon edhe me fazat e jetesës, qëndrimit dhe trajtimit të të huajve që kërkojnë azil, bëhet duke studiuar fazën e para – procedurës (mbërritja dhe kërkimi i azilit, krijimi i mundësive për të qëndruar në mënyrë dinjitoze në një vend përara intervistimit dhe marrjes së vendimit, ekzistenca e mjediseve/qendrave të pritjes sipas standarteve ndërkombëtare të kërkuara, etj), në fazën e procedurës (për përcaktimin e statusit të refugjatit) çka lidhet me mënyrën se si kryhen procedurat administrative apo gjyqësore, si jepet dhe merret informacioni mbi atë që

---

<sup>121</sup> Shih nenin 63 paragrafi 10 të Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin”.

pretendon azilkërkuesi, mundësitë e ankimit administrativ dhe gjyqësor, etj); si edhe në fazën pas proceduriale që lidhet me ofrimin e mundësive reale për jetesë dhe integrim në vendin pritës, duke shmangur qëndrimin e gjatë në asistencë dhe duke krijuar kushtet e nevojshme që refugjatët dhe personat e tjerë që kërkojnë azil të bëhen sa më shpejt të vetmjaftueshëm.

Kontakti i parë i një të huaji që hyn në RSH për të kërkuar azil drejtpërdrejt apo edhe në tranzit për të kaluar në vende të tjera, me institucionet shtetërore është me autoritetet policore e veçanërisht ato të policisë së kufirit dhe migracionit. Funkcioni parësor i kësaj policie në këtë fushë është sigurimi i moskthimit, si parim i së drejtës ndërkombëtare zakonore, i sanksionuar edhe nga Ligji Shqiptar për Azilin. Në lidhje me këtë, merr një rëndësi të madhe procedura e përzgjedhjes e zbatuar nga Policia e Kufirit dhe Migracionit.

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat Shteti Shqiptar përballlet në zbatimin e përpiktë të procedurës së përzgjedhjes është fakti që kjo procedurë është dhe duhet konceptuar si një proces i vazhdueshëm që duhet mbajtur gjithmonë në nivele të larta të zbatimit të standarteve ndërkombëtare. Praktikisht, procedura e përzgjedhjes kërkon që policia kufitare të identifikojë në zonën administrative që mbulon, përkthyes të aftë dhe të trajnuar për gjuhët më të mundshme të vendeve nga vijnë migrantët e parregullt. Ky identifikim duhet të shoqërohet me një përditësim të vazhdueshëm duke qenë se intervistimi sa më i shpejtë i individëve të kapur në kufi apo brenda territorit, ndikon drejtpërdrejt si në trajtimin e përshtatshëm të tyre – për të cilin ndihmon identifikimi i kategorisë së cilës i përkasin, ashtu edhe respektimi i afateve proceduriale që janë pjesë e punës dhe organizimit të brendshëm të procedurave policore. Po kështu, kjo procedurë kërkon që policia kufitare të jetë gjithnjë e përditësuar me njohuritë më të fundit mbi ngjarjet që mund të ndikojnë në krijimin e



flukseve të përsoneve drejt territorit të RSH. Kjo nuk lidhet vetëm me gjendjen e brendshme në shtetet fqinje, por edhe me vetë njohuritë mbi sistemin e azilit dhe trajtimin e të huajve në këto vende. Për shembull, prej shumë vitesh, një numër i madh refugjatësh, praktikisht më shumë se gjysma e popullsisë së atij vendi, janë larguar e vazhdojnë të largohen nga Somalia. Vende që janë prekur nga luftra apo konflikte të jashtme e të brendshme, si Iraku, Libia, Egjipti, Afganistani, Kongo e së fundmi e mbi të gjitha, Siria – me mbi 2 milionë refugjatë të larguar nga vendi, flasin shumë për prirjen e lëvizjeve migratore drejt zonave më të paqta e mirëqenatë botës, ku spikat Bashkimi Europian. Por jo vetëm kaq. Gjendja e vështirë ekonomike dhe mbi të gjitha trajtimi jashtë çdo standarti i të huajve të parregullt që kapen ose gjenden në territorn grek, është shkak parësor për flukset e shumta të të huajve që vijnë drejt Shqipërisë. Një pjesë e madhe e tyre përpiqen të kalojnë për në vendet e BE por një pjesë tjetër janë të gatshëm të qëndrojnë në Shqipëri përpkundrejt mundësisë së papranueshme të kthimit në vendin e tyre apo në Greqi. në këtë prizëm, është shumë i rëndësishëm edhe trainimi me njohuri për koncepte të tilla si vendi i tretë i sigurt dhe ndryshimet që mund të pësojë cilësimi si një vend i tillë, në varësi të rrethanave dhe zhvillimeve.

Ndërsa ligji përcakton saktë se kur lejohet dhe cilat organe merren me çështjet e bashkimit familjar, një sërë problemesh kanë dalë me aplikimin për bashkim familjar si të tillë. Edhe duke lënë mënjane çështjen e ngarkesës apo mbështetjes financiare për bashkimin familjar të një refugjati në Shqipëri me familjen e vet që gjendet jashtë vendit, asnjë parashikim nuk ka për rastet kur:

- Familja gjendet në një vend ku nuk ka ambasadë apo konsullatë të RSH.
- Familjarët e refugjatit e kanë praktikisht të pamundur që të shkojnë e të paraqiten

personalisht përpara ambasadës shqiptare më të afërt (rast konkret: familja gjendet 53 në Kongo dhe ambasada shqiptare kompetente më e afërt është në Egjipt ose Afrikën e Jugut). Anëtarët e familjes që u janë bashkuar personave që kanë përfutur mbrojtje të përkohshme do t'u jepet gjithashtu leje qëndrimi sipas kushteve të kësaj mbrojtje.

### **6.3. Leja e qëndrimit në kuadër të të drejtës së bashkimit familjar**

Legjislacioni Shqiptar ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në hartimin e ligjit dhe procedurave që o të përcaktojnë regjimin e vizave të ngjashme me BE-në duke njohur legjislacionin me *aquis communautaire* të BE-së. (Bhuiyan J.H.,2013:131) Hyrja e personave të huaj në Shqipëri rregullohet në ligjin "Për të huajt" si dhe procedurat e bashkimit familjar. Vendi ynë ka forcuar masat kundër emigrimit të paligjshëm me qëllim parandalimin dhe mos lejojë që të shërbej si një trampolinë për vendet e tjera të Ballkanit evropian<sup>122</sup>. Legjislacioni shqiptar në lidhje me migrimin paraqet gjashtë lloje të lejes së qëndrimit: afat shkurtër, të familjes, të studentëve, afatgjatë dhe lejeve të qëndrimit humanitare, si dhe ato të lëshuara për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. I huaji mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë afatshkurtër, periudhë të përkohshme dhe një periudhë të përhershme<sup>123</sup>. Qëndrimi afatshkurtër nuk mund të tejkalojë një periudhë prej 90 ditësh nga 180 ditë, bazuar në hyrjen me vizë ose pa viza, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj ose marrëveshje të ratifikuara nga

---

<sup>122</sup> Për të parandaluar migracionin e parregullt nëpërmjet Ballkanit Perëndimor, në nivel të BE-së, FRONTEX siguron mbështetje analitike dhe operative për vendosjen e pikave të Koordinimit në kufirin Hungari- Serbi. Aktualisht pikat koordinues të vendosura janë në Shqipëri (Muriqan) dhe IRUM (Tabanoc), me zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor të parashikuara. Shih Raportin 5 vjetor mbi emigracionin dhe azilin DMS-ja në Komisionin Europian në dispozicion në: [www.europa.eu](http://www.europa.eu).

<sup>123</sup> Shih nenin 32 të ligjit "Për të huajt".

Republika e Shqipërisë<sup>124</sup>. Në varësi të këtyre lejeve do të trajtojmë të drejtën e bashkimit familjar.

a. leja e qëndrimit afatshkurtër në kuadër të bashkimit familjar

Çdo i huaj i cili ka fituar të drejtën e qëndrimit afatshkurtër<sup>125</sup> në Republikën e Shqipërisë gëzon të drejtën e mbrojtjes së të drejtave themelore të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në traktatet e brendshme të të drejtave të njeriut në të cilat Shqipëria është palë. Një ndër këto të drejtë është edhe e drejta e bashkimit familjar. Në bazë të Ligjit Nr.108/2013 “Për të Huajt” i huaji dhe anëtarët e familjes së tij kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Shqipëri për një periudhë jo më shumë se tre muaj. Në mënyrë që të kenë të drejtë për të qëndruar në Shqipëri për një periudhë afatshkurtër, çdokush, përfshirë çdo anëtarë të familjes së të huajit duhet të plotësojë individualisht kushtet për qëndrimin afatshkurtër. Në përputhje me rrethanat, çdo pjesëtar i familjes së të huajit duhet të ketë një pasaportë dhe një vizë me përjashtim të rastit kur ai apo ajo i përkasin kategorisë së individëve që janë të përjashtuar nga një procedurë e tillë. Bashkëshorti dhe fëmijët e të huajit të cilët janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç nuk u kërkohet të mbajnë dokumentat e tyre të udhëtimit nëse emri dhe data e lindjes dhe fotografia, me disa përjashtime, janë të përfshira në pasaportën e një familjari. Krahas dokumentave të kërkuara, çdo person, i cili ka për qëllim të hyjë dhe qëndrojë në Shqipëri duhet të përmbush kushtin se nuk përbën rrezikshmëri për rendin,<sup>126</sup> sigurinë dhe shëndetin publik dhe nuk ka ndonjë vendim të vlefshëm për refuzimin e hyrjes. Për më tepër, familja duhet të ketë fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit të çdo anëtari të familjes në Shqipëri dhe kthimit

<sup>124</sup> Shih nenin 32 pjesa 2 të ligjit “Për të huajt”

<sup>125</sup> Shih nenin 32 të ligjit “Për të huajt”

<sup>126</sup> Shih nenin 6 paragrafi 1/c të ligjit “Për të huajt”.

në vendin e origjinës. Për këtë arsye kushti i vetëm është se i huaji dhe çdo anëtar i familjes së tij nuk duhet të bëhet barrë për sistemin social të Republikës së Shqipërisë. Sipas legjislacionit shqiptarë anëtarët e familjes së të huajit janë bashkëshortët; bashkëshortët ku martesë ka një natyrë të qëndrueshme dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e e përbërjes familjare, duke përfshirë edhe fëmijët e adoptuar me vendimin e gjykatës apo një vendim të drejtpërdrejtë të aplikueshëm në bazë të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose një vendim i cili duhet të njihet në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Anëtarët e familjes janë, gjithashtu, fëmijët në moshë madhore, të pamartuar kur ata objektivisht nuk mund të përmbushin nevojat e tyre për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; pasardhës të drejtpërdrejtë, nën kujdestarinë e tij/saj ose kujdestari i tij/saj bashkëshortit, sipas legjislacionit të vendit të origjinës dhe që nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e tyre të origjinës.<sup>127</sup> Familjarët e të huajit që plotësojnë parakushtet për qëndrim afatshkurtër, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Shqipërisë, gëzojnë të drejta të barabarta në trajtimin si të huajt e tjerë në rrethana të krahasueshme.

b. Leja e qëndrimit autonome

Nëse plotësojnë kërkesat e legjislacionit shqiptar i huaji dhe anëtarët e familjes së tij kanë të drejtë të qëndrojnë në Shqipëri. I huaji, bashkëshort i një shtetasi shqiptar, i lëshohet leja e qëndrimit për një periudhë të vlefshme prej jo më shumë se një vit, kur ajo lëshohet për herë të parë,<sup>128</sup> përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet apo në këtë ligj.

---

<sup>127</sup> Shih nenin 1, paragrafi. 14 i ligjit “Për të huajt”.

<sup>128</sup> Shih nenin 37 paragrafi 1 të ligjit “Për të huajt”.

Leja e qëndrimit mund të rinovohet për një periudhë të vlefshme prej dy vitesh. Ky rregull për bashkëshortin e një shtetasi shqiptar është i zbatueshëm edhe për të miturin, i cili është i pamartuar dhe nën kujdestarinë ligjore të të huajt. Natyrisht, i huaji nuk do t'i lëshohet një leje qëndrimi apo do t'i anulohet leja e qëndrimit nëse provohet se martesë është për përfitim bazuar në dispozitën e nenit 59 të ligjit "Për të huajt".<sup>129</sup> Procedura përcakton e përveç dokumenteve të kërkuara, çdo person i cili ka për qëllim të qëndrojë në Shqipëri ka për detyrim të përmbushë kushtin që nuk përbën rrezikshmëri për rendin, sigurinë ose për shëndetin publik dhe mos ketë një vendim për refuzimin e hyrjes kundrejt tij. Për më tepër, familja duhet të ketë fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit të secilit anëtar të familjes në Shqipëri dhe të kthimit në vendin e origjinës. I huaji dhe çdo anëtar i familjes nuk duhet të bëhen një barrë për sistemin e ndihmës sociale të Republikës së Shqipërisë

c. leja e qëndrimit afatgjatë në kuadër të bashkimit familjar

Familjarët e të huajt, të cilit i është lëshuar leje qëndrimi në mënyrë që të pajiset me leje qëndrimi për bashkim familjar, duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që të mund t'përfitojë të drejtën e bashkimit familjar.<sup>130</sup> Në rast se anëtarët e familjes së të huajt të cilit

<sup>129</sup> Spas legjislacionit shqiptar "Martesa e komoditet" është konsideruar si një martesë që hyri me qëllim të shmangies përmbushjen e kushteve për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. Domethënë një martesë do të konsiderohet të jetë një martesë e komoditet në qoftë se një nga rrethanat e mëposhtme është gjetur: bashkëshortët, pas bashkimit familjar, nuk e mbajnë lidhjen e tyre martesore në bazë të asnjë arsye në të gjitha; b) bashkëshortët pas ribashkimit familjar nuk i kryejnë obligimet e tyre martesore; bashkëshortët kurrë nuk kam takuar para përfundimit të martesës; bashkëshortët nuk arrijnë të sigurojnë të dhëna të qëndrueshme personale për njëri-tjetrin; bashkëshortët nuk flasin një gjuhë që ata të dy e kuptojnë; Paratë u shkëmbyen për përfundimin e martesës, përveç nëse paraja është prikë, dhe bashkëshortët vijnë nga vendet ku paraqitja e pajës është një porosi; ka dëshmi të martesave të mëparshme lehtësi nga ana e ndonjë prej bashkëshortëve ose në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj. I huaji nuk do të jetë çështje e lejes së qëndrimit për bashkim familjar në rast të martesës së lehtësi.

<sup>130</sup> Dokument udhëtimi të vlefshëm dhe një kopje të faqes së parë të atij dokumenti; një kopje të lejes së qëndrimit të sponsorit në Republikën e Shqipërisë; një kopje të vërtetuar të lejes afatgjatë qëndrimit të

i është lëshuar leja e qëndrimit nuk do të banojnë në vendin ku i huaji ka qenë një rezident afatgjatë, ai/ajo mund të aplikojë për bashkim familjar. Si rregull i përgjithshëm, ky rast bie nën regjimin e bashkimit familjar, të dhënë nga seksionit V të ligjit "Për të huaj".

Legjislacioni shqiptar parashikon rregullat e përgjithshme të zbatueshme për familjarët e banorit afatgjatë. Siç e kemi përmendur më sipër, anëtarët e familjes së të huajit konsiderohen bashkëshorti; partner, e cila partneritet ka një natyrë të qëndrueshme dhe të provuar; miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, duke përfshirë edhe fëmijët nën kujdestari dhe fëmijët e adoptuar me vendim të gjykatës apo një vendim të drejtpërdrejtë të aplikueshme në bazë të obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose një vendim i cili duhet të njihen në përputhje me ndërkombëtare detyrimet, si dhe fëmijët e rritur, e pamartuar, kur ata objektivisht nuk mund të përmbushin nevojat e tyre për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; pasardhës të drejtpërdrejtë, nën kujdestarinë e tij / saj ose kujdestari i tij / saj bashkëshortit, sipas legjislacionit të vendit të origjinës, dhe që nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e tyre të origjinës. Partnerët e pamartuara janë të trajtohen, në masën e zbatueshme, në mënyrë të barabartë si bashkëshortëve përsa i përket bashkimit familjar.

Nëse i mituri i cili ka hyrë në Republikën e Shqipërisë për qëllime të ribashkimit familjar, arrin moshën madhore, ai/ajo ka të drejtë të aplikojë në mënyrë të pavarur nga anëtarët e tjerë të familjes që do të lëshohen me leje qëndrimi. I huaji në rast martesë poligame ka të drejtë të aplikojë për bashkim familjar me vetëm njërit prej bashkëshortëve

---

anëtarëve të familjes në vendin e vendbanimit të mëparshëm dhe dëshmitë e tyre duke qenë anëtarët e familjes të rezidentit afatgjatë në vendin tjetër para mbërritjes së tyre në Republikën e Shqipërisë. Është e rëndësishme të përmendet këtu mbulimi i sigurimit shëndetësor në lidhje me të gjitha rreziqet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe certifikimin e vaksinimit sipas sëmundjeve të mbuluara nga kalendari i vaksinimit në Shqipëri si dhe dëshmi e mjeteve të qëndrueshme financiare.

dhe gjithashtu fëmijët e lindur nga ky bashkëshort. Familjarët e të huajit, i cili gëzon leje qëndrimi në bazë të kërkesave të këtij neni, në mënyrë që të pajiset me leje qëndrimi për bashkim familjar, duhet të paraqesë një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe një kopje të faqes së parë të atij dokumenti ; një kopje të lejes së qëndrimit të sponsorit në Republikën e Shqipërisë; një kopje e vërtetuar e afat-gjatë të lejes së qëndrimit të anëtarëve të familjes në vendin e vendbanimit të mëparshëm; nëse është e nevojshme, dëshmi e tyre duke qenë anëtarët e familjes të rezidentit afatgjatë në vendin tjetër përpara mbërritjes së tyre në Republikën e Shqipërisë; sigurime për të mbuluar sëmundjet dhe në lidhje me të gjitha rreziqet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe certifikatën e vaksinimit sipas sëmundjeve të mbuluara nga kalendari i vaksinimit në Shqipëri; dëshmi e mjeteve të mjaftueshme financiare ose dëshmi që rezidenti afatgjatë ka burime të mjaftueshme financiare për këtë arsye. Kur përbën një kërcënim serioz për rendin publik ose sigurinë publike justifikohet anulimi i lejes afatgjate. Bazat për dhënien e lejeve të qëndrimit për arsye humanitare apo për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë të lidhura me përfundimin e nevojës për dhënien e këtyre lejeve. Pozitat ligjore të anëtarëve të familjes, të cilët mbajnë një leje të përhershme qëndrimi ose leje qëndrimi KE është e njëjtë me atë të rezidentëve të tjera afatgjata.

#### **6.4. Rastet e refuzimit të bashkimit familjar**

Vlefshmëria e lejes së qëndrimit ose viza është e lidhur kryesisht me arsyen e dhënies së vetë lejes. Shkaku i dhënies së lejes së qëndrimit përcakton kohëzgjatjen e lejes. Në Republikën e Shqipërisë, lejet e qëndrimit jepen fillimisht si leje të përkohshme. Ato jepen për një afat kohor të caktuar, dhe duhet që pas përfundimit të kësaj periudhe, leja të

rinovohet nëse i huaji dëshiron të qëndrojë dhe / ose vazhdon të qëndrojë në territorin e Shqipërisë. Në fazat e rinovimit të lejes së qëndrimit, kryhet vlerësimi nëse personi në fjalë i ka përmbushur kushtet për të përfituar sërish një leje qëndrimi në Shqipëri. Në shumicën e rasteve humbja e së drejtës së qëndrimit është e lidhur me vendimet negative në aplikimin për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit me afat të caktuar, dhe jo të rrethanave si tërheqje apo shuarje të një lejeje qëndrimi ekzistuese. Natyrisht, vendimet lidhur me rinovimin e lejeve të qëndrimit dhe vendimeve mbi tërheqjen apo jo të së drejtës së qëndrimit, duhet të përkojnë qartazi me standarte të mirë-përcaktuara përsa i përket sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike për subjektin juridik. (Bana. E, 2013, 45) Ligji Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” parashikon në nenin 60 të tij anulimin i lejes së qëndrimit të marrë për shkak të bashkimit familjar. Kështu në këtë nen përcaktohet se autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin<sup>131</sup> anulon lejen e qëndrimit për të huajin, i cili e ka marrë atë për shkak të bashkimit familjar, në rast se provohet se kërkuesi dhe përfituesi kanë lidhur një martesë fiktive për përfitimin e lejes së qëndrimit.<sup>132</sup>

Mosparaqitja e dokumentacionit të rregullt është një nga kushtet e refuzimit të bashkimit familjarë, pra nëse i huaji gjatë paraqitjes së kërkesës për bashkim familjarë

---

<sup>131</sup> Shih Nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë

<sup>132</sup> Shih Nenin 59 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se “1. Martesa fiktive, sipas këtij ligji, është martesa e lidhur me qëllim për të shmangur përmbushjen e kushteve për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. 2. Martesa mund të konsiderohet fiktive, nëse plotësohet një nga rrethanat e 34 mëposhtme: a) bashkëshortët, pas bashkimit familjar, nuk jetojnë së bashku pa ndonjë arsye; b) bashkëshortët, pas bashkimit familjar, nuk përmbushin detyrimet martesore ndaj njëri-tjetrit; c) bashkëshortët nuk janë takuar përpara se ata të lidhnin martesën; ç) bashkëshortët nuk janë në gjendje të japin të dhëna personale të njëri-tjetrit që përputhen në mes tyre; d) bashkëshortët nuk flasin një gjuhë apo formë komunikimi të kuptueshme nga të dy; dh) për lidhjen e martesës ose bashkimin familjar janë paguar shuma financiare ose janë shkëmbyer pasuritë martesore, përveç rastit kur këto pasuri janë pjesë e pajës dhe bashkëshortët vijnë nga vende ku shkëmbimi i pajës është traditë; e) ka prova të një martese fiktive të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër. 3. I huaji nuk pajiset me leje qëndrimi për bashkim familjar në rast të martesave fiktive.”



paraqet të dhëna jo të rregullta atëherë atij i mohoet e drejta e bashkimit familjarë në Republikën e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia e familjes si institucion legjislatori shqiptarë ka vendosur afatin 5 vjetor si kusht minimal për qëndrimin e të huajit si i martuar në rastin e bashkimit familjar.

Kështu në nenin 60 pika c parashikohet se “autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin anulon lejen e qëndrimit për të huajin, nëse ajo është lëshuar për shkak të bashkimit familjar dhe martesë është zgjidhur brenda 5 vjetëve nga marrja e lejes dhe, për shkak të vdekjes së bashkëshortit, brenda 3 viteve nga marrja e lejes, si dhe kanë pushuar të drejtat për kujdestari prindërore, me përjashtim të rastit kur i huaji ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë me leje qëndrimi për të paktën 5 vjet”. Po kështu në pikën ç të nenin 60 të Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt. të Republikën e Shqipërisë përcaktohet se refuzohet e drejta e bashkimit familjarë dhe për rrjedhojë dhe e qëndrimit në vendin tonë nëse të dy prindërve, ose njërit nga prindërit apo kujdestarit/ve ligjorë, i është hequr leja e qëndrimit dhe të miturit nuk i garantohet qëndrimi nga prindi tjetër apo kujdestari ligjor.

Çështjet që lidhen me imigracionin dhe të drejtën e të huajve për të qëndruar në Shqipëri janë çështje që janë të lidhura me shqetësimet sovrane në lidhje me sigurinë kombëtare dhe çështje të tjera me interes publik. Kështu, në nenin 65 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë” përcaktohen rastet kur refuzohet e drejta e bashkimit familjarë për azilkërkuesit në Republikën e Shqipërisë. në këtë nen përcaktohet se autoriteti përgjegjës për akordimin e azilit dhe statusit të refugjatit mund të refuzojë aplikimin për bashkim familjar, të revokojë ose të refuzojë rinovimin e lejes së qëndrimit të familjes nëse vërtetohet se familjarët e tij mund të cenojnë sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe shëndetit publik.

E drejta e bashkimit familjar mund të refuzohet edhe nëse aplikuesi për bashkim familjar ose anëtarët e familjes së tij në vendin pritës, gjatë qëndrimit në vendin e origjinës, nuk kanë jetuar në marrëdhënie martesore ose familjare. Pra kanë realizuar një martesë që do të shërbente vetëm për të përfutur bashkimin familjar. Paraqitja e dokumentave jo të rregullta <sup>133</sup>dhe me të dhëna të pasakta përbënë një arye të rëndësishme të refuzimit të bashkimit familjarë nesh nga ana e autoriteteve përgjegjëse konstatohen parregullsi në dokumentacionin e duhur. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët që shqyrton aplikimin për bashkim familjar ka detyrimin ligjor në bazë të këtij ligji që të arsyetojë vendimin e refuzimit të aplikimit, revokimit për bashkim familjar apo refuzimit për të rinovuar lejen e qëndrimit të familjes. I huaji ose azilkërkuesi ka të drejtë të bëjë ankim pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit me shkrim të vendimit, në rastin e refuzimit të bashkimit familjar. Nëse i huaji nuk është dakort me përgjigjen e marrë nga ana e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët atëherë ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë” në nenin 65 paragrafi 5 i mundëson atij të drejtën e ankimit të vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

---

<sup>133</sup> Shih nenin 65 pika c të Ligjit Nr. 121/2014 “Për Azilin Në Republikën e Shqipërisë”

## KAPITULLI VII KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### 7.1.Konkluzione

Krijimi i një përkufizimi kategorik për familjen në tërësi në kuadër të bashkimit familjar është disi e vështirë. Këtë nocion, më shumë se legjislacioni komunitar, e kushtëzon legjislacioni i brendshëm dhe jurisprudenca komunitare ose ajo e brendshme. Para së gjithash është e vështirë të flasim për një anëtarësi të qëndrueshme të familjes. Në këtë drejtim edhe përcaktimi i situatave të veçanta apo i statusit të personave që përcaktojnë përbërjen e familjes, ndryshojnë në varësi të titullarit aktiv (shtetas komunitar ose jo komunitar). Nuk ka dyshim që disiplinat në fjalë janë subjekt i përmirësimeve dhe, në këtë drejtim me qëllim përparimin dhe harmonizimin e politikës së bashkimit familjar. Në trajtimin që i kemi bërë temës së të drejtës së bashkimit familjar vërejmë evolucionin e mundimshëm të kryer nga sistemi juridik ndërkombëtar dhe komunitar, si dhe ai kombëtar për sa i përket mbrojtjes së njësisë familjare dhe të drejtën e bashkimit familjar.

Mbrojtje e njësisë familjare, në dimensionin e saj faktik, përmes institutit të bashkimit familjar, konfigurohet më shumë se sa si një e drejtë themelore, si një e drejtë e ndryshueshme dhe e modeluar sipas përfituesit. Pikërisht, ky konfigurim e bën studimin e jurisprudencës, europiane dhe kushtetuese, një pasqyrim të privilegjuar në studimet e bëra. Këto jurisprudenca lejojnë, sigurisht, të vendoset në fokus jo vetëm evolucioni që tutela e të drejtës në shqyrtim ka pasur, por lejojnë edhe të verifikohet si ndryshon interpretimi i instituteve dhe koncepteve për familjen dhe për jetën familjare. Përpjekja për të ri parë ndërhyrjet e shumta normative në këtë temë të jurisprudencave të sipërpërmendura vendos në përfundim disa pyetje të rëndësishme. Mbrojtja ndërkombëtare e jetës familjare dhe mbi

të gjitha, e drejta e emigrimit, kanë një karakter të fortë politik. Një vetëdije e qartë për matricat mbi të cilat formohen disiplinat në këtë temë, gjithsesi, nuk justifikon as teknikat shtrënguese normative të ndërmarra dhe as qëllimet e ndjekura nga ligjvënësi.

Mbrojtja e familjes në Bashkimin European është pasojë e impaktit të lirive komunitare në realitetin social-ekonomik dhe juridik të familjeve europiane. Jurisprudenca komunitare duket sot e prirur të instrumentalizojë parimet e funksionimit të tregut të brendshëm me objektivin e mbrojtjes së familjes. Duke iu referuar kësaj të fundit, problemi i menjëhershëm që paraqitet, në përcaktimin e të drejtës së bashkimit familjar, është pikërisht në lidhje me gjetjen e modelit të familjes që supozohet të pranohet në shtetet e BE-së. Përcaktimi i këtij modeli, më shumë se t'i përgjigjet kriterëve krahasues të influencës midis modeleve të ndryshme, për nga traditat kulturore dhe juridike, të lidhura me shtetet anëtare, duket qartësisht e orientuar drejt një perspektive të politikës dhe të drejtës së emigracionit. Futja në shtete të shumta komunitare e instituteve të bashkimeve të regjistruara dhe të martesave homoseksuale apo rritja e rëndësisë juridike të bashkëjetesës more uxorio, ngre vështirësi koordinimi midis legjislacioneve kombëtare në temën e bashkimit familjar dhe në përgjithësi, për të drejtën e familjes. Në mungesë të një discipline të përbashkët, zgjidhja e çështjeve të tilla u është besuar në parim sistemit të së drejtës ndërkombëtare private të secilit shtet anëtar, në kurriz të procesit të integritetit.

Nuk ka dyshim që pamundësia për të “ruajtur” statusin familjar përcakton, në fakt, një pengesë për lëvizjen e lirë, edhe në rastin kur shtetasi komunitar duhet të “humbasë” të drejta dhe prerogativa të njohura për të në temën familjare nga shteti i origjinës, si dhe në rastin në të cilin ky status është i rëndësishëm si bazë ligjore për dhënien e të drejtave subjektive me origjinë komunitare, si e drejta e qëndrimit. Njohja dhe vlefshmëria dhe

efikasiteti i bashkimeve të reja familjare është veçanërisht problematikë e legjislacioneve, si ai italian për shembull, që nuk parashikon asnjë institucionalizim për raportet e çifteve jashtë martesës, përveç njohjes së disa të drejtave për çiftet e faktit.

Duke pranuar që mungesa e njohjes së unitetit familjar përbën një pengesë për lirinë për të lëvizur të shtetasve të Bashkimit European, mund të parashikohet kalimi i kësaj pengese përmes zbatimit të parimit të njëanshmërisë dhe njohjes së statusit shtetas komunitar. Për shembull, neni 2 i Direktivës nr. 38/2004 vendos lidhjen – për temën e të drejtës së qëndrimit – të statusit familjar për njohjen e dhënë atyre në shtetin e destinacionit të atij që ushtron të drejtën e lëvizjes së lirë. Rëndësia e vlerësimeve të shtetit të destinacionit, në përcaktimin e supozimit të normës komunitare mbi të drejtën e qëndrimit, bën që një subjekt i kualifikuar “familjar” në një legjislacion mund të mos jetë në shtetin në të cilin ai ka ndër mend të shoqërojë shtetasin komunitar që ushtron të drejtën e lëvizjes së lirë dhe mundet, të mos gëzojë nga e drejta e qëndrimit si “familjar” në shtetin tjetër. Përkundrazi, zbatimi i parimit të njëanshmërisë të statusit të shtetasit komunitar do të ia linte përcaktimin e “familjarit” legjislacionit të “shtetit të origjinës” të subjekteve të interesuar, me detyrimin për shtetin pritës të “njohë” situatat familjare para ekzistuese. Kur, për shembull, “shteti i origjinës” disiplinon bashkimet jo martesore, të pa parashikuara në “shtetin e destinacionit”, parimi i njëanshmërisë së Statusit do t’i garantonte vazhdimësinë e këtyre raporteve me pasoja të rëndësishme për dhënien e të drejtave subjektive me origjinë komunitare – në këtë rast e drejta e qëndrimit.

Nëse do t’i referohemi të drejtës së bashkimit familjar në Shqipëri do të vërejmë që ajo ka qenë e kornizuar në kuadër të të drejtës së migracionit në vendin tonë, e drejtë e cila

për herë të parë në formë të shkruar është sanksionuar në Statutet e Shkodrës ku parashikohet për herë të parë e drejta e të huajve për t'u vendosur në qytetin e Shkodrës.

Pas vitit 1991 me krijimin e Parlamentit të parë pluralist i cili shpalli dhe Republikën Parlamentare të Shqipërisë, sistemi ligjor shqiptarë hodhi hapat e para të sigurta drejt zhvillimit të politikave të reja zgjeruese të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e shoqërisë. Fillimisht e drejta e bashkimit familjar është trajtuar në nenin 23 të Ligjit Nr. 8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, ku sanksionohej leja e qëndrimit si rezultat i bashkimit familjar. Aktualisht e drejta e bashkimit familjar gëzon një mbrojtje të plotë ligjore në legjislacionin shqiptarë. dhe në përputhje me standartet europiane. Kështu Shqipëria ka hyrë në një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian, nënshkruar atë më 12 qershor 2006 dhe mori liberalizimin e vizave për qytetarët e saj brenda zonës së Shengenit në vitin 2010. Vendi ka bërë përpunim të rëndësishëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, i orientuar kryesisht në drejtim të përmbushjes së kriterëve politike dhe krijimin e institucioneve të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira me vendet e zgjerimit dhe Shtetet Anëtare. Ajo fitoi statusin e vendit kandidat për të hyrë në BE në qershor 2014. Shqipëria ka integruar të gjitha direktivat që lidhen me emigracionin dhe azilin të paraqitura nga BE-ja dhe merr pjesë në negociatat rreth masave të reja të migrimit dhe azilit në nivel rajonal. Kuadri i parë ligjor për të huajt në Republikën e Shqipërisë u krijua me ligjin nr. 9959 datë 18.7.2008 “Për të huajt”, ligjin nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 9098 datë 03.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në

Republikën e Shqipërisë”, të cilat janë pasuar nga ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme duke u përshtatur mjaftë mirë me kërkesat aktuale.

Bashkimi familjar në Republikën e Shqipërisë është një e drejtë që garantohet edhe është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kërkesën për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjar e bën vetë i huaji, i cili vjen nga një martesë monogame. Legjislacioni aktual përcakton kategorinë e subjekteve përfutues të të drejtës së bashkimit familjar në Shqipëri. Në nenin 3 të Ligjit Nr. 108 datë 28.03. 2013 “Për të huajt” përcaktohet se janë subjekt të këtij ligji, bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundën objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës. Në rast të të huajve që vijnë nga një vend ku poligamia është e ligjshme, i huaji që kërkon bashkim familjar duhet të zgjedhë vetëm një nga bashkëshortet. Zgjidhja për këta anëtarë të familjes është në përputhje të plotë me legjislacionin komunitar, madje shkon edhe më tej, duke lejuar edhe prindërit nëse janë në

ngarkim. Elementet percaktuar te anëtarëve të familjes sic realizohet ne vendin tone është në përputhje të plotë me legjislacionin komunitar, madje shkon edhe më tej, gjithmone ne kuptimin me favorizues te mundshem.

Çështja e krizës së refugjatëve dhe migrantëve sot në Europë është çështje e të drejtave të njeriut dhe duhet të përshkojë në mënyrë tërësore politikat shtetërore të vendeve pritëse, apo të tranzitit dhe të atyre vendeve që kanë gjasa të preken nga kjo krizë. Shqipëria sot mbetet në një gjendje ende të papërgatitur në mënyrën e duhur për flukset ekzistuese, apo të pritshme migratore, apo të refugjatëve dhe nuk po ndjek ritmin e kërkuar të kushtëzuar nga zhvillimet. Kështu personave që kapen duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin për të ardhur apo larguar nga Shqipëria, qartësisht pjesë e flukseve migratore, iu mohohet tërësisht apo iu shtyhet pa fund hyrja në procedurat e azilit. Nga monitorimet dhe inspektimet e kryera në Qendrën e Trajtimit të të 13 Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e kalimit kufitar, si dhe pikat potenciale për ngritjen e kampeve të pritjes apo të ndihmesës për kalimin tranzit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, ka rezultuar se kapacitet e tyre janë të pamjaftueshme në hapësirë, burime njerëzore dhe ato financiare.



## 7.2.Rekomandime

Regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitarë dhe jo komunitarë ndryshon. Kuptohet që bëhet fjalë për regjime të ndryshme juridike, të cilat rregullohen nga akte të ndryshme ligjore. Në kuadër të bashkimit familjar familja komunitare është më e plotë dhe më e mbrojtur dhe përfshin jo vetëm bashkëshortin por edhe partnerin e regjistruar. Legjislacioni ynë është me i plotë dhe me favorizues se dhe legjislacionet e vendeve anetare të BE-se. I njëjti regjim shihet edhe në lidhje me shtetasit amerikanë, pavarësisht se kjo kategori nuk është në fokus të këtij studimi. Rregullimi ligjor i lejimit të hyrjes dhe qëndrimit të partnerëve *de facto* i lihet në dorë Shteteve Anëtare. Ky është një diskrecion i shtetit pritës dhe jo atij dërgues. Pikërisht këtu lindin problemet e unifikimit të legjislacioneve, edhe pse në realitet unifikim nuk ka.

1. Rregullat komunitare në lidhje me bashkimin familjar të shtetasve jo komunitarë edhe në vendin tonë janë subjekt i përmirësimeve ligjore dhe jurisprudenciale në varesi të ndryshimeve sociale, politike dhe ekonomike.
2. Zgjidhja më e përshtatshme në këtë drejtim do të ishte ulja (ose rritja) e shkallës së mbrojtjes në përputhje me rregullat e shtetit pritës. Vendi ynë lejon bashkimin familjar të shtetasve të huaj edhe me partneret, pra është në tejkalim edhe të realitetit të vendeve të BE-se. Për këtë arsye, rekomandimi me këtë pjesë lidhet me pjesën procedurale dhe jo legjislative.
3. Mbrojtja e të drejtave lidhur me lëvizjen e lirë dhe respektimin e jetës familjare dhe bashkimin familjar duhet të orientojnë politikën komunitare jo vetëm drejt objektivit për të harmonizuar ndërkombëtarisht zgjidhjet, por, në veçanti, për të shmangur situata juridike të tilla jo favorizuese, të njohura në disa shtete komunitare.

4. Në lidhje me shtetasit ekstra-komunitarë duhet të merren masat e duhura që t'u sigurojnë atyre të drejta (thuajse) të barabarta me ato të shtetasve të BE –së.
5. Legjislacioni shqiptar lidhur me bashkimin familjar edhe pse rezulton te jete në përputhje me legjislacionin europian përkatës, nuk e perfshin kategorine e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë.
6. Në legjislacionin shqiptar për të huajt duhet t'i meshojme thjeshtesimit te procedurave lidhur me dokumentacionin si ato te gjendjes civile, te cilat kane rezultuar problematike lidhur me kategorine e refugjateve ne vecanti.
7. Duhet të krijohet një përcaktimin i saktë i kategorive: si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji aktual e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejtë themelore.
